

1 E martë, 4 prill 2023

2 [Deklarata hyrëse]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.00

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëdita,
7 të gjithëve.

8 Znj. Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar
10 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Vërej se z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi
15 janë të pranishëm të gjithë në sallë.

16 Në rendin e ditës sot kemi deklaratën hyrëse të ekipeve
17 të mbrojtjes. Në përputhje me rregulloren do të filloj me
18 Mbrojtjen e Thaçit, pastaj do të vazhdojmë me atë të Veselit.
19 Dhe në varësi të kohës, mund të vazhdojmë me Mbrojtjen e
20 Selimit. Në mos sot, pastaj nesër. Pastaj, nesër mbetet edhe
21 deklarata hyrëse e Mbrojtjes së Selimit dhe e Krasniqit.

22 Të njëjta rregulla si dje, zbatohen dhe sot.

23 Përpara se të fillojmë, Trupi Gjykses ka marrë
24 parashtrimin e Mbrojtjes së Veselit sa i takon provës
25 materiale W04474. Është parashtrim i protokolluar 1414. Duke

1 pasur parasysh se kjo ka të bëjë me një çështje e cila është
2 thirrur më herët në provat -- e cila do jetë ndër provat e
3 para të paraqitura të Prokurorisë, kërkon një zgjidhje të
4 përshpejtuar.

5 Z. Halling, a mundet që të marr një përgjigje brenda
6 datës 5 prill?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë i
9 japim urdhër ZPS-së që t'i përgjigjet parashtrimit F1414 jo më
10 vonë se data e parashtruar pak më lartë, jo më vonë se ora
11 16.00.

12 Do të fillojmë, pra, me deklaratën hyrëse të z. Thaçi.

13 Z. Kehoe, keni tre orë në dispozicion.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës,
15 të nderuar kolegë të Prokurorisë, të nderuar kolegë të ekipeve
16 të mbrojtjes, mirëdita.

17 Besoj se ju kemi dhënë një prezantim në PowerPoint i cili
18 do të jetë, si të thuash dhe shtylla e diskutimit sot. I kemi
19 dhënë kopje të kësaj ZPS-së dhe Mbrojtësit të Viktimave.

20 Të nderuar Gjykatës, nëse mundem, përpara se të kaloj me
21 këtë, kam disa komente shumë të shkurtra lidhur me deklaratat
22 hyrëse të ZPS-së dje. Qëndruam këtu duke dëgjuar për diçka më
23 shumë se katër orë duke mbajtur vesh deklaratat e tyre. ZPS-ja
24 kërkon që t'ju thotë juve se z. Thaçi, ka drejtuar ndonjë
25 ndërmarrje kriminale të madhe për të sunduar Kosovën duke

1 filluar nga viti 1998, UÇK-ja ishte një grup fillestar
2 vullnetarësh që mbronin atdheun e tyre dhe luftonin për
3 ekzistencën e tyre duke vijuar pastaj edhe në shtatorin e
4 vitit 1999, kur z. Thaçi së bashku me KFOR-in dhe UNMIK-un e
5 përfunduan çmilitarizimin.

6 Këtë ata e bënë duke ju paraqitur dokumente dhe duke bërë
7 një orvatje për t'i lidhur këto dokumente me qendrat e
8 ndalimit në vende të ndryshme të cilat kontrolloheshin nga
9 popullsia lokale që mbronin shtëpitë dhe fshatrat e tyre. Pra,
10 kjo është pikërisht përpjekja e tyre për të lidhur këto
11 dokumente me qendrat e ndalimit, të cilat sipas atyre
12 përcaktojnë dhe fajësinë.

13 Ajo që ata nuk arritën të bënin gjatë katër orëve
14 deklaratë hyrëse është konteksti. Lufta. Çfarë bën lufta sa i
15 takon komandës dhe kontrollit dhe komandimit dhe kontrollit
16 efektiv. Përfaqësuesit e ZPS-së folën që kolaboracionistët
17 konsideroheshin si një rrezik ekzistencial. Jo. I vetmi rrezik
18 ekzistencial në vitin 1998 dhe 1999 ishte ushtria jugosllave
19 dhe policia jugosllave, në bashkëpunim me forcat
20 paraushtarake.

21 Ata nuk përmendën komandimin dhe kontrollimin në
22 funksionim në nivel lokal, në bazë. Ata nuk përmendën
23 përbërësin thelbësor të komandimit dhe kontrollimit, që do të
24 thotë, komandanti i përgjithshëm i UÇK-së i cili u zëvendësua
25 gjatë konferencës së Rambujesë ndërkohë që presidenti Thaçi

1 dhe z. Krasniqi dhe Azem Syla ndodheshin në Paris. Komandantët
2 lokal ndryshuan komandantin e përgjithshëm të UÇK-së pa asnjë
3 mendim të marrë nga presidenti Thaçi, nga Azem Syla, që ishte
4 aso kohe komandat i përgjithshëm, apo askush tjetër në
5 Rambuje, që ndodhej në Rambuje.

6 Pra, nuk ka asnjë diskutim se kush e kishte në dorë
7 pushtetin dhe pushteti ishte në dorë të nivelit lokal. Ata nuk
8 folën as për kontekstin e luftës, një luftë e cila filloi në
9 mënyrë mizore në verën e vitit 1998 dhe vijoi deri në shtator
10 të vitit 1998.

11 E çfarë i bëri kjo luftë, kjo ofensivë strukturës
12 komanduese të UÇK-së, kjo ofensivë shkatërrimtare e ushtrisë
13 jugosllave dhe e policisë ushtarake? Unë mund të përdorë
14 fjalët e një dëshmitari të vetë ZPS-së:

15 "Na shkatërroi brigadën. Njerëzit u shpërndanë dhe shkuan
16 në vende të tjera. Dhe nuk ndodhi vetëm në zonën tonë por në
17 çdo zonë të Kosovës. Në fakt, nuk kishte, nuk mbeti komandim e
18 kontrollim pas ofensivës pas verës së vitit 1998".

19 Dhe ky shkatërrim i strukturave komanduese dhe
20 kontrolluese të UÇK-së u përsërit përsëri në mars dhe prill të
21 vitit 1999, me fushatën e spastrimit etnik që ushtruan forcat
22 serbe. UÇK-ja gjatë kësaj periudhe kohore u shpartallua apo u
23 sakatua në atë shkallë sa që UÇK-ja e cila e kishte rimarrë
24 veten nga viti 1998, u eliminua, thuajse u eliminua në vitin
25 1999.

1 Çfarë i ndodh strukturës komanduese dhe kontrolluese në
2 rrethana të tilla? Çfarë i ndodh strukturave vertikale të
3 pretenduara të tilla? Në fakt, këto pushojnë së ekzistuari.
4 Megjithatë, ZPS-ja dëshiron që ju të besoni se kishte një
5 strukturë funksionale komanduese me kontroll efektiv. Të
6 nderuar Gjykatës, ju parashtroj që kjo është shumë larg së
7 vërtetës.

8 Prandaj dhe dëshirojmë që të fillojmë në këtë moment që
9 të ofrojmë kontekstin e çështjes, faktet e asaj që ndodhën në
10 terren t'i vendosim në kontekst, duke filluar me prezantimin
11 fillestar të klientit tonë, Presidentit Thaçi, pastaj për të
12 folur për rolin e tij gjatë këtyre viteve, në viti 1998 dhe
13 1999.

14 Ajo që kemi bërë është që kemi një skemë në diapozitivin
15 2 dhe 3 në mënyrë që të nderuar Gjykatës dhe anëtarët e
16 ekipeve të tjera të mund të na ndjekin.

17 Kush ishte z. Hashim Thaçi në vitin 1998 dhe në 1999? I
18 ri, 30-vjeçar, të mos e ngatërrojmë me njeriun që u bë më pas
19 Kryeministër dhe President i Kosovës vite më pas. Ishte një
20 aktivist student që u kthye në Kosovë në mars 1998, menjëherë
21 pas vrasjes së anëtarëve të familjes Jashari që është dhe
22 pikënisja e kësaj periudhe që mbulohet nga kjo aktakuzë për
23 ndërmarrje kriminale të përbashkët të pretenduar.

24 Motivi është shumë i rëndësishëm. Prandaj dhe ne
25 dëshirojmë që të flasim për motivin në këtë çështje gjyqësore.

1 Hashim Thaçi nuk kishte asnjë motiv që të merrte pjesë në
2 krime. Si një prej udhëheqësve politikë të UÇK-së, Hashim
3 Thaçi e dinte se suksesi i Lëvizjes Çlirimtare të Kosovës
4 varej nga mbështetja e vendeve perëndimore, sidomos nga
5 Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

6 Po, mund të transmetohet.

7 Ju kërktoj ndjesë, të nderuar Gjykatës. Më duket se nuk i
8 thashë sekretarisë që mund ta transmetojnë prezantimin.

9 Mund të vijoj?

10 Mund të kalojmë në diapozitivin tjetër.

11 Shumë herët në fillim të këtyre zhvillimeve në vitin
12 1998, SHBA-ja i ofroi mbështetje UÇK-së sipas disa kushteve:
13 Asnjë sulm kundër civilëve, asnjë asistencë nga grupet
14 fundamentaliste islamike apo të tjera ekstremiste, asnjë
15 financim nga trafikimi i lëndëve narkotike të paligjshme dhe
16 asnjë veprim jashtë territorit të Kosovës.

17 Përfundimi i CIA-s në një raport ishte pikërisht se:

18 "UÇK-ja nuk ishte e përfshirë në aktivitete terroriste -
19 të përkufizuara si dhunë me paramendim dhe motive politike
20 kundër objektivave joluftuese".

21 Hashim Thaçi e dinte shumë mirë që Kosova nuk mund ta
22 arrinte pavarësinë apo vetëqeverisjen pa ndihmën e Shteteve të
23 Bashkuara të Amerikës dhe vendeve të tjera perëndimore. Kishte
24 motivin për të mos u angazhuar në ndërmarrjen kriminale të
25 përbashkët të përshkruar në aktakuzë në mënyrë që të mos

1 rrezikonte mbështetjen nga SHBA-ja.

2 Krimet janë kryer, por jo të motivuara me NKP-në e
3 përshkruar në aktakuzë. Presidenti Thaçi nuk e mohon se disa
4 krime janë kryer nga disa individë shqiptarë gjatë por edhe
5 pas konfliktit. E ka informuar Këshillin e Sigurimit të OKB-së
6 për këtë fakt më 17 dhjetor të vitit 2018. Por ai e
7 kundërshton, e rrëzon pretendimin e ZPS-së se janë kryer krime
8 si pjesë e një politike të planifikuar nga udhëheqja e UÇK-së.
9 Ai gjithashtu rrëzon pretendimet e ZPS-së se janë kryer krime
10 në mënyrë të përhapur apo sistematike sipas shkallës dhe
11 shpërndarjes që pretendon ZPS-ja.

12 Nga vjen kjo dhunë? Se dhunë ka pasur, nuk argumentojmë
13 se nuk pasur dhunë. Dhuna ishte rezultat i veprimeve të
14 pakontrolluara të lokalizuara dhe jo produkt i një NKP-je.
15 Kishte hakmarrje dhe larje hesapësh, mungesë e përgjithshme e
16 ligjit për shkak të luftës dhe të mungesës së institucioneve
17 pas lufte dhe do të shpjegojmë për këtë më pas. Një mungesë e
18 kontrollit efektiv nga Shtabi i Përgjithshëm mbi zonat
19 operative, sepse UÇK-ja ishte një ushtri me bazë lokale, nëse
20 mund ta quajmë ushtri. Kishte zemëratë dhe urrejtje e
21 popullatës më parë të dëbuar tani e kthyer pas përfundimit të
22 luftës dhe kjo kishte të bënte shumë me dhunën e ndodhur
23 atëherë.

24 E thënë shkurt, hakmarrja ishte një motiv i
25 konsiderueshëm për dhunën dhe krimet.

1 Krimet e kryera nga regjimi serb shpjegojnë dhunën që
2 ndodhi gjatë luftës dhe pas kthimit të popullatës së larguar.
3 Në asnjë moment gjatë deklaratës hyrëse të ZPS-së nuk u fol
4 për hakmarrjen e popullatës lokale gjatë luftës lidhur me atë
5 se çfarë ndodhi gjatë regjimit serb.

6 Nëse mund t'ju citoj dhe komentet që aso kohe ka bërë në
7 shtator të vitit 1999 nga Milo Djukanovic. Komente të cilat
8 janë shumë të rëndësishme sepse kur i ka bërë këto komente, i
9 ka thënë ato, ka qenë jo vetëm President i Malit të zi. Mali i
10 Zi aso kohe ishte pjesë e një shteti të përbashkët me Serbinë.
11 Pra, nuk ishte ende Mali i Zi një vend më vete. Dhe ai ka
12 thënë, ka folur, pra, para Asamblesë Parlamentare të Këshillit
13 të Evropës që:

14 "Ato që po heqin serbët, malazezët dhe banorë të tjerë
15 joshqiptarë janë rezultat i krimeve të rënda të kryera nga
16 forcat serbe të cilat kanë bërë kërdrinë gjatë luftës dhe
17 pastaj ja mbathën duke ua lënë bashkëpatriotëve shlyerjen e
18 bëmave të tyre".

19 Hakmarrja ishte pikërisht arsyeja e asaj që po ndodhte në
20 terren.

21 Kjo është një video nga BBC-ja që flet për dëbimin e
22 civilëve nga Peja.

23 [Luhet videoincizimi]

24 "Folësi: Nuk kishe mundësi që t'ju kundërvije aleatëve të
25 NATO-s. Ata do të na kundërvihen neve përmes dritareve se po

1 shkonte tym e flakë. Shumë e tmerrshme, sepse pritej se edhe
2 neve do të na ndodhë e njëjta gjë me -- do na dëbojnë nga
3 shtëpia ose do të na kallin shtëpinë. Isha shumë, shumë i
4 dëshprum.

5 PËRKTHIM: "Valmiri dhe motra e tij, Valentina, kujtojnë
6 ende rrezikun që kanosjes nga forcat serbe dhe nga fqinjët
7 [nëse] kthehen përsëri.

8 "Pesë minuta pasi ramë për të fjetur të gjithë, filluan
9 disa trokitje në derë në gjuhën e tij serbe dhe menjëherë
10 filloi me këto fjalë "Policia. Çeleni derën".

11 "Pastaj pas zërit që e dëgjoi e kuptoi se është kojshia.

12 "Se të mbyste të gjithë familjen apo për ndonjë përdhunim
13 tjetër.

14 "Atë natë i çuan me forcë me mijëra të tjerë brenda një
15 stadiumi sportiv.

16 "Aty s'kishte çka për të parë. Ishte, mund të them,
17 ndoshta jo i tërë qyteti, por gjysma e qytetit deri për aq të
18 pa se pasi që kishte të smut, kishte bebe, njerëz, pleq,
19 plaka, invalid, por këta ju kthenin me përgjigjen 'Vetë keni
20 kërkuar kështu. Keni kërkuar NATO-n dhe tash duroni'.

21 PËRKTHYESI: "Të nesërmen i dërguan më këmbë për t'i
22 dëbuar nga vendi. Ishte vala e parë e cila më pas do kthehej
23 në një dallgë më të madhe".

24 "O Zot, a ka mëshirë për neve. Dhe do të vijë një ditë
25 dhe t'ju kthejmë dhe na këtyre kështu sikur na përqeshin."

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Hakmarrjen, motivi për një pjesë kaq
2 të madhe të dhunës që ndodhi pas luftës.

3 Dhe aktgjykimi në çështjen Limaj e pranon që hakmarrja
4 ishte faktor për këto krime. Një numër civilësh - më falni -
5 është një hakmarrje për krimet që ishin kryer kundër
6 shqiptarëve. Në të thuhet:

7 " ...një numër civilësh shqiptarë të Kosovës mund të jenë
8 rrëmbyer, për arsye të tjera si hakmarrje personale e
9 anëtarëve të veçantë të UÇK-së dhe motive të tjera. UÇK-ja nuk
10 kishte burime apo strukturën komanduese të kontrollonte si
11 duhej zbatimin e kësaj strategjie prej forcave të veta gjatë
12 kohës që ka lidhje me aktakuzën dhe Dhoma pranon se rastet e
13 veçanta të rrëmbimeve për arsye jo në lidhje me strategjinë
14 ndaj bashkëpunëtorëve, u kryen nga elementë të pabindur të
15 UÇK-së".

16 Të nderuar Gjykatës, do ndjekim udhëzimet tuaja për të
17 mos folur për të gjitha krimet serbe. Por, besoj se një
18 përmbledhje e shkurtër e idesë së krimeve që kanë ndodhur
19 gjatë kësaj periudhe është me vend për t'u bërë këtu po kjo
20 nuk është shteruese, por një këqyrje e disa prej këtyre
21 incidenteve, besoj, do të ishte me rëndësi.

22 Kjo është periudha shkurt, mars të vitit 1998. Kemi më 5
23 mars 1998 janë vrasjet në kompleksin e familjes Jashari, 59 të
24 vdekur ndër to gra dhe fëmijë.

25 23 prill 1998, Deçan, 20 shqiptarë të vdekur.

1 Në pranverën dhe verën e vitit 1998, 300 fshatra u
2 batërdisën me 250,000 njerëz të përzënë nga shtëpitë e tyre.
3 Sulme këto që u bënë në bazë të operacioneve ushtarake kundër
4 UÇK-së nga ushtria jugosllave dhe policia e serbëve. Nga
5 pranvera e 1998 deri në tetor 1998, kjo është ofensiva që unë
6 e përmenda pak më parë kur një dëshmitar tha se, brigada e tij
7 u shkatërrua por sikurse u shkatërruan në të gjithë Kosovën.

8 26 shtator 1998, Abria e Epërme, 25 vetë të vdekur.

9 15 janar 1999, Reçak, 45 shqiptarë të vrarë.

10 25-27 mars 1999, Krusha e Madhe, 241 të vrarë.

11 28 mars të vitit 1999, Izbicë, diku nga 146 deri në 166
12 shqiptarë të vrarë.

13 Rezallë, 41 shqiptarë të vrarë.

14 27 prill 1999, në Mejë, 300 shqiptarë.

15 2 maj 1999, në Studimë, 100 shqiptarë.

16 Dhe, sigurisht, për të mos folur pastaj dhe për dëbimin
17 me forcë të afro 800,000 shqiptarëve të Kosovës të cilët u
18 shpërngulën nga shtëpitë e tyre nga ofensiva e pranverës e
19 vitit 1999.

20 Ç'i bëri kjo strukturës komanduese të UÇK-së? Dhuna serbe
21 çoi në shkatërrimin e UÇK-së dhe vuri në lëvizje Këshillin e
22 Sigurimit të OKB-së. Brutaliteti dhe shkalla e sulmeve nga
23 shteti serb gjatë verës së vitit 1998 thuhet se shkatërroi
24 UÇK-në. Ushtarët u larguan nga repartet e tyre, u larguan nga
25 vendi dhe kur filloi zjarr-pushimi, u përpoqën që ta

1 rimontojnë prapë ushtrinë.

2 Kjo çoi në miratimin e Rezolutës së Këshillit të
3 Sigurimit 1199, ku shprehej shqetësimi i madh për përdorimin e
4 tepërt dhe të padiskriminuar të forcës nga forcat serbe,
5 kërkonte nga të gjitha palët që të jepnin fund konfliktit të
6 armatosur dhe që Republika Federative e Jugosllavisë të
7 urdhëronte tërheqjen e reparteve të sigurimit.

8 Ju dëgjoj, i nderuar Gjykatës.

9 Dhe u kërkoj ndjesë përkthyesve dhe do përpiqem që të
10 flas më ngadalë.

11 Respektimi i Rezolutës 1199 i takonte misionit verifikues
12 për Kosovën të krijuar në vitin 1998.

13 Mirëpo, ndodhi sërish një tjetër masakër në Reçak në
14 janar të vitit 1999 cila e vuri në rrezik Misionin Verifikues
15 të Kosovës, MVK-në dhe çoi në fillimin e konflikte të tjera të
16 armatosura nga forcat serbe.

17 Do të shohim videon nga Reçaku ku u vranë 41 [sipas
18 përkthimit] vetë.

19 [Luhet videoincizimi]

20 PËRKTHYESI: "Folësi: Shtëpitë në fshatin e Reçakut ende
21 duke nxjerrë tym të shtunën, një ditë pasi forcat serbe
22 filluan një sulm kundër luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të
23 Kosovës separatiste. Vëzhguesit ndërkombëtarë, të udhëhequr
24 nga William Walker, që është amerikan, thonë se janë
25 ekzekutuar 45 civilë nga forcat serbe. Fshatarët që shpëtuan

1 gjallë thonë se policia serbe i veçoi ata nga familjet e tyre
2 të premtën dhe i çuan mbi një kodër ku edhe i pushkatuan. Të
3 gjithë të vdekurit ishin me tesha civile. Përfshirë këtu një
4 vajzë të re, një djalë 12 vjeçar dhe shumë pleq të tjerë”.

5 PËRKTHYESI: “Willim Walker: Fatkeqësisht, nuk gjej dot
6 fjalët për të përshkruar neverinë që ndjej nga gjithë kjo që
7 pashë në një vend, e cila mund të përshkruhet si një krim për
8 të cilin nuk mund ta përshkruash dot”.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Këto krime të rënda u pasuan me akte
10 të tjera kriminale nga forcat serbe. Por, në fakt, çuan në një
11 mbledhje urgjente të ministrave të Grupit të Kontaktit në
12 Londër më 29 janar të vitit 1999.

13 Grupi i Kontaktit e dënoi masakrën e Reçakut dhe u bëri
14 thirrje palëve që të vijnë në Rambuje në mënyrë që “t’i jepej
15 fund spirales së dhunës që po shkon drejt një katastrofe të re
16 humanitare dhe një lufte të përgjithshme”. Jo vetëm që po
17 çonte kjo në një katastrofë të re humanitare dhe luftë të
18 përgjithshme, por po çonte dhe në shkatërrimin e një strukture
19 të perceptueshme apo të imagjinueshme brenda UÇK-së.

20 NATO-ja shprehu gatishmërinë e vet “për të marrë të
21 gjitha masat e nevojshme” nëse palët nuk do të përmbushnin
22 kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare.

23 Dhe kështu kemi ardhur në konferencën e Rambujesë të
24 shkurtit 1999. Z. Thaçi ishte përzgjedhur si udhëheqës i
25 delegacionit shqiptar, por e vërteta është që z. Thaçi, i cili

1 aso kohe jetonte në Zvicër, nuk kishte kontroll mbi UÇK-në.
2 Hashim Thaçi nuk mund ta nënshkruante marrëveshjen e Rambujesë
3 pa pëlqimin e komandantëve të zonave dhe komandantët e zonave
4 kishin kaq shumë pushtet sa që ata shkarkuan komandantin e
5 përgjithshëm Azem Sylën ndërkohë që Hashim Thaçi ndodhej në
6 Rambuje.

7 Dhe nëse mund të shtoj këtu, jo vetëm Hashim Thaçi
8 ndodhej në Rambuje edhe Azem Sylë ndodhej aty.

9 Pra, për të dhënë kontekstin: Hashim Thaçi ndodhet në
10 Rambuje edhe Azem Sylë edhe anëtarë të tjerë të UÇK-së,
11 përfshirë edhe z. Krasniqi, aso kohe Azem Sylë ishte komandant
12 i përgjithshëm i UÇK-së.

13 Dhe pa i marrë mendim Hashim Thaçit apo Azem Sylës apo
14 askujt tjetër që ishte pjesë e delegacionit të UÇK-së, Azem
15 Sylë u shkarkua si komandant dhe u zëvendësua nga komandant
16 Sylejman Selimi.

17 Kjo na qenka struktura komanduese që paska pushtet
18 efektiv komandues dhe kontrollues në të gjitha qendrat e
19 ndalimit të cilat i përshkroi ZPS-ja dje. Mjafton sikur ky
20 fakt, që Trupi Gjykses të arrijë në përfundimin se nuk ka
21 pasur strukturë komanduese dhe kontrolluese nga z. Hashim
22 Thaçi apo askush tjetër që ishte pjesë e delegacionit në
23 Rambuje mbi bazën në terren.

24 Ai thjesht nuk kishte kontroll efektiv mbi UÇK-në, nuk
25 kishte as pushtetin përfundimtar mbi atë që quhen "politiks"

1 në anglisht dhe "policy" që është politik në UÇK. Provat nga
2 Rambujeja tregojnë se Hashim Thaçi nuk e kishte mundësinë që
3 të parandalonte apo ndëshkonte krimet që ndodhnin nëpër zona.
4 Dhe siç e vura re, megjithëse Hashim Thaçi ishte i zgjedhur si
5 udhëheqës i delegacionit shqiptar, pushteti real u takonte
6 komandantëve të zonave.

7 Këtu, të nderuar Gjykatës, kam paraqitur delegacionet.
8 Anëtarët e LDK-së, z. Rugova, kryeministrin Bukoshi, kishte
9 anëtarë të LBD-së dhe, sigurisht, kishte dhe anëtarë të UÇK-së
10 dhe persona të pavarur. Kam nënvijëzuar që Azem Syla ndodhej
11 aty, se aso kohe ishte komandant i përgjithshëm kur ishte në
12 Rambuje. Por, fatkeqësisht, nuk ishte më komandant i
13 përgjithshëm i UÇK-së kur u largua nga Rambujeja, pra, vajti
14 komandat i përgjithshëm dhe iku jo komandat i përgjithshëm.
15 Pra, këto janë përfaqësuesit në Rambuje.

16 Kundërshtimi i zjarhtë për pjesëmarrjen dhe angazhimin e
17 tyre nga disa fraksione të UÇK-së, përfshirë komandantët e
18 zonave dhe diaspora shqiptare. Siç e përmenda, mu në mes të
19 negociatave të Rambujesë, Azem Syla u shkarkua nga posti i vet
20 dhe u zëvendësua me Sylejman Selimin si komandant i
21 përgjithshëm i UÇK-së dhe këto zhvillime u mbështetën
22 publikisht nga Adem Demaçi.

23 Do të flasim edhe për Adem Demaçin dhe pushtetin që Adem
24 Demaçi ushtronte brenda UÇK-së, por dua të them, që dje katër
25 orë, në katër orë deklarata hyrëse të ZPS-së, nuk u përmend

1 asnjëherë emri i "Adem Demaçit", në asnjë kontekst, pra, nuk u
2 përmend që të kishte ndonjë farë pushteti brenda UÇK-së.

3 Mjafton të themi që ky vendim për heqjen e Azem Sylës u bë pa
4 u konsultuar as me Azem Sylën, as me Hashim Thaçin.

5 E megjithatë, dje qëndruam katër orë duke dëgjuar për një
6 varg qendrash ndalimi, argumente të tjera pa përmendur
7 asnjëherë faktin se personi, komandanti i përgjithshëm i UÇK-
8 së, u shkarkua, u hoq, pa marrë mendim të atyre personave që
9 ndodheshin në Rambuje dhe që flisnin në emër të UÇK-së.

10 Po kush i komandonte dhe i kontrollonte këto qendra
11 ndalimi? Për mendimin tim është shumë e qartë. Ishin personat
12 në nivel lokal, komandantët e zonave dhe vartësit e tyre.

13 Dhe sa i takon aftësisë së Hashim Thaçit për të
14 nënshkruar marrëveshjen e Rambujesë, kjo vihej në dyshim nga
15 një sërë faktorësh. Faktori i parë është se duhej që të
16 ekzistonte një farë aprovimi nga Adem Demaçi. Adem Demaçi
17 ishte përfaqësuesi i përgjithshëm politik i UÇK-së dhe
18 autoriteti suprem politik i UÇK-së.

19 Gjatë konferencës në Rambuje, Hashim Thaçi u largua nga
20 Rambujeja për të shkuar në Slloveni që të merrte miratimin dhe
21 mbështetjen e Demaçit. Sekretarja e Shtetit e SHBA-së Albright
22 i bëri thirrje Demaçit ta mbështeste Rambujenë. Por ai refuzoi
23 në mënyrë kategorike. Demaçi ishte kundër pjesëmarrjes dhe
24 nënshkrimit të marrëveshjes së Rambujesë sepse nuk përfshinte
25 pavarësinë e Kosovës.

1 Pa thënë se z. Thaçi u kthye në Rambuje për të diskutuar
2 çështjet me drejtuesit ndërkombëtarë që më pas i ushtruan
3 trysni që të nënshkruante marrëveshjen e Rambujesë që në fund,
4 në fakt, nuk e bëri.

5 Mund të shohim videon tjetër.

6 [Luhet videoincizimi]

7 PËRKTHYESJA: "Albright: Ministrat e jashtëm u ulën në një
8 tavolinë të gjatë, tha, thuajse ishin në gjykim apo diçka të
9 ngjashme dhe fillimisht Thaçi erdhi me disa anëtarë të tjerë
10 të delegacionit shqiptar. Pyetja ishte a e pranoni kornizën po
11 a jo, ne prisnim një 'po'. Ose të paktën unë. Unë thashë,
12 shiko, nuk e kuptoj çfarë ndodhi këtu, na zhgënjyet. Është
13 situatë e pamundur. Si na e bëtë këtë? Ne prisnim që ju të
14 ishit udhëheqës".

15 "Hashim Thaçi: Madeleine Albright ka deklaruar se po qe
16 se ju nënshkruani, serbët nuk nënshkruajnë, ne do të
17 bombardojnë. Ne do të aktivizohemi. Po qe se ju nuk
18 nënshkruani, serbët e pranojnë, ne i kemi duart e lidhura".

19 "Albright: Mund ta shihni që ishte shokuar. Dukej si një
20 gjimnazist që e kisha qortuar".

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Pra, dukej si një nxënës gjimnazi që
22 unë e kisha qortuar". Dhe ky personi i ZPS-së, që sipas tyre
23 ka bërë të gjitha këto, ka spiralar këto përpjekjet edhe na
24 përshkruhet nga Sekretarja e Shtetit si një nxënës që e kishte
25 qortuar.

1 Dhe kishte një arsye në fakt, pse nuk donte ta
2 nënshkruante. Keni parasysh, të nderuar Gjykatës që nëse nuk
3 shkruanin marrëveshjen e Rambujesë, NATO-ja nuk do ndërhynte.
4 Nëse do të nënshkruanin atëherë do të fillonte fushata e
5 bombardimit. Pra, steka ishte e lartë.

6 Hashim Thaçi hezitonte, hezitonte të nënshkruante kushtet
7 e marrëveshjes dhe ne do ju a themi dhe pse-në.

8 Po do të shkojmë në diapozitivin tjetër.

9 [Luhet videoincizimi]

10 PËRKTHYESJA: "Dublimi: Znj. Albright kishte besim se z.
11 Thaçi do t'i pranonte kushtet e marrëveshjes ndonëse i
12 premtuan Kosovës autonomi vetëm brenda Serbisë dhe jo
13 pavarësinë për të cilën po luftonte UÇK-ja. Po ajo s'e kuptoi
14 trysninë që i ushtrohet drejtuesit të UÇK-së nga vendi i vet".

15 "Remi Komandanti i UÇK-së: Me negociatorët që janë kanë
16 aty edhe ju kemi kërcnue se nuk guxoni me nënshkrue".

17 "Hashim Thaçi: Por edhe në Kosovë ishte krijuar një
18 opinion se gjoja atje delegacioni shqiptar është duke
19 tradhtuar".

20 "Komandanti i UÇK-së Remi: Dhe më kujtohet si sot kur
21 njënit prej tyre i kam thënë që 'Ju e dini që kemi raketa
22 kundër-ajrit dhe do t'i ruajmë ato raketa s'do t'i përdorim me
23 serb. Po aeroplan në ju po zbritën në Sllatinë do ta rrëzojmë,
24 nëse e nënshkruani".

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Pra, komandanti i zonës operative me

1 emrin Remi tha, nëse ata guxonin të nënshkruanin do të
2 luftonin me antiajror.

3 Dhe këto kërcënime nuk erdhën vetëm nga komandantët e
4 zonave dhe nuk ishin vetëm kërcënime imagjinare të cilat i
5 sajoi Hashim Thaçi në Rambuje, po janë të reflektuara edhe në
6 librin e Ambasadorit Christopher Hill, Ambasador i lartë i
7 këtij delegacioni gjatë marrëveshjes së Rambujesë në shkurt të
8 1999.

9 Ai shkroi një libër, ku flet për këto bisedat që ka bërë
10 me Thaçin lidhur me këtë aspekt konkret.

11 Ai pyet:

12 “‘Pse s’e pranoni?’ e pyeta Thaçin, vërtetë s’po e
13 kuptoja nëse ai e realizonte pasojat gati fatale që do të
14 kishte për Kosovën përgjigja ‘jo’.

15 “‘Ti, nuk po më kupton’ u përgjigj ai. ‘Në qoftë se unë
16 pranoj, do kthehem në shtëpi dhe do më vrasin’”.

17 Kërcënimet forcohen edhe më tej nga një komandat tjetër i
18 zonës dhe komandanti i përgjithshëm i UÇK-së, Sylejman Selimi.
19 Ai thotë në një libër të vetin:

20 “Herën e parë, siç ju thashë, i kërcënuam që të mos e
21 bënin nënshkrimin e marrëveshjes së Rambujesë. I kërcënuam se
22 nëse do të shkruanin diçka pa e marrë vesh ne, që do të thotë
23 të gjithë komandantët e zonave, pra, personat që kishin dhe
24 barrën dhe peshën e luftës atëherë ... do të kishte pasoja”.

25 Nuk po diskutoj tani se një pjesë i keni dëgjuar dje, të

1 nderuar Gjykatës, por Hashim Thaçi nuk kontrollonte UÇK-në. Në
2 fakt e kontrollonin komandantët e zonave. Dhe këtu mund të
3 shohim komentet që ka bërë senatori Biden, aso kohe ishte
4 senator, para senatit, bëri një takim në korrik të 1999 me
5 Hashim Thaçin dhe bëri këto komente para Komisionit të
6 Marrëdhënieve të Jashtme në vitin 1998, më 26 shtator. Dhe
7 mund të shihni këtu që Thaçi po përpigëj të përparonte
8 pozicionin e UÇK-së dhe t'i jepte fund luftës. Ai thotë:

9 "Mua më duket se bombardimet funksionuan dhe ndonëse z.
10 Thaçi më thotë, se u takova për disa orë me të, sesi ai veproi
11 në fakt - më falni komentin këto, "janë gjepura". Nuk e besoj
12 që e ka thënë këtë koment në fakt para komisionit. Por "ishte
13 një proces pa prova. Asnjë farë prove".

14 Sepse UÇK-ja u shkatërrua gjatë kësaj kohe.

15 "Ai mbase po flet për 1500 luftëtarë, jo 10.000. Z. Thaçi
16 më thotë, "Jeni 29 vjeç. Ishit 29 vjeç sa ç'jam unë tani. A ke
17 ndonjë këshillë për mua?" dhe unë ia thashë 'Po unë isha në
18 rrethana të tjera'. Ai tha 'Cila është këshilla juaj?'. I
19 thashë 'Numër 1, mos e merr veten shumë seriozisht. Dhe, numër
20 2, të kuptoni se ... unë e di që ti e di që nuk e kontrollon
21 ti UÇK-në'".

22 Diapozitivi i radhës.

23 Pavarësisht presionit të jashtëzakonshëm, Hashim Thaçi
24 nuk nënshkroi pa miratimin e komandantëve të zonave.

25 Keni parasysh, të nderuar Gjykatës, se kemi dy lëshime

1 kryesore që bënë Shtetet e Bashkuara. Së pari, brenda tre vite
2 vullneti i popullit do të merrej parasysh në një referendum.
3 Dhe kjo siguri është përcjellë në një letër, draftletër po e
4 themi, nga delegacioni amerikan. Së dyti, UÇK-ja do të kryente
5 një proces transformimi, që do të thotë duhet ta transferonte
6 ushtrinë në forcë civile për ta theksuar dhe më shumë
7 presionin që pati z. Thaçi për të nënshkruar.

8 Sekretarja e Shtetit Albright caktoi një takim me
9 delegacionin shqiptar dhe gjeneralin e NATO-s Wesley Clark,
10 që ishte komandanti i forcave aleate për NATO-n aso kohe.

11 Përkundër këtyre lëshimeve dhe presioneve nga bashkësia
12 ndërkombëtare dhe delegacionin shqiptar, sepse kishte dhe të
13 tjerë në delegacionin shqiptar që donin të nënshkruanin, Thaçi
14 nuk pranoi ta jepte për miratim përfundimtar pa marrë pëlqimin
15 e komandantëve të zonave.

16 Delegacioni shqiptar u kthye në Kosovë pas konferencës së
17 Rambujesë për të marrë miratimin e komandantëve të zonave dhe
18 segmenteve të tjerë të shoqërisë së Kosovës. U takua me
19 komandantë të zonave dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së t'u
20 shpjegonin marrëveshjen dhe të merrnin pëlqimin e tyre.

21 Shumë nga komandantët e zonave nuk u bindën, por si
22 përfundim nuk e kundërshtuan nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje
23 sepse kishin frikë se do humbitnin mbështetjen nga komuniteti
24 ndërkombëtar, përfshirë NATO-n edhe nga popullata, nga civilët
25 të cilët po vuanin. Kjo është në atë kohë UÇK-ja ishte

1 pothuajse e shpërbërë edhe po bëhej gjithnjë e më shumë.

2 Për më tepër ata u bindën nga letra e Sekretares së
3 Shtetit së ShBA-së Albright e cila u premtonte një referendum
4 për pavarësinë në tre vjet dhe se UÇK-ja nuk do të shpërbëhej
5 por thjesht do të transformohej. U kthye në Paris, në 18 mars
6 të 1999 dhe u nënshkrua marrëveshja.

7 Tani nëse mund të flasim për Qeverinë e Përkohshme të
8 Kosovës, se u komentua dje nga ZPS-ja se Qeveria e Përkohshme
9 e Kosovës erdhi në momentin që kishte një vakum pushteti dhe
10 se që Qeveria e Përkohshme e Kosovës, me z. Thaçi si të
11 ashtuquajtur Kryeministër, po përpiqej të merrte nën kontroll
12 Kosovën. Kjo s'është aspak e vërtetë, as nga ana faktike, as
13 nga ana ligjore.

14 Dhe le t'i kthehemi dhe të flasim për këtë vakum pushteti
15 për të cilën flet ZPS-ja. Kur u formua Qeveria e Përkohshme e
16 Kosovës, apo ideja, e të pasurit një qeveri të përkohshme?
17 Natyrisht në Rambuje.

18 Gjatë negociatave në Rambuje, Sekretarja e Shtetit
19 Albright dhe liderë të tjetër evropianë kërkuan që të krijohet
20 një strukturë e unifikuar, inkurajuan të kishte një strukturë
21 të unifikuar për të folur në emër të shqiptarëve të Kosovës
22 dhe për të qenë partneri zbatues për marrëveshjen e Rambujesë
23 me OSBE, KVM dhe NATO-n.

24 Keni parasysh, të nderuar Gjykatës, në këtë pikë
25 s'diskutohej fare UNMIK-u. UNMIK-u as ishte krijuar edhe në

1 shkurt të 1999, as nuk ishte hedhur si ide.

2 Marrëveshja e Rambujesë -- më falni, Qeveria e Përkohshme
3 e Kosovës do të ishte një strukturë gjithëpërfshirëse dhe nuk
4 do të kishte vetëm anëtarë të UÇK-së por dhe anëtarë të LDK-së,
5 si dhe të LBD-së.

6 Para jush keni dhe marrëveshjen që është në shqip dhe në
7 diapozitivin tjetër kemi dhe përkthimin dhe këtu është
8 nënshkruar nga Hashim Thaçi për UÇK-në, Dr. Ibrahim Rugova për
9 LDK-në dhe për LBD-në, Rexhep Qosja.

10 Kjo supozohet të ishte një Qeveri e Përkohshme e cila do
11 të ishte në fuqi derisa të ishin zgjedhjet e para të lira dhe
12 do të kishte përfaqësi të barabartë nga të gjitha grupet.

13 Pra, Qeveria e Përkohshme e Kosovës nuk ishte një plan i
14 Hashim Thaçi apo ndokujt tjetër nga ana e shqiptarëve të
15 Kosovës për të shfrytëzuar vakumin e pushtetin dhe për të
16 marrë kontrollin e vendit. Përkundrazi, edhe pasi serbët
17 refuzuan ta nënshkruanin marrëveshjen e Rambujesë dhe LDK-ja u
18 tërhoq nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës, Shtetet e Bashkuara
19 donin që të kishin një qeveri të përkohshme në mënyrë që kjo
20 qeveri të funksiononte në harmoni me subjektet ndërkombëtare
21 që vepronin në terren.

22 Sekretarja e Shtetit tha më 12 prill 1999:

23 "Sekretarja Albright theksoi nevojën për një qeveri të
24 përkohshme të Kosovës me bazë të gjerë. Ishte mirë që kishte
25 dhe vende për LDK-në dhe ishte e rëndësishme të vazhdojmë të

1 komunikojmë me Rugovën. Ndonëse e njohëm Qeverinë e Përkohshme
2 sigurisht do të kishim dashur që të punonim me të në
3 praktikë”.

4 Pra, çfarë mesazhi marrin ne nga ky informacion për këtë
5 Qeveri të Përkohshme të Kosovës? Kjo qeveri ishte një qeveri,
6 një partner gjithëpërfshirës, zbatues me komunitetin
7 ndërkombëtar. Kishte për synim të ishte një qeveri me bazë të
8 gjerë që përfshinte të gjitha subjektet politike të
9 shqiptarëve të Kosovës. Nuk ishte krijuar që UÇK-ja të merrte
10 me forcë kontrollin e Kosovës duke shënjestruar kundërshtarët
11 dhe marginalizuar partitë e tjera politike. Dhe nuk u krijua
12 për të shfrytëzuar citoj “vakumin e pushtetit” që tha ZPS-ja.

13 Përkundrazi, me nxitjen e SHBA-së dhe ndërkombëtarëve,
14 shërbeu si korniza bazë mbi të cilën subjektet ndërkombëtare
15 do të rindërtonin infrastrukturën civile për Kosovën në
16 bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar. Puna filloi para se
17 të përfundonte lufta dhe filluan të punonin me çiltërsi me
18 subjektet -- në të vërtetë punonin me subjektet ndërkombëtare
19 pas luftës.

20 Me tërheqjen e forcave serbe dhe themelimin e UNMIK-ut -
21 do të flasim dhe për themelimin e UNMIK-ut pak më vonë për
22 një çast - Qeveria e Përkohshme e Kosovës u përpoq të
23 lehtësonte kthimin e refugjatëve, të ndihmonte në mbështetjen
24 civile për komunat në vend e cila do të përfshinte shpërndarje
25 ushqimi, gjendjen e vendeve për të jetuar, arsimin, shërbimet

1 komunale si dhe funksione të tjera civile.

2 Qeveria e Përkohshme e Kosovës nuk kishte asnjë formë
3 kontrolli mbi strukturat ushtarake. Kjo ishte nën autoritetin
4 e komandantit të KFOR-it gjenerali Michael Jackson dhe
5 komandantit të UÇK-së gjeneralin Agim Çeku.

6 Edhe në arenën pas luftës, Qeveria e Përkohshme e Kosovës
7 ishte vetëm një, nga disa qeveri që konkurronin për mbështetje
8 popullore në Kosovë përfshirë edhe qeverinë e përkohshme
9 Rugova, Bukushi dhe një post të qeverisë serbe.

10 Por, a mund të flasim për një moment, për vitin 1999 për
11 fushatën e spastrimit etnik serb dhe ç'i bëri kjo strukturës
12 së komandës dhe kontrollit të UÇK-së. Ajo që i bëri strukturës
13 së komandës dhe kontrollit të UÇK-së në të gjitha format apo
14 disa nga format që diskutoi ZPS-ja dje, sepse ZPS-ja dje nuk e
15 trajtoi këtë aspekt.

16 Mos u ngatërroni plani i autoriteteve serbe ishte
17 spastrimi etnik, ta spastronin Kosovën nga shqiptarët e
18 Kosovës.

19 Edhe shkojmë në diapozitivin tjetër.

20 [Luhet videoincizimi]

21 PËRKTHYESJA: "Folësi: Parlamenti i Serbisë refuzon.
22 Kryeministri i Serbisë tha atë që planifikonte të bënte më pas
23 Milosheviçi. Nëse NATO-ja na bombardon, ne do të kemi viktima
24 por nuk do të mbetet asnjë shqiptar në Kosovë.

25 Kryeministri i Serbisë tha çfarë do të bënte më pas

1 Milosheviçi nëse NATO-ja na bombardon, ne do të kemi viktima
2 por nuk do të mbetet ama asnjë shqiptar nuk do të mbetet në
3 Kosovë”.

4 [Luhet videoincizimi]

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Pra, “Fushata e bombardimit vazhdon,
6 do të kemi pasoja ne tha, ne do kemi disa viktima tha ama në
7 Kosovë s’do të mbetet këmbë shqiptari.

8 Dhe fushata vazhdoi nga 24 marsi i 1999 deri në 9
9 qershor. Ka të drejtë z. Seseli, sepse vazhdoi spastrimi etnik
10 edhe gjatë fushatës. Ne e thamë edhe më parë, rreth 800,000
11 shqiptarë u dëbuan drejt vendeve të tjera dhe 500,000 u
12 zhvendosën brenda vendit. U dogjën shtëpi, u vranë njerëz, u
13 helmuan burimet ujore. Qëllimi i fushatës serbe ishte të mos
14 lejonin popullatën e Kosovës të kthehej më në vendet e tyre
15 dhe në fshatrat e tyre në Kosovë dhe depërtimi i këtyre
16 individëve ishte në shkallë masive, ishte masiv.

17 Dhe do të shikojmë videon tjetër.

18 [Luhet videoincizimi]

19 PËRKTHYESJA: “Alan Little: Në terren, kaosi po fshinte
20 vendin dhe po i afrohej kryeqytetit. Nuk ndryshoi asgjë nga
21 bombardimet e NATO-s, policia e armatosur dhe paramilitarët
22 filluan të mbillnin terror mes civilëve përgjatë udhëtimit të
23 tyre”.

24 PËRKTHYESJA: “Gjeneral Nebojsa Pavkovic: Nuk mund t’i
25 lejonin sulmet nga ana e policisë apo ushtrisë brenda Kosovës.

1 Kur filloi NATO-ja të sulmonte shënjestrat civile, pati një
2 zhvendosje masive të popullsisë jashtë Kosovës. Kjo nxiti
3 pastaj që ne të bënim dislokimet tona në pozicione mbrojtëse”.

4 PËRKTHYEJA: “Alan Little: Automjetet e blinduara të
5 policisë filluan të patrullonin në rrugë dhe popullit i dhanë
6 pak orë për t’u larguar. Këto janë marrë fshehurazi këto
7 fotografi nga një fotograf shqiptar”.

8 PËRKTHYESJA: “Gjenerali Nebojsa Pavkovic: U përpoqëm t’i
9 shkuraionim ndonjëherë dhe ja dolëm mbanë. Një numër i madh
10 qëndruan në Kosovë dhe u mbrojtën prej forcave tona.

11 PËRKTHYEJA: “Alan Little: E gjithë bota mund ta shihte që
12 kjo ishte një gënjeshtër. Njësitet e gjeneral Pavkovic, në
13 fakt, po organizonin një nga programet më të mëdha dhe
14 deportimit në Evropë që prej Luftës së Dytë Botërore. Ky është
15 një imazh që të ngjall të njëjtën kujtime si dhe lufta nga
16 nazistët”.

17 PËRKTHYESJA: “Gjenerali Wesley Clark: E dinim që do të
18 kishte disa përpjekje për të marrë shpagim, po nuk e
19 parashikuam asnjëherë që do të ishim të përlllogaritur në një
20 formë të tillë që do të krijonin një fluks kaq të madh
21 refugjatësh.

22 PËRKTHYESJA: “Alan Little: Ishte e pabesueshme përmasa e
23 saj. Milosheviçi e kishte rritur në mënyrë dramatike stekën”.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] E gjithë kjo fushatë e spastrimit
25 etnik ishte pjesë - dhe e diskutuar tek gjykimi i

1 Milutinoviçit dhe mund të shohim këtu - ku gjykatës Bonomy,
2 është një pjesë e përmbledhjes kjo në aktgjykimin e
3 Milutinoviç:

4 "Dëshmia më bindëse në mbështetje të pretendimit se
5 kishte një qëllim të përbashkët për të modifikuar ekuilibrin
6 etnik në Kosovë për të siguruar kontroll të vazhdueshëm nga
7 RFJ-ja dhe autoritetet serbe mbi krahinë janë disa nga provat
8 që vërtetojnë fushatën e përhapur të dhunës që ishte drejtuar
9 dhe shënjestronte popullsinë shqiptare të Kosovës mes marsit
10 dhe qershorit 1999 dhe solli shpërngulje masive të kësaj
11 popullsie".

12 Po, në fakt, çfarë pasojash pati kjo mbi UÇK-në dhe
13 strukturën e komandës dhe kontrollit të UÇK-së?

14 Shkurtimisht, aftësia luftarake e UÇK-së u gjymtua, u
15 cungua, si rezultat i fushatës së spastrimit etnik të Serbisë.
16 Furnizimet për UÇK-në u ndërpreu dhe, sigurisht, që ra dhe
17 morali i pjesëtarëve të UÇK-së. Shumica e anëtarëve të UÇK-së
18 brenda Kosovës lanë njësitet e tyre, për arsye të mira, të
19 forta, për të shoqëruar familjet e tyre ishin dëbuar nga
20 banesat e fshatrat e tyre.

21 Dhe theksoj, të nderuar Gjykatës, kjo ishte një ushtri
22 vullnetare, luftëtarë vullnetarë, njerëz iknin e dilnin siç
23 dëshironin.

24 Ofensiva serbe shkatërroi njësitet individuale të UÇK-së
25 dhe dëmtoi strukturën e komandës së UÇK-së në atë pikë sa që

1 pjesa më e madhe e Shtabi i Përgjithshëm të UÇK-së ikën nga
2 Kosova. Gjatë gjithë kësaj periudhe kohore, pra, i gjithë vetë
3 Shtabi i Përgjithshëm nuk ishte më në Kosovë, pothuajse i
4 gjithë shtabi.

5 Ofensiva serbe e dyta, ofensiva e dytë serbe - jo e 1998,
6 tani po flasim për fushatën masive të vitit 1999 - pengoi çdo
7 mundësi që UÇK-ja të vepronte apo të funksiononte si një njësi
8 e bashkuar. Pra, kjo i ndodhi UÇK-së teksa shpaloseshin këto
9 ngjarje dhe ju dëgjuat dje të gjitha këto prova nga ZPS-ja mbi
10 ato ngjarje që ndodhën në terren. S'ishte strukturë komande të
11 UÇK-së dhe me siguri nuk kishte strukturë efikase.

12 Për një moment do të ndërrojmë temën, folëm për
13 përfundimin e konfliktit të armatosur.

14 Diapozitivi i radhës, ju lutem.

15 Pas 78 ditësh bombardimesh, NATO-ja u përgatit për luftën
16 në terren me Milosheviçin, zgjodhi pastaj, vendosi t'i jepte
17 fund luftimeve në Kosovë.

18 Më 3 qershor të vitit 1999, parlamenti serb konfirmoi
19 vendimin për t'i dhënë fund konfliktit të armatosur.

20 Më 9 qershor, Serbia nënshkroi marrëveshjen e Kumanovës
21 me KFOR-in ku parashikoi që të gjitha forcat serbe duhet të
22 largoheshin nga Kosova jo më vonë se 20 qershori 1999.

23 Edhe hyri në fuqi ditën tjetër Rezoluta e Këshillit të
24 sigurisë së OKB-së 1244. Kombet e Bashkuara morën
25 përgjegjësinë për të ruajtur rendin publik. Përgjegjësia e

1 tyre, në kuadër të kapitullit 47 të Rezolutës ishte:

2 “(i) sigurimi ... i rendit publik, të krijonin një forcë
3 policore dhe ndërkohë të shkonte personel civil në Kosovë;

4 “(j) Të mbronte dhe të inkurajonte të drejtat e njeriut;
5 dhe,

6 “(k) Të siguronin kthimin e sigurtë të të gjithë
7 refugjatëve dhe personave që ishin dëbuar nga shtëpitë tyre në
8 Kosovë”.

9 Me përfundimin e luftës, mbërrin KFOR-i më 12 qershor
10 1999 në Kosovë i cili u ndoq nga personeli civil i UNMIK-ut të
11 nesërmen, më 13 qershor.

12 Më 20 qershor 1999, forcat serbe tërhiqen nga Kosova në
13 zbatim të marrëveshjes së Kumanovës.

14 Më 21 qershor UÇK-ja dhe KFOR-i nënshkruan zotimin apo
15 marrëveshjen për të filluar demilitarizimin apo çarmatimin e
16 UÇK-së. Ky zotim u nënshkrua me KFOR-in dhe grupe të tjera të
17 armatosura si FARK-u. FARK-u ishte dega e armatosur e LDK-së.
18 Me nxitjen e Shteteve të Bashkuara, Hashim Thaçi nënshkruan
19 zotimin, pas nënshkrimit të këtij zotimi e përgëzon Presidenti
20 Klinton për këtë.

21 Më 24 qershor 1999, parlamenti serb heq gjendjen e
22 luftës. Dhe këtu në këtë moment, pa marrë parasysh pretendimet
23 e ZPS-së, pavarësisht çka thotë ZPS-ja - më falni- përfundoi
24 lufta. Nuk u shtri deri në shtator të 1999 kjo luftë.

25 Po çfarë ndodhi? Çfarë bëri UNMIK-u kur e mori përsipër

1 situatën në mbështetje të rezolutës 1244?

2 Kjo është hera e parë që OKB-ja kishte krijuar një prani
3 ndërkombëtare civile dhe të sigurisë të mandatuar sipas
4 rezolutës 1244 për të pasur kontroll të plotë mbi funksionet
5 gjyqësore, ligjore, të sigurisë dhe ato administrative. Nuk
6 ishte një mision paqeruajtës i zakonshëm ky. Ishte një
7 sipërmarrje e paprecedentë nga ana e OKB-së për nga përmasat
8 dhe kompleksiteti që kishte.

9 UNMIK-u kishte mandatin të krijonte sundimin e ligjit dhe
10 të rikthente institucionet e Kosovës, pra, institucionet e
11 vetëqeverisjes në Kosovë. Ishte e lehtë? Jo. Madje, ishte
12 shumë e vështirë, siç duket edhe nga komentet që ka bërë
13 gjenerali Clark dëshmia që ka dhënë para Komisioneve të
14 Shërbimeve të Armatosura të Senatit më 2 shkurt 2000:

15 "Dallimi mes Bosnjës dhe Kosovës është se ... kishim të
16 bënim me fraksione të organizuara qeveritare në Bosnje. Kishte
17 polici, kishte zyrtarë, kishte struktura që të kishim një
18 bazë.

19 "Nuk ka pasur asnjë mision në Kosovë.

20 "Atje nuk ka struktura qeveritare. Nuk ka polici lokale.
21 Nuk ka as ndonjë rrjet të ndonjë partie komuniste që të paktën
22 t'i mbante të gjithë deri diku të frikësuar dhe të vepronte si
23 një qeveri nën hije.

24 "Në vend të kësaj, kemi një milion pikë gjashtë njerëz që
25 kanë hedhur sytë nga Kombet e Bashkuara për udhëheqjen e tyre

1 civile totale dhe kërkojnë nga KFOR-i stabilitet, autoritet,
2 rend dhe mbrojtje derisa të krijohen strukturat civile”.

3 Kur mbërriti UNMIK-u më 13 qershor 1999, Kosova nuk
4 kishte institucione të sigurisë dhe institucione civile. As
5 ligje, as gjykata, as struktura komunash, as shoqëri civili,
6 as shërbime komunale. Ç’ndodh në një mjedis të tillë?

7 Në këtë mjedis pa ekzistencën e ligjit, me qindra e
8 mijëra kosovarë të dëbuar u kthyen dhe gjetën shtëpitë që u
9 ishin shkatërruar, u kishin marrë pronat, të afërmit ishin
10 zhdukur, kishin vdekur dhe s’kishte institucione. Dhe
11 sigurisht që kërkonin hakmarrje.

12 Aktet e lokalizuara të dhunës individuale të nxitura nga
13 zemërimi, urrejtja dhe mungesa e llogaridhënies ishin të
14 pashmangshme dhe shpesh shkaktoheshin nga kriminelët, elementë
15 keqbërës të UÇK-së dhe njerëz që prezantoheshin si UÇK dhe
16 mbanin uniforma të blera në rrugët e Prishtinës e gjetkë.

17 Siç raporton edhe Grupi për Krizën Ndërkombëtare më 6
18 gusht 1999, UÇK-ja mohon “që të ketë pasur ndonjë fushatë të
19 organizuar që të synonte të krijonte një vend ku të kishte
20 vetëm shqiptarë të Kosovës”.

21 Dhe kjo ishte e besueshme, sigurisht, për shkak të
22 motivit të hakmarrjes dhe nuk kishte në fakt prova të
23 mjaftueshme për një fushatë të organizuar.

24 Dhe sigurisht që Pentagoni ishte në dijeni të kësaj. Ky
25 është Ken Bacon që flet në 5 qershor 1999, shkurtimisht

1 përpara se të përfundonte fushata e bombardimit dhe komentonte
2 se çfarë parashikonin ata, ç'mendonin ata se do të ndodhte në
3 fund të fushatës së bombardimit.

4 [Luhet videoincizimi]

5 PËRKTHYESJA: "Bacon: Është fakt që unë nuk mendoj që
6 Kosova do të jetë një vend shumë i lumtur për serbët kur të
7 vijë NATO-ja dhe nuk mendojnë që serbët duan të qëndrojnë
8 atje. Mendoj që ata do të duan që të kthehen në Serbi. Ne nuk
9 e dimë sesa i madh është minoriteti serb atje. Mund të jetë
10 ndoshta 100,000 mijë vetë, ose mund të jetë pak më tepër sesa
11 kaq. Por ndërkohë që shqiptarët e Kosovës do të kthehen
12 mbrapssh në vend ne prezumojmë që shumë prej serbëve do të
13 duan që të shkojnë në Serbi.

14 PËRKTHYESJA: "Pyetje: Duket sikur po i inkurajoni serbët
15 që të largohen nga Kosova?

16 PËRKTHYESJA: "Bacon: Jo, nuk po i inkurajoj fare. Thjesht
17 po them sesi janë faktet dhe çfarë parashikojmë ne që do të
18 jenë faktet më pas".

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Gjenerali Clark i tha këto komente
20 dhe gjithashtu foli me një gazetare lidhur me atë që po
21 mendohej që të bënte UÇK-ja.

22 Kështu që në qoftë se mund të kalojmë tek videoja tjetër.
23 Që është një video e 1 korrikut 1999.

24 [Luhet videoincizimi]

25 PËRKTHYESJA. "Jim Lehrer: Margaret Warner ka bërë një

1 intervistë me gjeneralin e forcave amerikane z. Wesley Clark
2 dhe ka folur me të sonte, në kapacitetin e tij si komandant i
3 NATO-s.

4 PËRKTHYESJA: "Margaret Warner: Mirë se erdhët, gjeneral.

5 PËRKTHYESJA: "Gjen. Wesley Clark: Faleminderit.

6 PËRKTHYESJA: "Margaret Warner: Dua t'ju pyes me misionin
7 e KFOR-it në Kosovë. Sekretarja e Shtetit Albright tha dje që
8 njerëzit në Kosovë, populli i Kosovës nuk janë të sigurtë.
9 Është e vërtetë kjo?

10 PËRKTHYESJA: "Gjen. Wesley Clark: Unë mendoj që kjo është
11 një periudhë e identifikimit që asaj se çfarë po ndodh. Ka
12 qindra e mijëra njerëz që po kthehen mbrapsht. Kanë ndodhur
13 gjëra të tmerrshme në atë vend. Ka gjithë gjërat e emocioneve
14 të mundshme që po i ndodhin njerëzve. Ndërkohë që ka edhe
15 serbë të cilët mendojnë që do të jenë fajtorë për shkak të
16 etnitetit të tyre. Ndërkohë, që ka romë të cilët po
17 diskriminohem. Kështu që ka disa përpjekje legjitime në mënyrë
18 që pronat t'i kthehen mbrapsht pronarëve. Është një periudhë
19 ku po merret hak. Është një periudhë ku po lahen hesapet.
20 Është një situatë shumë e vështirë. Ne po bëjmë çfarëdo që
21 është e mundur, po sigurisht që ne nuk mund të bëjmë dot
22 gjithçka, ne nuk jemi polici.

23 PËRKTHYESJA: "Margaret Warner: A mendoni që serbët do të
24 vazhdojnë që të largohen dhe nuk do të vijnë më mbrapssh, a
25 mendoni që do të ketë cenim të kredibilitetit lidhur me atë se

1 çfarë NATO-ja do të bëjë lidhur me luftën?

2 PËRKTHYESJA: "Gjen. Wesley Clark: Ne nuk e dimë sesi
3 pjesëmarrja popullore serbe në masakra -- si ka qenë situata.
4 Sesi ka qenë pjesëmarrja e popullsisë serbe. Mbase shumë
5 njerëz kanë ndihmuar ose kanë marrë pjesë në disa situata të
6 tilla të ndërlikuara me fqinjët e tyre ose kur kanë ndodhur
7 spastrimet etnike. Nuk e dimë. Sepse disa njerëz ndoshta mund
8 të largohen sepse mund ta konsiderojnë veten si shënjestra
9 reale për drejtësinë ndërkombëtare si dhe për hakmarrjen
10 shqiptare. Është e vështirë që të krijosh një situatë të
11 përgjithshme, ta gjeneralizosh ta përgjithësosh. Megjithatë
12 mendoj se lidërs hipi i UÇK-së ka kërkuar të njëjtën gjë.

13 PËRKTHYESJA: "Margaret Warner: A mendoni se kjo është e
14 vërtetë?"

15 PËKTHYESJA: "Gjen. Wesley Clark: Mendoj se po."

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Pra, flitet për një vend multietnik
17 në Kosovë dhe ky vendi multietnik lidhet me lidërs hipin e z.
18 Thaçi.

19 Të nderuar Gjykatës, besoj që e keni parë në këtë
20 periudhë kaq shumë delikate e keni parë se çfarë hapash ka
21 bërë z. Thaçi dhe çfarë fjalimesh ka bërë z. Thaçi përpara
22 njerëzve të vet dhe përpara popullit të vet dhe komunitetit
23 ndërkombëtar në mënyrë të tillë që të realizonte këtë pajtim
24 të paqtë. Personi nuk ishte ai që do të mbushte këtë hendekun
25 ose vakumin e pushtetit dhe nuk ishte kjo, në fakt, ajo çfarë

1 ndodhi në Kosovë.

2 Në të kundërtën dhe do të doja që të vazhdonim më tej me
3 disa çështje të tjera të cilat janë pjesë e prezantimit, është
4 që Hashim Thaçi ka mbështetur përpjekjet praktike në arenën
5 pas lufte në mënyrë të tillë që të promovohet toleranca
6 etnike.

7 Kur UNMIK-u për herë të parë erdhi në Kosovë pas 13
8 qershorit 1999, atëherë autoriteti për sigurinë publike në
9 Kosovë, nuk e kishte askush tjetër, po e kishte vetëm UNMIK-u,
10 në bazë të 1244. Përveç autoritetit pavarësisht autoritetit
11 ligjor, UNMIK-u nuk mund të parandalonte dhunën sepse
12 fillimisht nuk i kishte burimet. Ndërkohë nga ana tjetër KFOR-
13 i kishte burimet por nuk kishte as trajnimin ndoshta dhe as
14 dëshirën për të marrë funksione policore.

15 Ajo çfarë është e qartë - vijon me diapozitivin tjetër -
16 pra, ajo çfarë është e qartë është që UÇK-ja nuk kishte
17 kompetenca policimi. As UÇK-ja dhe asnjë organizatë tjetër
18 shqiptare kosovare nuk kishte kompetencë ligjore që të
19 funksiononte si forcë sigurie. Prezenca civile edhe e sigurisë
20 së UNMIK-ut nuk qëndroi mënjane. Dhe, në qoftë se, për
21 shembull, do të shikojmë seksionin 1.1 të Rregullores së
22 UNMIK-ut deklarohet që:

23 "Të gjithë autoritetet ligjore, legjislative dhe ekzekutive
24 sa i takon Kosovës, përfshirë dhe administratën dhe
25 gjyqësorin, i jepen UNMIK-ut..."

1 Kështu që Qeveria e Përkohshme e Kosovës nuk kishte asnjë
2 lloj kompetence për të arrestuar, për të futur në burg apo për
3 të bërë akte të tjera ligjore, të gjitha këto kompetenca i
4 përkisnin UNMIK-ut. Duke e ditur që kishte probleme në rrugët
5 e Prishtinës edhe të zonave të tjera të Kosovës, Hashim Thaçi
6 promovoi, dhe vijojmë këtu me diapozitivin e radhës, dhe
7 mbështeti forcën policore të Kosovës.

8 Përpara sesa të futemi këtu argumenti i ZPS në dosjen
9 paragjyqësore dhe në aktakuzën e tyre është se përmes këtij
10 vakumi pushteti, Qeveria e Përkohshme e Kosovës dhe Hashim
11 Thaçi, në një farë mënyre, po zienin dhe po promovonin këtë
12 dhunë në mënyrë të tillë që ata do të ishin persona që do të
13 mbushnin këtë vakum ligjor.

14 Por pyetja që do bëja unë është kjo, në qoftë se ti do të
15 promovosh këtë lloj dhune, në qoftë se do të promovosh këtë
16 lloj qasje pse duhet pastaj që të mbështesë forcën e policisë?
17 Pse mbështetët demilitarizimin e UÇK-së? Pse të kishte një
18 qëndrim të tillë?

19 Po e vërteta është që ai nuk i ka bërë asnjë nga këto
20 gjëra që unë i përmenda. Hashim Thaçi ka bërë këto për forcën
21 e policisë. Që në fillim të korrikut 1999, UNMIK-u pranoi
22 mungesën e prezencës zbatuese në rrugët e Kosovës. UNMIK-u dhe
23 OSBE-ja, me mbështetjen e plotë të Hashim Thaçi, krijuan
24 Shërbimin Policor të Kosovës që ishte projektuar për të
25 trajnuar kosovarët e të gjithave etniciteteve, për t'i

1 shërbyer oficerëve të policisë dhe për të filluar që të
2 trajtonin aktivitete kriminale. Ndërkohë programi i trajnimit
3 u përshpejtua me njohjen s'e kishte një nevojë urgjente për
4 këtë gjë dhe klasa e parë u diplomua në tetor të vitit 1999.

5 Gjatë mbështetjes së shërbimit policor të Kosovës, Hashim
6 Thaçi trajtoi në dy mënyra trazitë civile: Së pari, që të
7 kishte oficerë policie në rrugë në mënyrë të tillë që të mund
8 të trajtonin rastet e dhunës; dhe, së dyti që ushtarë
9 individualë të ish-UÇK-së të mund të jepnin ndihmën e tyre për
10 uljen e dhunës.

11 Atëherë, përveç, le të themi, përpjekjeve për
12 demilitarizimin e UÇK-së. A është ky një hap i cili ka si
13 qëllim që të marrë kompetenca e pushtet? Ju sugjeroj, të
14 nderuar Gjykatës, që nuk është ky rasti.

15 Si pjesë e procesit të demilitarizimit që kishte filluar
16 më 20 qershor 1999, UÇK-ja u transformua në Trupën e Mbrojtjes
17 Kosovare, në TMK. Ndërkohë komandantët e zonave, pra, nuk
18 ishin të aftë ose hezitoinin që të demilitarizonin dhe të
19 transformonin dhe ndërkohë që kishin dhe ndërhyrje personale
20 me gjeneral Clark. Procesi i demilitarizimit vijoi më tej me
21 përfundimin e suksesshëm nën autoritetin e Gjeneralit të KFOR-
22 it Jackson dhe komandantit të UÇK-së Agim Çeku, në koordinim
23 me UNMIK-un dhe në mbështetjen e Hashim Thaçit.

24 Ndërkohë në këtë fotografi që keni përpara, keni Hashim
25 Thaçin në të majtë, Bernard Kouchner nga Kombet e Bashkuara

1 dhe UNMIK-u. Mike Jackson në mes. Pastaj vjen Agim Çeku dhe më
2 tej vjen gjenerali Wesley Clark. Më 21 shtator 1999.

3 Dhe si vijoj më tej? A ishte kjo diçka e cila u bë me
4 shkrim apo ishte diçka që kishte një tjetër agjendë. Ndërkohë
5 që senatori Wesley Clark e ka shpjeguar këtë. Në takimin e
6 Komitetit të Shërbimeve të Armatosura më 2 shkurt 2000.

7 Senatori Reed :

8 "Ju lutem, sa i takon UÇK-së. A po e respektojnë ata
9 marrëveshjen për çarmatim, a jeni të kënaqur me këtë?

10 Gjenerali Clark: Po. Po e respektojnë.

11 Senatori Reed : Dhe sa i takon integrimin në shërbimin e
12 ri civil, ky integrim a po shkon në mënyrë të paqshme dhe
13 efektive?

14 Dhe përgjigja që jep Gjenerali Clarc është: "Po".

15 Pra, ky personi i cili mendohej se do të udhëzonte
16 Qeverinë e Përkohshme po merr pjesë dhe po ndihmon për
17 krijimin e institucioneve, dy institucioneve të rëndësishme,
18 domethënë, së pari, që të çarmatoste UÇK-në dhe që të vendoste
19 rend në rrugë përmes krijimit të forcës së policisë së
20 Kosovës.

21 Tani, më lejoni që flas pak sa i takon strukturës së UÇK-
22 së, sepse nuk dëgjuam asgjë lidhur me strukturën e UÇK-së,
23 përveç disa dokumenteve që na i tregoi ZPS-ja dhe që i vendosi
24 në ekran dje. Ndërkohë ZPS-ja nuk shpjegoi atë se çfarë, në
25 fakt, po ndodhte në terren me UÇK-në. Pra, le të flasim pak

1 për UÇK-në duke filluar nga fillimi i 1998.

2 UÇK-ja ishte një forcë guerile, pra, nuk bëhej fjalë për
3 një forcë të organizuar por bëhej fjalë për një grup
4 njerëzish, një grup vullnetarësh që kishte si qëllim që t'i
5 përgjigjeshit regjimit serb, domethënë, bëhej fjalë për
6 vullnetarë të cilët u mblodhën me njeri-tjetrin në mënyrë që
7 të mbronin fshatrat e tyre.

8 Kush ishin këta njerëz? Këta ishin vullnetarë, pra, ishin
9 fermerë, mësues, punonjës, studentë, si dhe civilë të tjerë
10 nga qytete, qyteza dhe fshatra në të gjithë Kosovën dhe
11 diasporën. Nuk ishin ushtarë të trajnuar. Nuk është se ishin
12 ushtarakë të trajnuar. Nuk ishin persona që kishin qenë pjesë
13 të ushtrive të mëparshme. Flitej për njerëz të zakonshëm.

14 Si rezultat, njësitet u formuan në nivelin vendor me
15 lojalitet dhe besnikëri ndaj drejtuesve të fshatrave. E kam
16 thënë dhe më përpara, që ndërkohë përpjekjet për zhvillime për
17 t'u organizuar në pranverë të vitit 1998, u shkatërruan nga
18 forcat eprore serbe gjatë ofensivës së verës, do dëgjojmë që
19 brigadat u shkatërruan dhe këto brigada, në fakt, u
20 shkatërruan në të gjithë Kosovën.

21 Viojmë më tej, në nëntor të vitit 1998, si pjesë e
22 riorganizimit pas ofensivës së verës që e uli në minimum
23 numrat e UÇK-së, UÇK-ja rikonfirmon Azem Sylën si komandant i
24 përgjithshëm, jo Hashim Thaçin, po Azen Sylën. Azem Sylë është
25 ky personi i cili u zëvendësua ndërkohë që ishte së bashku me

1 Hashim Thaçin në Rambuje.

2 U caktuan gjithashtu edhe dy zëvendëskomandantë të tjerë
3 dhe asnjëri prej tyre nuk ishte Hashim Thaçi.

4 Hashim Thaçi ishte njëri prej nëntë drejtorive, nuk
5 kishte asnjë përgjegjësi komande mbi trupat e UÇK-së në
6 terren. Në fakt, në mesatarisht 16 nëntor 1998, Hashim Thaçi u
7 largua nga Kosova shkoi në Evropën perëndimore dhe nuk u kthye
8 më në Kosovë deri më 9 mars 1999.

9 Pra, me të gjithë këtë riorganizim, me të gjitha këto
10 struktura, cili është rezultati fundor i UÇK-së duke e parë
11 atë çfarë kishte ndodhur gjithashtu edhe ofensivën e verës dhe
12 atë të vitit 1999 që uli shumë numrin e popullsisë edhe
13 spastrimin etnik që çoi në rreth 800,000 vetë që u larguan, u
14 dëbuan nga vendi?

15 Grupi i Krizës Ndërkombëtare kishte një koment,
16 domethënë, në një dokument të datës 3 mars 2020 tregon se
17 "Çfarë ka ndodhur në UÇK?:

18 "UÇK-ja tani nuk ka më strukturë strikte dhe nuk e ka
19 pasur këtë strukturë asnjëherë".

20 Dhe:

21 "'UÇK'-ja nuk ekziston sa i takon një strukture
22 komanduese të riorganizuar perëndimore. Kështu që pyetja ...
23 që duhet të bëhet është ... cila pjesë? Apo cilët individë?"

24 Ky informacion bazë i cili është reflektuar në një
25 telegram të Shteteve të Bashkuara, Departamentit të Shtetit më

1 10 mars 1999, aty flitet për konkurrencën për të pasur pushtet
2 ndërmjet komandantëve të zonës dhe Shtabit të Përgjithshëm,
3 pra, flitet për marsin e vitit 1999, pas asaj çfarë supozohej
4 që të jetë ristrukturim. Thuhet që:

5 "Mundësia e humbjes së pushtetit dhe ndikimit është forca
6 shtytëse e opozitës në Rambuje ndërmjet disa komandantëve të
7 ushtrisë. Oficerët politik të Shtabit të Përgjithshëm duket
8 sikur janë shumë të shqetësuar për të ruajtur unitetin e UÇK-
9 së përballë opozitës së komandantëve ushtarakë në Rambuje.

10 "Çështja tjetër e rëndësishme është ajo çfarë UÇK-ja e
11 quan "riorganizimin" e vet por, në fakt, kjo ka qenë thjesht
12 një përpjekje e lidërsipit për të krijuar një shtab të
13 përgjithshëm efektiv me kontroll të vërtetë në formacionet e
14 UÇK-së të shpërndarë në të gjithë Kosovën. Kjo përpjekje duket
15 sikur ka qenë vetëm pjesërisht e suksesshme ndërkohë që
16 komandantët e zonës mbajnë realisht pavarësi të konsiderueshme
17 operative në zonat e tyre".

18 Do ta lexoj dhe njëherë:

19 "...komandantët e zonës kanë mbajtur qartësisht pavarësi
20 të konsiderueshme operative".

21 Flitet përpara marsin e vitit 1999.

22 E gjithë çështja dhe një herë reflektohet në një letër të
23 Departamentit të Shtetit që është shkruar, pra, Departamenti i
24 Shtetit i Shteteve të Bashkuara që kishte të bënte me komandën
25 dhe kontrollin e UÇK-së nga ndihmës sekretari i Shtetit për

1 Çështjet Ligjore. Është një letër që mban datën 4 maj 1999.

2 Pra, data është 4 maj 1999. Një muaj përpara sesa të
3 përfundonte fushata bombarduese.

4 Në këtë letër të 4 majit 1999, thuhet, pra, Departamenti
5 i Shteteve të Bashkuara thotë:

6 "Për aq kohë sa nuk ka një strukturë politike në Kosovë
7 apo një komandë dhe kontroll efektiv të UÇK-së, do të duhen
8 shumë muaj, në qoftë se jo vite, për të organizuar ata për të
9 përdorur ose për të ruajtur ose për të përdorur, pra, ndihmë
10 ushtarake që do të ofrohet nga Shtetet e Bashkuara".

11 Pra, edhe një herë nuk kemi kontroll dhe komandë të UÇK-
12 së deri në maj të vitit 1999. Megjithatë, të nderuar Gjykatës,
13 me të gjitha dëshmitë dhe në të gjithë çështjen gjyqësore do
14 të shikoni se ka një mungesë të tërë komande dhe kontrolli të
15 UÇK-së dhe kjo është përtej çdo dyshimi. Nuk ka pasur komandë
16 dhe kontroll efektiv të UÇK-së. Deri në masën që nuk ka pasur
17 edhe ndonjë përpjekje për të pasur një komandë ose kontroll pa
18 diskutim që kjo u shkatërrua gjatë sulmeve dhe gjatë
19 përpjekjeve për spastrim etnik.

20 Kështu që më lejoni të vijoj me rolin e Hashim Thaçit në
21 drejtorinë politike.

22 E pamë këtë organigramë, që dua të parashtroj, të nderuar
23 Gjykatës, që organigrama që pamë nga Prokuroria ishte
24 tërësisht e gabuar. Më lejoni të flas lidhur me rolin Hashim
25 Thaçit në Drejtorinë Politike, t'i kthehem pak mbraps nëse

1 më lejoni, faktit që Hashim Thaçi kthehet në Kosovë në mars të
2 vitit 1998 pas masakrës së Jasharëve.

3 Në pranverë të vitit 1998, ai u ftua që të bëhej anëtar i
4 Shtabit të ri të Përgjithshëm, përgjegjës për logjistikën dhe
5 mediat. Çfarë ka bërë ai? Çfarë aktivitete kanë pasur? Ka
6 transportuar material dhe armë nga Shqipëria, siç kanë bërë
7 dhe shumë ushtarë të tjerë; është përfshirë me median, në,
8 veçanti duke lehtësuar intervista me drejtues të UÇK-së dhe
9 vetë ka ndërvepruar me diplomatë në terren.

10 Por lidhur me përgjegjësinë e komandës dhe kontrollit të
11 tij veçanërisht lidhur me komandantët e zonave? Mungesa e
12 përgjegjësive të komandës së tij është treguar ose demonstruar
13 nga komanda e nënzonës së Drenicës, e cila lëshoi një urdhër
14 arresti kundër tij më 10 korrik 1998. Pra, ky personi që
15 mendohej që kishte atë pushtetin e jashtëzakonshëm brenda UÇK-
16 së dhe komanda e nënzonës së Drenicës lëshon një urdhër
17 arresti për të më 10 korrik 1998. Mungesa e përgjegjësisë së
18 komandës në terren demonstron nga vendimi për të unifikuar
19 UÇK-në dhe FARK-un, për të bashkuar këto të dyja në një
20 marrëveshje e cila nuk u nënshkrua, megjithatë ky ishte një
21 propozim i bërë aso kohe.

22 Viojmë me diapozitivin tjetër.

23 Ky është një dokument i ZPS-së që, fatkeqësisht, nuk u
24 transmetua, nuk u tregua dje, megjithatë kjo është marrëveshje
25 nga anëtarët e FARK-ut dhe të UÇK-së që të bashkonin forcat.

1 Dëgjuam dje shumë informacion lidhur me UÇK-në që luftonte
2 LDK-në dhe se LDK-ja ishte pjesë "kundërshtareve" që UÇK-ja
3 ishte pas tyre. Por FARK-u është krahu ushtarak i LDK-së. Ata
4 po përpiqen që të bëhen pjesë e LDK-së, pra, e kësaj dorës së
5 zgjatur të LDK-së ndërkohë që përpjekja është që të bashkohen
6 të dyja këto njësi.

7 Në qoftë se do të shikojmë individët që ishin të
8 pranishëm në takim dhe bëhet fjalë për datën 2 nëntor 1998,
9 ndërkohë themi që z. Thaçi është kaq i rëndësishëm, ndërkohë
10 që z. Thaçi s'ka qenë fare në takim. Çfarë mund të ndihmonte,
11 pra, kush do të merrte vendimin? Dhe personat që ishin anëtarë
12 ose pjesëtarë të këtij takimi ishin: Adem Demaçi, Bujar
13 Bukushi, një përfaqësues i UÇK-së dhe një tjetër përfaqësues i
14 LDK-së.

15 Pra, as nuk përmendet fare Hashim Thaçi, fare. Pra, nuk
16 mendohej, as nuk perceptohej që ishte një vendimmarrës i
17 rëndësishëm ose një person që ata duhet ta identifikonin në
18 mënyrë që të mund të krijonin këto lloj unifikimi të UÇK-së.
19 Dhe pse është kështu? Është shumë e qartë sepse sipas
20 përgjegjësisë së komandës dhe kontrollet për operacionet
21 luftarake në terren, Hashim Thaçi nuk ishte absolutisht asnjë
22 lloj përgjegjësie.

23 Viojmë në faqen tjetër, Hashim Thaçi këtu përmendet,
24 listohet, si një prej anëtarëve të qeverisë në J.1.
25 Megjithatë, kompetencat janë të ndara ndërmjet anëtarëve të

1 FARK-ut dhe i keni të theksuara këtu me të verdhë. Megjithatë,
2 e rëndësishme këtu është kush është personi në UÇK që duhej që
3 ta miratonte këtë? Kush është personi i parë i kësaj liste?

4 Ju lutem transmetojeni dhe një herë diapozitivin.

5 Personi i parë në listë është Adem Demaçi. Nuk është as
6 Hashim Thaçi. Askush tjetër. Është Adem Demaçi. Adem Demaçi
7 ishte personi që duhej të pajtohej me faktin që FARK-u dhe
8 UÇK-ja të bashkonin fuqitë, kompetencat e tyre. Kush është ky
9 person? E përmenda dhe më përpara. Është përfaqësuesi i
10 përgjithshëm politik i UÇK-së nga data 13 gusht 1998 deri në 3
11 mars 1999. Është përfaqësuesi i përgjithshëm politik, është
12 përfaqësuesi më i lartë i UÇK-së. Gjatë kohës operative të kaq
13 shumë gjërave që u përmendën nga ZPS-ja dje, z. Demaçi nuk u
14 përmend asnjëherë në diskutimet e tyre. Nuk u diskutua si një
15 ndër personat kryesorë të UÇK-së. Edhe njëherë të vetme nuk e
16 përmenden atë.

17 Kush ishte ky person dhe çfarë ka bërë ai? Ai e kishte
18 selinë në Prishtinë. Kishte këshilltarë. Ka mbajtur konferenca
19 për shtyp çdo javë për të paraqitur pozicionet politike të
20 UÇK-së dhe objektivat e tyre. Është një person që mbante
21 kontakte të vazhdueshme dhe të rregulla me komandantët e
22 zonës, takohej në mënyrë të rregullt me përfaqësues të
23 komunitetit ndërkombëtar, jepte fletë-kalime për diplomatët
24 ndërkombëtarë dhe gazetarë në mënyrë që mund të shkonin në
25 zona që kontrolloheshin nga UÇK-ja dhe ndërmjetësonte lirimin

1 e të ndaluarve të UÇK-së. Ai ndërkohë ka kundërshtuar fort
2 praninë e UÇK-së në Rambuje.

3 Ishte një person, i cili ishte një drejtues, një ndër
4 drejtuesit më të lartë politik të UÇK-së. Një person i cili
5 njihej shumë nga popullsia kosovare. Një person që kishte
6 shpenzuar vite të tëra të jetës së tij në burgjet serbe. Dhe
7 ky ishte personi i cili duhej që të miratonte këtë marrëveshje
8 për UÇK-në. Ndërkohë që ZPS-ja nga të gjitha gjërat që tha dje
9 nuk tha qoftë edhe një fjalë të vetme lidhur me të. Nuk tha
10 asgjë lidhur me pozicionimin e tij, me autoritetin që kishte
11 dhe çfarë hapash ka marrë ai gjatë kësaj periudhe.

12 Nëse më lejoni, të nderuar Gjykatës, do të kalojmë tek
13 segmenti tjetër. Kështu që tani dua t'i jap fjalën z. Misetic,
14 nëse më lejoni, për të vazhduar me pjesën tjetër të
15 prezantimit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pa diskutim.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. President, anëtarë të Trupit
18 Gjykues, mirëmëngjes. Do të vazhdojë këtu me rëndësinë që i
19 duhet dhënë dallimit ndërmjet fjalës "policy" në anglisht dhe
20 "politics". Politikat dhe politika në shqip.

21 Cili është roli i Drejtorisë Politike i Shtabit të
22 Përgjithshëm të UÇK-së? Roli kryesor ishte që të paraqiste
23 objektivat kryesore politike të UÇK-së, të komunikonte
24 pozicionet politike të UÇK-së me delegacione të brendshme dhe
25 të huaja si dhe me median vendase dhe ndërkombëtare. Ndërmjet

1 gjërave të tjera, drejtoria politike e UÇK-së ka hapur zyrat e
2 ndërlidhjes së UÇK-së në vendet perëndimore dhe ka organizuara
3 konferenca për shtyp jashtë shtetit.

4 Drejtoria Politike ishte përgjegjëse për ndërlidhjen me
5 autoritetet evropiane dhe amerikane si dhe me organizata të
6 tjera të tilla si, për shembull, KDOM-i dhe OSBE-ja. Ajo çfarë
7 është e rëndësishme të theksohet është se drejtoria politike
8 nuk ka përcaktuar politikat apo strategjinë e UÇK-së dhe nuk
9 ka ushtruar kontroll politik mbi UÇK-në.

10 Viojmë me diapozitivin tjetër.

11 ZPS-ja, në paragrafin 18 të dosjes paragjyqësore, thotë
12 që kishte një strategji të UÇK-së dhe "politika të UÇK-së
13 lidhur me kundërshtarët" dhe këtu dua të citoj që "personat
14 kishin përgjegjësi për politikën" pra, "të akuzuarit kishin
15 përgjegjësi për politikat e UÇK-së".

16 Megjithatë vijohet më tej në dosjen e ZPS-së që anëtarët
17 e UÇK-së respektonin marrëdhëniet publike të Shtabit të
18 Përgjithshëm dhe "autoritetin politikbërës", të tilla si
19 deklaratat politike.

20 Ndërkohë që dje juve ju tha dhe qua që të citoj:

21 "Që në rolin e vetë në Drejtorinë Politike, politikat e
22 UÇK-së ishin përgjegjësi e z. Thaçi".

23 Si rezultat, deduktimi është që ishte Shtabi i
24 Përgjithshëm ai dhe më specifikisht Drejtoria Politike e
25 Shtabit të Përgjithshëm dhe më specifikisht sesa kaq, madje

1 dhe z. Thaçi i cili zbatonte politikat e UÇK-së. Por nga ana
2 tjetër çfarë provash ka përdorur ZPS-ja për të mbështetur
3 pretendimet e veta që shpjegojnë ose vërtetojnë që z. Thaçi
4 "kishte përgjegjësi për politikat e UÇK-së"? E gjithë gjëja që
5 kemi ne nga ZPS-ja është dosja paraprake e ZPS-së. Dhe aty,
6 është vetëm një provë e cila, në fakt, lidhet dhe përfshinë z.
7 Krasniqi.

8 Përpara sesa të kthehemi tek libri i z. Krasniqi, është e
9 rëndësishme për Trupin Gjykes që të kuptojë që në gjuhën
10 shqipe nuk ka dallim ndërmjet fjalës "policy" dhe "politics"
11 në anglisht. Në shqip të dyja konceptet mbulohen nga një fjalë
12 "politikë", megjithatë këto dy terma kanë komplet kuptime të
13 ndryshme në gjuhën angleze.

14 Në gjuhën angleze, politika përkufizohet si "ushtrimi ose
15 kërkimi i pushtetit në marrëdhënie qeveritare ose publike me
16 shtetin, me komunat, e tjera".

17 Ndërkohë që në anglisht politika si strategji përcaktohet
18 si "një vijë e cila përdoret dhe ndiqet nga një qeveri, nga
19 një parti politike, e tjerë".

20 Drejtoria Politike e UÇK-së, përfshirë këtu edhe z.
21 Thaçi, ka përfaqësua politikat e UÇK-së; me fjalë të tjera,
22 domethënë, strategjitë politike të UÇK-së. Dhe prandaj quhej
23 Drejtoria Politike dhe jo e politikave.

24 Detyra kryesore e Drejtorisë Politike është që të
25 negocionte dhe të takonte me ndërkombëtarët dhe përfaqësuesit

1 në mënyrë të tillë që të siguronte mbështetje për kauzën e
2 lirisë së Kosovës. As Hashim Thaçi dhe as Drejtoria Politike
3 nuk ishin përgjegjëse për përcaktimin e politikës apo
4 strategjisë së UÇK-së.

5 Tani le të kalojmë pak tek libri i z. Krasniqi, "Pika e
6 Madhe e Kthesës" që është e vetmja provë e cila citohet nga
7 ZPS-ja në dosjen e vetë paragjyqësore për të mbështetur faktin
8 ose presupozimin e tyre që UÇK-ja ishte përgjegjëse ose
9 drejtoria politike ishte përgjegjëse për politikat e UÇK-së.

10 ZPS-ja, pra, na dha një fragment të librit dje. Është ky
11 citimi të cilin e kemi të dhënë pak më poshtë:

12 "Hashim Thaçi, nga Buroja, Skënderaj, ka studiuar në
13 doktoratë për shkencë politike në Cyrih, në universitetin e
14 Cyrihut. Është një ndër drejtuesit kryesorë politik të UÇK-së
15 dhe drejtues i lëvizjes studentore në vitin 1990 dhe ai ishte
16 drejtuesi i Departamentit Politik që "drejton politikat e UÇK-
17 së". Pavarësisht që është dënuar në mungesë nga gjykatat e
18 armikut, ai në mënyrë të vazhdueshme ka qenë i pranishëm në
19 Kosovë".

20 Tani, pavarësisht prezumimeve të gabuara të z. Krasniqi
21 që z. Thaçi ishte vazhdimisht i pranishëm në Kosovë, gjëja
22 kryesore që duhet të diskutojmë është në qoftë se z. Thaçi
23 ishte "drejtuesi i politikave të UÇK-së". Në tekstin në shqip,
24 z. Thaçi, në fakt, thuhet që ka drejtuar "politikat" e UÇK-së.
25 Ndërkohë që përkthimi ka qenë i gabuar sepse bëhej fjalë për

1 "politikën". Domethënë, si drejtori politike dhe përgjegjësi e
2 z. Thaçi ishte lidhur me politikat e UÇK-së dhe me jo
3 "politikën" e saj.

4 Nuk duhet të diskutohet më tej se fjala politik në librin
5 e z. Krasniqi duhet të kuptohet që z. Thaçi ishte përgjegjës
6 për politikën e UÇK-së dhe jo për politikat e UÇK-së. Nuk
7 duhet të ketë më asnjë diskutim se ZPS-ja e ka përkthyer
8 gabimisht këtë provë, sepse po t'i kthehemi dhe njëherë më
9 saktë do ishte:

10 "Hashim Thaçi, nga Buroja (komuna e Skënderajt), që i
11 cili kishte ndjekur studimet pas universitare për shkencat
12 politike në Universitetin e Cyrihut, një nga udhëheqësit e
13 parë politik të UÇK-së dhe udhëheqës i lëvizjes studentore të
14 viteve 1990, drejtonte, pra, drejtorinë Drejtorin Politike që
15 drejtonte politikën e UÇK-së në kuptim "politiks" në anglisht.

16 Pra, edhe njëherë e them nuk duhet të ketë më asnjë
17 diskutim që ZPS-ja i ka përkthyer gabimisht provat e përdoruar
18 për të konfirmuar aktakuzën dhe në dosjen paraprake të saj për
19 të pretenduar se drejtoria politike ishte udhëheqëse e
20 politikave, në kuptimin "policy" në anglisht, të UÇK-së,
21 rrjedhimisht, pra, Drejtoria Politike ishte -- që i bie se
22 Drejtoria Politike do të duhej të ishte përgjegjëse për një
23 politikë të pretenduar të shënjestrimit të civilëve.

24 Drejtoria Politike dhe Hashim Thaçi nuk bënë politikat e
25 UÇK-së, por përfaqësonin qëndrimet politike të UÇK-së.

1 Patëm pesë muaj më pas në dosjen paraprake, ku pesë muaj
2 pas këtij korigjimi përkthimi, Prokuroria vijonte që ta
3 paraqiste këtë provë që është e vetmja provë e cila mbështetej
4 në keqpërkthimin e mëparshëm. Përse ZPS-ja vijon që të
5 mbështetet në këtë keqpërkthim mbetet ende enigmë.

6 Diapozitivi tjetër, ju lutem.

7 Tani do të flasim për rolin e Hashim Thaçi në të
8 ashtuquajturën Qeveri të Përkohshme të Kosovës. Hashim Thaçi
9 nuk pati kurrë një pushtet ligjor ekzekutiv në cilësinë e tij
10 si i ashtuquajtur kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të
11 Kosovës sepse, siç e shpjegoi z. Kehoe, kjo Qeveri e
12 Përkohshme e Kosovës nuk ekzistoi kurrë, siç u parashikua në
13 Rambuje, por u zëvendësua nga UNMIK-u.

14 Z. Thaçi nuk pati kurrë autoritet, pra, pushtet mbi UÇK-
15 në si i ashtuquajtur kryeministër.

16 Është e vërtetë që Hashim Thaçi ishte Kryeministër për
17 t'u përfaqësuar para ndërkombëtarëve sikur kishte më shumë
18 pushtet, këto tituj ishin vetëm në letër, si të thuash, sepse
19 provat apo mungesa e provave e dëshmojnë mjaftueshëm këtë
20 fakt. Ai bëri çmos që ta promovonte veten si kur ishte një
21 person i pushtetshëm, por realiteti ishte që nuk kishte një
22 pushtet real dhe nuk kishte kontroll efektiv asnjëherë.

23 Shumë shpejt pas mbërritjes së UNMIK-ut, z. Thaçi e
24 kuptoi se UNMIK-u ishte ai që kishte pushtetin dhe autoritetin
25 real për të qeverisur Kosovën dhe filloi të bashkëpunonte me

1 UNMIK-un.

2 Si një politikan aspirues me shpresën për të udhëhequr
3 Kosovën, ishte në interesin e Hashim Thaçi për t'i dëshmuar
4 UNMIK-ut se ishte partner i besueshëm dhe i qëndrueshëm. Nuk
5 kishte asnjë motiv për të lejuar apo nxitur kryerjen e krimeve
6 në Kosovë. Një kaos i tillë vetëm sa do të minonte rëndësinë
7 që ai do të kishte për udhëheqësit ndërkombëtar por dhe për
8 popullatën lokale.

9 Përkundrazi, ai vijoi që të kishte nevojë për mbështetjen
10 ndërkombëtare sidomos mbështetjen e ShBA-ve. Jo për aspirata
11 personale por, më shumë dhe më e rëndësishme, për shkak se
12 pavarësia e Kosovës ishte qëllimi përfundimtar. Pas instalimit
13 të UNMIK-ut, organizatat ndërkombëtare dhe media të cilat
14 bënin këto lloj pretendime, këto ishin më të logjikshme, pra,
15 që nuk mund të kryente gjëra të tilla.

16 Ai nuk e kishte pushtetin për të hetuar dhe të proceduar
17 krimet e kryera në Kosovë. Sepse ky pushtet dhe kompetencë i
18 takonte UNMIK-ut. Edhe pse ishte një person me influencë dhe
19 bënte kinse se kishte pushtet, ai nuk kishte kontroll efektiv
20 mbi UÇK-në apo ish-persona të UÇK-së apo personat që mbanin
21 uniforma të UÇK-së. Ajo që tregojnë provat sa i takon raportit
22 vartës-epror midis z. Thaçi apo personave të cilët pretendohet
23 se kanë kryer krime.

24 Prokuroria nuk i paraqet, nuk citon, prova të tilla, nuk
25 paraqet prova që z. Thaçi t'u ketë dhënë urdhra ushtarëve të

1 UÇK-së apo si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm apo si
2 kryeministër i kësaj Qeverie të Përkohshme të Kosovës. Po
3 kështu Prokuroria nuk ka as prova të linjave të raportimit
4 midis z. Thaçi dhe njësive të UÇK-së dhe kryeseve.

5 Nëse nuk ka urdhra të tillë dhe linja të tilla raportimi
6 nga njësitet e UÇK-së tek z. Thaçi është e paqartë sesi
7 menduaka Prokuroria që mund të vërtetojë se ekzistonte një
8 marrëdhënie epror-vartës midis z. Thaçi dhe kryesve të këtyre
9 krimeve.

10 Mbi të gjitha, është e qartë se z. Thaçi nuk kishte edhe
11 mundësinë materiale për të parandaluar apo ndëshkuar krimet.

12 Siç e përmenda më përpara, OJQ-të ndodheshin në terren në
13 Kosovë pas konfliktit dhe i kanë dokumentuar krimet e kryera
14 dhe mungesën e ligjit në periudhën menjëherë pas luftës. Një
15 OJQ e tillë ishte Grupi Ndërkombëtar për Krizat. Në raportin e
16 tij të 2 nëntorit 1999, me titullin "Kush po vret kë në
17 Kosovë" ICG-ja pajtohet se ka shumë njerëz të cilët vijnë
18 vërdallë nëpër Kosovë me uniforma të UÇK-së por që jo me
19 doemos janë anëtarë të UÇK-së. Dhe këtu po citoj:

20 "...uniformat dhe shenjat e UÇK-së mund t'i blësh kudo
21 nëpër dyqane dhe kioska si në Kosovë dhe në Shqipëri dhe, tek
22 e fundit, maskë mund të mbajë kushdo".

23 Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut i OKB-së
24 arriti në një përfundim të ngjashëm në raportin e tij të 27
25 shtatorit 1999, ku po fliste për përhapjen e uniformës së UÇK-

1 së në Kosovë. Dhe këtu po citoj:

2 "Disa viktime të dhunës me bazë etnike janë raportuar
3 përfshirë këtu edhe nga sulmues me uniforma të UÇK-së edhe pse
4 një pjesë e mirë e dhunës mund të jetë bërë nga elemente
5 kriminale që janë maskuar me uniforma të UÇK-së. Hapja e
6 kufijve, në fakt, ka mundësuar mbërritjen në shkallë të madhe
7 të elementeve kriminale, sidomos nga Shqipëria. Është vënë re
8 gjithashtu se uniformat e UÇK-së mund t'i gjesh për çmimin
9 rreth 50 DEM në Shqipëri edhe persona të shtetësisë shqiptare
10 pa asnjë marrëdhënie me UÇK-në, mund ta përdorin uniformën si
11 një lloj pasaporte për të kaluar përmes sektorit të KFOR-it
12 gjerman në Kosovë".

13 Lidhur me atë sesi dhuna pas luftës nuk ishte në interes
14 të ambicieve të Kosovës për pavarësi dhe as në interes të z.
15 Thaçi kemi këtë citim që e mbështet këtë nga raporti i ICG-së:

16 "Po kështu pranohet përgjegjësish se nuk është në
17 interesat e udhëheqjes së UÇK-së që të duket se sanksionon
18 sulmet gjithnjë e më barbare kundër serbëve. Ata e dinë mirë
19 se ekziston një efekt dëmtues i sulmeve të tilla, sidomos
20 kundër të moshuarve dhe civilëve të pambrojtur".

21 Raporti i ICG-së pastaj vëren se ka të ngjarë që, sidomos
22 z. Thaçi nuk ka qenë i kënaqur nga këto krime që kryheshin.
23 Dhe po citoj:

24 "Është e besueshme se udhëheqësi i UÇK-së Hashim Thaçi,
25 së bashku me shumë prej komandantëve të lartë të UÇK-së, mund

1 të mos jenë të kënaqur me këto sulme dhe frikësim të vazhduar
2 kundër popullatës jo shqiptare të Kosovës. Udhëheqësit e UÇK-
3 së vazhdimisht kanë bërë thirrje serbëve që të qëndrojnë në
4 Kosovë”.

5 “Në një intervistë Thaçi ka thënë se është i angazhuar
6 për të krijuar “një shoqëri tolerance” dhe se ai është i
7 brengosur për aktet e dhunës kundër serbëve dhe për largimin e
8 serbëve duke thënë se: ‘Jemi angazhuar që ditën e parë për të
9 krijuar një shoqëri ku sundon toleranca dhe jo hakmarrja. U
10 kërkohet serbëve që janë larguar nga Kosova të kthehen të
11 ndihmojnë për ndërtimin e paqes dhe demokracisë dhe
12 respektimin e njeri-tjetrit’.

13 “Duke qenë se UÇK-ja nuk ka pasur asnjëherë një komandë
14 qendrore të unifikuar udhëheqja e saj, paçka se e singertë,
15 nuk mund të japë garanci që ushtarët e UÇK-së nuk janë
16 përgjegjës për këtë. Thaçi nuk mund të flasë për të gjithë
17 UÇK-në dhe ish-komandantë apo ushtarë të UÇK-së, shumë prej të
18 cilëve dihet se kanë qenë kundër çmilitarizimit”.

19 Kjo është video e parë që do të luajmë, ajo që do t’ju
20 tregojmë tani është në -- janë deklaratat e asokohshme të z.
21 Thaçi të vitit 1999 që kanë të bëjnë me dhunën. Z. Thaçi në
22 mënyrë të përsëritur publikisht bënte thirrje për përfundimin
23 e dhunës dhe kërkonte që Kosova të ishte një vend multietnik
24 me të drejta dhe garanci për të gjithë qytetarët. Kjo është
25 një video e një deklaratë publike e lëshuar nga z. Thaçi më 17

1 qershor të vitit 1999.

2 [Luhet videoincizimi]

3 "Hashim Thaçi: Unë ju bëj thirrje serbëve që të kthehen
4 në Kosovë, ata të cilët janë larguar. Sepse ne e vlerësojmë se
5 këto masakra në Kosovë nuk i ka bërë populli serb. Sepse
6 vlerësojmë se këta njerëz mund të japin një kontribut të
7 çmueshëm për të ardhmen dhe prosperitetin e Kosovës. Ne nuk
8 kemi zhvilluar një luftë për pastrimin e Kosovës, ne kemi
9 zhvilluar një luftë për të jetuar të lirë të barabartë të
10 gjithë".

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Diapozitivi tjetër, ju lutem.

12 Nëntë ditë më pas, më 26 qershor të vitit 1999, z. Thaçi
13 shkoi në Mitrovicë për t'iu drejtuar një turme të madhe për të
14 ulur tensionet etnike.

15 [Luhet videoincizimi]

16 "Hashim Thaçi: Më vjen shumë që sot takohemi në
17 Mitrovicë, për të cilën kemi luftuar. Ne sot me z. De Mello
18 kemi ardhur këtu për të biseduar me ju po ashtu për të
19 biseduar edhe me palën serbe përtej urës. Ne e kaluam urën.
20 Shkuam në spitalin. Shkuam në spital. I kemi dërguar njerëzit
21 tonë, kanë filluar punët. Dhe ne jemi të interesuar që
22 gjithçka ti rregullojmë në bashkëpunim të ngushtë me
23 bashkësinë ndërkombëtare dhe do ta rregullojmë.

24 "Ne si gjithmonë, kemi qenë të interesuar që çdo problem
25 ta zgjidhim me të vërtetë ashtu siç na ka hije me një

1 disiplinë, me një kulturë. Ne edhe kemi luftuar me kulturë,
2 por edhe do të kthehemi në objektet dhe do ta ndërtojmë jetën
3 në një kulturë të mirëfilltë qytetare, jo vetëm shqiptarët për
4 demokracinë kulturore.

5 "Ne duhet ta kuptojmë se edhe serbët duan të jetojnë në
6 Mitrovicë me ata të cilët nuk kanë bë krime, ata të cilët nuk
7 kanë vra njerëz. Ne nuk jemi të interesuar dhe nuk i fryjmë
8 erës së jetës njënacionale. Duhet të kuptojmë se të jetojnë të
9 gjithë në Kosovë ata që dëshirojnë të jetojnë. Kosova është e
10 kosovarëve dhe do të jetojnë këtu".

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Diapozitivi 95, ju lutem.

12 Disa ditë më pas, më 2 korrik të vitit 1999, z. Thaçi
13 bëri thirrje për tolerancë dhe gjithëpërfshirje etnike në një
14 deklaratë të përbashkët me udhëheqë të tjerë. Folësi i parë në
15 video është z. Sergio De Mello, pastaj përfaqësuesi -- që
16 ishte aso kohe përfaqësues i Sekretarit të Përgjithshëm të
17 OKB-së.

18 [Luhet videoincizimi]

19 PËRKTHYESI: "Sergio De Mello: Sot, besoj se është hera e
20 parë që shqiptarët, që udhëheqësit shqiptarë dhe serbë të
21 Kosovës takohen dhe bisedojnë me njëri-tjetrin për të vendosur
22 një dialog për problemet më akute të tanishme që janë
23 parrezikshmëria dhe siguria, e drejta për jetë, e drejta për
24 pronësi për të gjithë banorët e kësaj province.

25 "Hashim Thaçi: I lusim të gjithë qytetarët e Kosovës,

1 qofshin ata me status civil apo ushtarak, të përmbahen dhe të
2 ndikojnë tek të tjerët që të mos ndërmarrin akte dhune ndaj
3 fqinjëve të tyre meqë veprime të këtilla janë të papranueshme,
4 përgjegjësit e veprimeve të tilla do të sillen para
5 drejtësisë.

6 "Insistojmë gjithashtu që të gjithë njerëzit e zhdukur
7 t'i dorëzohen përfaqësuesve të UNMIK-ut. Ne përkrahim
8 përpjekjet e përbashkëta që tani janë ndërmarrë nga aktivistët
9 e bashkësisë shqiptare ose serbe dhe të bashkësive të tjera që
10 së bashku me UNMIK-un dhe organizata të tjera ndërkombëtare të
11 realizojnë këto kërkesa. Rruga e pajtimit do të jetë e gjatë
12 dhe e vështirë. S'është e vërtetë se ekziston një urrejtje e
13 natyrshme mes njerëzve në Kosovë. Ne duhet të punojmë së
14 bashku. Si hapat e parë, ne jemi marrë vesh që sot, menjëherë
15 të vendoset liri komunikimi në mes nesh, UNMIK-ut dhe KFOR-it
16 dhe mbajtjen e mbledhjeve të përbashkëta si kjo sot, të
17 lëshojmë mesazhe të përbashkëta pajtimi në TV dhe radio, të
18 krijohet një forcë e përbashkët për krizat në rajon së bashku
19 me UNMIK-un dhe KFOR-in të cilat do të jenë në gjendje të
20 shqyrtojnë problemet urgjente kudo që ndodhin duke përfshirë
21 edhe vendet historike fetare dhe të organizohet një mbledhje e
22 hershme ndërmjet udhëheqësve fetarë dhe shpirtëror duke
23 thirrur për tolerancë.

24 PËRKTHYESI: "Ati Sava: Të dyja anët e dënojnë krimet e
25 regjimit të Milosheviçit në Kosovë. Personat e dyshuar për

1 krime lufte dhe krimet kundër njerëzimit do të sillen para
2 drejtësisë. E mbështesim rolin e TPNJ-së. Vetëm paqja mund të
3 ndërtojë drejtësinë, jo hakmarrja.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Tre ditë më vonë, më 6 korrik të
5 vitit 1999, z. Thaçi publikisht i dënoi krimet, përfshirë këtu
6 edhe krimet kundër popullatës serbe. Janë së paku katër
7 deklarata të tilla publike në javët e para pas përfundimit të
8 konfliktit të armatosur.

9 [Luhet videoincizimi]

10 "Hashim Thaçi: Është e vërtetë se kohëve të fundit,
11 sidomos pas përfundimit të luftës, në veçanti këto ditët e
12 fundit, kemi pasë një dukuri jo të mirë, jo të ndershme jo të
13 përgjegjshme për situatën nga individë apo grupe të caktuara
14 të cilët janë marrë me thyerje të banesave, me keqpërdorimet e
15 -- edhe me keqpërdorimin e simboleve të Ushtrisë Çlirimtare të
16 Kosovës, me plaçkitje, thyerje, djegie, shkatërrime, po ashtu
17 edhe në thyerjen e monumenteve dhe busteve të vëra nga serbët.
18 Kjo është një dukuri që neve na ka penguar dhe është duke na
19 shqetësuar. Qeveria e Përkohshme e Kosovës dhe unë,
20 personalisht, distancohemi nga veprime të tilla të
21 pandërgjegjshme".

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Diapozitivi 97, ju lutem.

23 Z. Thaçi bëri thirrje publike për tolerancë dhe unitet
24 etnik gjatë gjithë verës së vitit 1999. Siç e shohim në videon
25 e mëpasshme të z. Thaçi në Rahovec më 17 korrik të vitit 1999.

1 [Luhet videoincizimi]

2 "Hashim Thaçi: Qyteti juaj, ashtu siç ka ditur
3 vazhdimisht, do të jeni dhe sot të ndaj të mirën, të ndaj të
4 keqen, të ndaj atë të cilën nuk është e kapshme, nuk është e
5 respektueshme për orientimet tona, për të ardhmen tonë.
6 Megjithatë, sot ja kemi një kohë, ashtu siç e kemi respektuar
7 ne vazhdimisht realitetet e reja të krijuara, që të mos
8 mendojmë shumë për hakmarrje, për urrejtje, për ndasi. Sot
9 është kohë bashkimi. Dhe në këtë bashkim duhet të luajmë rolin
10 secili nga ne, nga qytetari, politikani dhe të gjitha shtresat
11 popullore, pa dallim përcaktimi politik, ideologjie, krahine,
12 feje apo ndonjë përcaktimi tjetër.

13 "Ne duhet të jemi ata që, si kurrë ndonjëherë më parë, të
14 bashkohemi rreth unitetit për pavarësinë e Kosovës. Ne nuk
15 kemi nevojë për qytet etnik. Kemi nevojë t'i respektojmë të
16 gjithë ata të cilët dëshirojnë të jetojnë në qytet, por si
17 qytetarë të lirë, si qytetarë që respektojnë rregullin,
18 rendin, si qytetarë të cilët nuk mendojnë për konfrontim, si
19 qytetarë të cilët nuk kanë marrë pjesë në masakrat mbi
20 vëllezërit tonë, mbi motrat tona, mbi prindët tonë. Ne do t'i
21 respektojmë ata që e meritojnë të respektohen, por dhe nuk do
22 të lejojmë që askush kriminelët në qytetin e Rahovecit t'i
23 merrë në mbrojtje.

24 "Nuk do të lejojmë gjithashtu anarki në qytet. Nuk do të
25 lejojmë anarki, nuk do të lejojmë asnjë frymë të jotolerancës

1 në Kosovë, sepse, ne ashtu siç kemi treguar shpesh herë, do të
2 tregohemi përsëri, se ne jemi ata që kemi respektuar dhe
3 respektojmë rregullat, rendin demokratik. Ashtu siç kem
4 respektuar, ne do të respektojmë përsëri”.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Diapozitivi tjetër, ju lutem.

6 Më 21 korrik të vitit 1999, ditët përpara vrasjes së 14
7 serbëve në Graçkën e Vjetër, në Kosovë, z. Thaçi vizitoi këto
8 zona serbe së bashku me patriarkun Sava, me z. Trajkovic dhe
9 me z. Kouchner.

10 Pasi ndodhën vrasjet në Graçkën e Vjetër, të cilën z.
11 Thaçi menjëherë ia përshkroi BBC si “një akt të çmendur që
12 synonte që të trondiste marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe
13 serbëve në Kosovë”, ai sërish kërkoi që të bënte thirrje që
14 duke i dënuar këto vrasje dhe duke u bërë thirrje serbëve,
15 pra, që të ktheheshin në Kosovë, të qëndronin në Kosovë.

16 [Luhet videoincizimi]

17 “Hashim Thaçi: Ky akt është një akt kundër demokracisë,
18 popullit të Kosovës, bashkësisë ndërkombëtare. Ky akt i
19 konvenon vetëm Milosheviçit dhe regjimit të tij dhe askujt
20 tjetër në Kosovë dhe botë. Ky akt i dhunës ndodhi në ditën kur
21 përfundoi faza e dytë e procesit të demilitarizimit të
22 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me këtë rast ftoj dhe njëherë
23 serbët të cilët janë në Kosovë që të mos largohen nga Kosova,
24 që të mos kenë frikë nga shqiptarët. Të afrohen me njëri-
25 tjetrin si qytetarë të barabartë të Kosovës. Ta ndihmojnë

1 njeri-tjetrin, ta respektojnë njeri-tjetrin, të integrohen me
2 njeri-tjetrin dhe të ndërtojnë një shoqëri me të vërtetë të
3 mirëfilltë qytetare moderne.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe, në fund, më 2 shtator të
5 vitit 1999, z. Thaçi u takua në Londër me Sekretarin e Punëve
6 të Jashtme Robin Cook, për t'i shprehur dhe njëherë dëshirën e
7 tij për një Kosovë multietnike.

8 [Luhet videoincizimi]

9 "Hashim Thaçi: Megjithatë, dukuria negative e largimit të
10 një numri të serbeve nga Kosova, ka qenë me të vërtetë një
11 dukuri shqetësuese për ne, sepse ne jemi të interesuar që në
12 Kosovë ta ndërtojmë një shoqëri multietnike, të barabartë për
13 të gjithë qytetarët e Kosovës. Ne ju kemi bërë ftesë dhe
14 thërrasim përsëri që ata njerëz të kthehen në Kosovë ta
15 ndihmojnë paqen e demokracinë. Megjithatë ne do të punojmë dhe
16 kam bindje të plotë se në përputhshmëri me atë të cilat i kemi
17 nënshkruar ne do të ketë sukses të plotë procesi i
18 transformimit dhe demilitarizimit të UÇK-së.

19 PËRKTHYESI: "Robin Cook: Jemi të inkurajuar që deri tani
20 UÇK-ja i ka respektuar afatet dhe, në fakt, i ka dorëzuar
21 armët përpara datave brenda të cilave duhet t'i kthenin.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kam edhe vetëm
23 një diapozitiv që më ka mbetur nga kjo pjesë. E kam parasysh
24 dhe kohën.

25 Të gjitha këto dëshmi me video, dëshmojnë se politika e

1 z. Hashim Thaçi ishte e kundërta krejt e politikës që përpiqet
2 që t'i ngarkojë Prokuroria në aktakuzë. Z. Thaçi, ishte një
3 udhëheqës inteligjent dhe pragmatik i cili nxiste rendin dhe
4 rregullin sepse e dinte se kjo ishte e vetmja rrugë për të
5 arritur qëllimin përfundimtar të Kosovë, pavarësinë. Dhe
6 provat e mbështesin këtë konkluzion.

7 Në dallim nga kjo, Prokuroria ka barrën e provës përtej
8 dyshimit të arsyeshëm se nuk kishte asnjë shpjegim të
9 arsyeshëm për këto dëshmi, përpos faktit që z. Thaçi nuk
10 ishte, pra, pjesëtar i kësaj politike, siç pretendojnë ata.

11 ZPS-ja nuk mund t'i bëjë këto argumente duke pasur
12 parasysh dhe provat që ne sapo treguam dhe kundrejt edhe shumë
13 deklaratave dhe dëshmive të shumta në nivelin ndërkombëtar.
14 Prova e barrës së Prokurorisë, sipas mendimit tonë, në këtë
15 çështje gjyqësore do të jetë e papërmueshme. Për shembull, po
16 të shikojmë këtë diapozitiv ky është nga një raport i
17 përgatitur nga Departamenti i Shtetit dhe i Shteteve të
18 Bashkuara të Amerikës në dhjetor të vitit 1999, me titull
19 "Spastrimi etnik në Kosovë" ku thuhet nga Departamenti i
20 Shtetit dhe po citoj që:

21 "Një deklaratë e 20 korrikut ku dënoheshin sulmet kundër
22 serbëve dhe romëve u lëshua nga ish-udhëheqja e UÇK-së dhe
23 ish-udhëheqësi i UÇK-së Hashim Thaçi duke e denoncuar
24 publikisht sulmin e 23 korrikut të Graçkës. Nuk ka asnjë
25 dëshmi se ish-udhëheqja e UÇK-së e ka orkestruar dhunën".

1 ZPS-ja do të duhet t'ju bindë se Departamenti i Shtetit i
2 dinte gabim gjërat dhe duhet t'ju bindin se edhe njerëzit që
3 ishin në terren i dinin gabim gjërat dhe duhet t'ju bindin se
4 këto që sapo pamë është i vetmi shpjegim pas, pra, 23 -- pas
5 fakteve, për pretendimin e tyre sipas të cilit që udhëheqja e
6 UÇK-së dhe sidomos Hashim Thaçi po orkestronin këtë dhunë.

7 Z. Kryegjykatës, pas pushimit do të flas për provat
8 specifike të ZPS-së kundër z. Hashim Thaçi si dhe
9 jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
11 vlerësim se edhe sa kohë ju mbetet për deklaratën tuaj hyrëse?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj se 30 apo 40 minuta pas së
13 cilës z. Thaçi besoj do të flasë për pesë minuta.

14 Ah, edhe z. Kehoe ka fjalë përmbyllëse, por do të jetë
15 shumë e shkurtër. Pastaj do jetë z. Thaçi besoj se deri në
16 orën 12.15 mund të mbarojmë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
18 Mund të uleni.

19 Atëherë këtu bëjmë ndërprerje të seancës deri në orën
20 11.30, ju lutem të riktheheni në atë orë.

21 --- Pauza fillon në orën 11.02

22 --- Seanca rifillon në orën 11.30

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Uluni ju lutem.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit z. Kryetar i
25 Gjykatës.

1 Anëtarë të Trupit Gjykses, shumë nga provat që ju
2 paraqitëm seancën e paradites, përfshirë edhe mesazheve apo
3 deklaratat që janë dhënë në Senatin e Shteteve të Bashkuara,
4 raportet prej OJQ-ve si International Crisis Group - në vijim,
5 sigurisht dolën disa përfundime, të cilat janë konfirmuar nga
6 konstatimet e tribunalit ndërkombëtar.

7 Pra, krahas mungesës së provave për të mbështetur
8 teorinë, barra e Prokurorisë është më e lartë në këtë rast se
9 shumë prej pretendimeve të ZPS-së në fakt janë rrëzuar nga
10 TPNJ-ja.

11 Dhe ky është diapozitivi 102 për transkriptin.

12 Justifikimet e ZPS-së dje për të shmangur rëndësinë e
13 këtyre konstatimeve nuk janë bindëse për arsyet që do t'i
14 shpjegoj në një çast.

15 Shkojmë te diapozitivi 103.

16 Por, pikësëpari le të diskutojmë konstatimet e TPNJ-së.

17 Për të vërtetuar se i akuzuari në këtë çështje është
18 përgjegjës për krime lufte që janë kryer në verën 1999,
19 Prokuroria duhet të vërtetojë se ekzistonte konflikti i
20 armatosur në Kosovë deri në shtatorin 1999. Por Prokurori i
21 TPNJ-së doli në përfundimin se konflikti i armatosur përfundoi
22 në Kosovë në qershor 1999, dhe për rrjedhojë TPNJ-ja nuk
23 kishte juridiksion për të hetuar krimet që ishin kryer në
24 Kosovë pas muajit qershor 1999. Kjo i është paraqitur
25 Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara më 24 nëntor

1 2000. Mund ta shihni dhe në ekran.

2 Diapozitivi 104.

3 I njëjti përfundim doli edhe nga Clint Williamson,
4 prokurori i TFHS-së, që ishte krijuar nga Bashkimi Evropian
5 apostafat për të hetuar pretendimet e Dick Marty. Z.
6 Williamson në fakt është paraardhësi në fakt -- është në një
7 farë mënyre -- paraardhësja e Zyrës së Prokurorisë së sotme.
8 Edhe tha në një njoftim për shtyp:

9 "Realiteti është që TPNJ-ja kishte juridiksion të
10 trajtonte krimet që kanë ndodhur gjatë periudhës së konfliktit
11 të armatosur, pra deri në momentin që lufta përfundoi në mes
12 të qershorit 1999."

13 Z. Williamson u shpreh se konflikti i armatosur në Kosovë
14 përfundoi, thuhet shprehimisht në mes të qershorit 1999, por
15 mesa duket ZPS-ja paska zbuluar disa prova -- pa marrë
16 parasysh deklaratat e z. Williamson, edhe nga kjo periudhë
17 edhe në momentin që dorëzoi aktakuzën paska bazuar prova që
18 qenkan kaq bindëse se ka ekzistuar një konflikt i armatosur në
19 Kosovë pas qershorit 1999, saqë ju si Trup Gjykues do ta
20 shihni dhe do të dilni në përfundim se nuk janë prova të
21 arsyeshme, sepse konflikti i armatosur në fakt nuk ekzistoi
22 pas qershorit 1999. Dhe kjo është konstatuar nga dy prokurorë
23 ndërkombëtarë.

24 Shikojmë diapozitivin 105.

25 Gjashtë nga pikat -- dhjetë pikat e Prokurorisë janë për

1 krimet kundër njerëzimit. Për të vërtetuar këto pika,
2 Prokuroria duhet të vërtetojë se ka pasur sulm të zgjeruar dhe
3 sistematik kundër popullsisë civile gjatë periudhës së
4 aktakuzës. Nëse nuk e vërtetojnë dot këtë, këto gjashtë pikat
5 e aktakuzës duhen rrëzuar, dhe ju duhet të shfajësoni të
6 akuzuarit për këto pika.

7 TPNJ-ja, në çështjen Limaj, doli në përfundimin se nuk
8 kishte sulme të zgjeruara dhe sistematike kundër popullatës
9 civile. Por duhet t'i përsërisim në fakt, dhe duhet të flasim
10 për krimet kundër njerëzimit. Në paragrafin 210 - 217,
11 konstatimet ishte se nuk kishte sulme sistematike të zgjeruara
12 kundër serbëve apo shqiptarëve, as ndonjë politikë për të
13 shënjestruar civilët. Politika ishte vetëm për ata që ishin
14 kolaboracionistë të regjimit serb, edhe kjo lidhej me
15 objektivat ushtarake të UÇK-së; raste kidnapimi ndodhën në
16 mënyrë të izoluar apo të veçuar nga keqbërës, dhe çdo gjë
17 bëhej jashtë kontrollit të UÇK-së sepse në fakt UÇK-ja nuk
18 kishte kontroll efikas.

19 Në paragrafin 228 të aktgjykimit thuhet nuk ka pasur
20 politikë për të shënjestruar popullatën civile, por një
21 politikë që shënjestronte ata që kolaboronin, bashkëpunonin,
22 me regjimin serb, dhe kjo ishte e lidhur me objektivat
23 ushtarake, sikurse është përcaktuar në aktgjykim.

24 Konstatimi i fundit po ashtu pranon se në fakt kishte
25 kolaboracionistë me regjimin serb, diçka që Prokuroria dje nuk

1 e pranoi.

2 Në diapozitivin 106.

3 Po ashtu, nuk duhet të habiteni kur të dëgjoni se çështja
4 e komunikatave të UÇK-së është diskutuar edhe më përpara në
5 gjykata e tribunale të tjerë që i ka rrëzuar përpjekjet e
6 mëhershme të prokurorëve për të përshkruar, për t'i lidhur
7 motivet kriminale me lëshimin e këtyre komunikatave.

8 Për shembull, TPNJ-ja, Dhoma pranon se komunikatat
9 shërbenin pjesërisht për qëllime propagandistike, "vetëm ata
10 që besoheshin ose besohesh se kishin lidhje me regjimin serb".
11 Dhe kjo politikë "lidhesh me objektivat ushtarake [të UÇK-së]".
12 Kjo janë paragrafët 216, 217 të aktgjykimit Limaj që në fakt i
13 keni përpara në ekran.

14 Në paragrafin 216, trajtohet çështja e komunikatave --
15 është pjesa që e shikoni të nënvizuar:

16 "Dhoma pranon se komunikatat pjesërisht përdorshin për
17 qëllime propagandistike. Mirëpo ekzistonte një strategji e
18 UÇK-së e lidhur me objektivat e saj ushtarake për të goditur
19 ata individë të cilët mendohej se bashkëpunonin me forcat
20 serbe. Gjithsesi, nën maskën e konkretizimit të kësaj
21 strategjie, një numër civilësh shqiptarë të Kosovës mund të
22 jenë të rrëmbyer për arsye të tjera, si hakmarrje personale e
23 anëtarëve të veçantë të UÇK-së apo motive të tjera. UÇK-ja nuk
24 kishte burime apo strukturën komanduese të kontrollonte siç
25 duhej zbatimin e kësaj strategjie prej forcave të veta, gjatë

1 kohës që ka lidhje me aktakuzën, dhe Dhoma pranon se rastet
2 individuale të rrëmbimeve për arsye jo në lidhje me
3 strategjinë ndaj bashkëpunëtorëve u kryen nga elementë të
4 këqij të UÇK-së”.

5 Po ashtu, theksoj se Prokuroria dje tha, se pas
6 konfliktit të akuzuarit u përpoqën të justifikojnë këto
7 komunikata si propagandë, dhe dje na thanë se kjo ishte në
8 fakt “absolutisht e rremë”. Në fakt, Prokuroria nuk po
9 argumenton se të akuzuarit kanë gënjyer, këtu po thonë që vetë
10 TPNJ-ja ka dalë me konstatime të rrema, të pavërteta.

11 Nuk do të dëgjoni ndonjë provë të re nga ZPS-ja në këtë
12 gjykim, që t’ju ndihmojë ju të dilni në ndonjë gjykim të
13 ndryshëm nga ai që pati TPNJ-ja në çështjen Limaj.

14 Diapozitivi 107.

15 TPNJ-ja në çështjen Haradinaj po ashtu nuk konstatoi
16 konstatimin e NKP-je që shënjestronte kolaboracionistët.
17 Aktgjykimi Haradinaj refuzoi faktin që kishte NPK dhe që
18 shënjestronte kolaboracionistët, thanë që nuk kishte sulme të
19 zgjeruara sistematike ndaj popullatës civile, nuk kishte plan
20 për të konsoliduar kontrollin e UÇK-së ndaj zonës operative të
21 Dukagjinit, përmes keqtrajtimit të civilëve, dhe “viktimat
22 zgjidheshin për arsye që kishin vetëm të bënë me individin”,
23 dhe kjo është në kundërshtim me pretendimin e ZPS-së se
24 popullata civile shënjestrohej.

25 Diapozitivi 108.

1 Tani, për të anashkaluar konstatimet e TPNJ-së dhe për të
2 përshtatur siç iu volit atyre, ZPS-ja ka ripërkufizuar në një
3 farë mënyre elementët e krimeve kundër njerëzimit. Pra në vend
4 që të pretendojnë se ka pasur një sulm të zgjeruar sistematik
5 kundër popullatës civile, ata kanë thënë që ka pasur një sulm
6 të zgjeruar, sistematik, ndaj popullatës civile të
7 kundërshtarëve. Kjo qasje marginalizon të drejtën kombëtare
8 humanitare me pasoja të paparashikuara për çështje në të
9 ardhmen.

10 Aktgjykimi në Limaj konstatoi se numri i viktimave të
11 krimeve ishte relativisht i vogël, në qoftë se krahasohet me
12 popullatën në përgjithësi.

13 Dhe Prokuroria është përpjekur të ndërtojë një çështje
14 duke rritur numrin e viktimave, ndërkohë që në të njëjtën kohë
15 ka ulur përkufizimin, apo ka ndryshuar përkufizimin e
16 popullatës civile. Pra, ka rritur e ka bërë në një farë mënyre
17 që një pjesë e madhe e një popullate që në fakt ishte
18 relativisht e vogël, u shënjestrua. Sidoqoftë ZPS-ja nuk na
19 jep asnjë burim nga e ka gjetur këto popullatë civile, pse e
20 ka ndryshuar këtë përkufizim.

21 Dhe është shumë e rëndësishme, se provat në gjykim do të
22 na tregojnë se Prokuroria në këtë çështje nuk do të jetë në
23 gjendje që ta rrisë as numërorin. Numri i viktimave në
24 çështjen Limaj që pretendohen se u kidnapuan nga forcat e UÇK-
25 së ishte gati 140 - dhe mund ta shihni këtë në aktgjykimin --

1 paragrafi 209, dhe numri në këtë rast është rreth 440. Kjo
2 shifër nuk ndikon në mënyrë thelbësore përfundimet që ka patur
3 në rastin e çështjes Limaj, pra që nuk ka pasur sulm ndaj
4 popullatës në përgjithësi.

5 Ju lutem, më lejoni t'ju them edhe një risi tjetër që po
6 përpiqet të ndjekë ZPS-ja. Komandantët e zonës në çështjen
7 Limaj dhe Haradinaj u shfajësuan pjesërisht sepse nuk pati
8 NPK, nuk pati zona, dhe nuk pati krime kundër njerëzimit në
9 zonat e tyre përkatëse. Por ZPS-ja tani po akuzon eprorët e
10 pretenduar të këtyre komandantëve të zonave që janë shfajësuar
11 për këtë gjë, se kanë marrë pjesë përmes ndërmarrjes kriminale
12 të përbashkët, me të njëjtët komandantë zone që tashmë janë
13 shfajësuar dhe kanë kryer krime kundër njerëzimit në zonat që
14 ka pasur parasysh dhe TPNJ-ja kur rrëzoi pretendimet.

15 Ne themi që kjo është e gabuar. Si mund ta zbatonte i
16 akuzuari këtë NKP me komandantë të zonave që janë shfajësuar
17 është diçka që ZPS-ja nuk e shpjegon.

18 Sigurisht që UÇK-ja nuk e kishte politikë të
19 shënjestronte kundërshtarët.

20 Edhe njëherë, konkretisht thanë:

21 "Provata nuk tregojnë dhe as thonë një politikë të -- prej
22 provave -- pra që ka Dhoma, UÇK-ja nuk tregoi strategji për
23 vënien në shënjestër të civilëve si të tillë".

24 Dhe ju tregova më herët konstatimet e aktgjykimit Limaj
25 që çdo keqpërdorim nga forcat e UÇK-së ose ishte jashtë

1 politikës së UÇK-së dhe UÇK-ja nuk kishte burimet apo
2 strukturën komanduese për të kontrolluar siç duhet forcat e
3 veta. Ky është paragrafi 216 i aktgjykimit Limaj.

4 Dhe, më lejoni t'ju them edhe një herë, se përdorimi i
5 forcave të UÇK-së, dhe po themi që UÇK-ja nuk mund ta
6 kontrollonte për shumë arsye edhe këto janë për arsye që
7 Mbrojtja e Thaçit ia ka paraqitur Trupit Gjykues, siç ishte
8 domosdoshmëria për vetëmbrojtje kundër fushatës ushtarake
9 serbe dhe krimeve që z. Kehoe jua ka përshkruar më herët.

10 Pra, ZPS-ja duhet të thotë tani që të gjitha
11 institucionet që i kanë trajtuar këto çështje në të shkuarën,
12 i kanë pasur të gjitha konstatimet të gabuara.

13 Pavarësisht konstatimeve të TPNJ-së dhe të z. Williamson,
14 tani ZPS-ja argumenton se ka pasur NKP që shënjestronte
15 kundërshtarët dhe kolaboracionistët, se UÇK-ja është përfshirë
16 në sulme të zgjeruara dhe sistematike, këto sulme
17 shënjestroheshin ndaj popullatës civile të kundërshtarëve, dhe
18 ekzistonte konflikti i armatosur pas qershorit 1999 dhe deri
19 në shtator 1999.

20 ZPS-ja, 20 vjet [sipas përkthimit] pas faktit tani thotë
21 që TPNJ-ja e ka pasur gabim, siç e ka pasur edhe paraardhësi
22 TFHS-ja, z. Williamson. Duhet t'ju vërtetojnë ju, se TPNJ-ja,
23 z. Williamson, e kishin gabim dhe arsyetuan në mënyrë të
24 gabuar apo se ZPS-ja duhet të ketë zbuluar prova të reja që
25 asokohe nuk i kishte në dispozicion TPNJ-ja, z. Williamson,

1 apo të dy. Kjo është -- i kanë hyrit detit në këmbë

2 Prokuroria, mund të themi.

3 Prokuroria dje, e pranoi se në fakt ka një problem që ne
4 i themi 'problemi i TPNJ-së'. Dhe për ta anashkaluar këtë
5 problem, ata prezantojnë dy argumente kryesorë. Ju thonë këtu,
6 lini mënjane, harrojini konstatimet e TPNJ-së sepse
7 Prokuroria, "asnjë gjykatë më herët nuk ka shqyrtuar rolin dhe
8 përgjegjësinë e anëtarëve kryesorë të Shtabit në mënyrën siç
9 do ta bëjë Trupi Gjykes në këtë rast."

10 Kjo është shtrembëruese në fakt. Sepse unë sapo e tregova
11 që trupi gjykes në çështjen Limaj doli në përfundimin, pranoi
12 pra, se UÇK-ja nuk e kishte strukturën komanduese për të
13 kontrolluar zbatimin e politikave për të ndaluar
14 kolaboracionistët në zbatim të objektivave ushtarake.

15 Së dyti, fakti, kur thonë që ju jeni Trupi i parë Gjykes
16 që do të shqyrtoni përgjegjësinë e Shtabit të Përgjithshëm
17 kemi pikëpyetje tani, dhe shtrohet pyetja, pse qenkeni ju
18 Trupi i parë Gjykes që do të shqyrtoni këtë çështje? Ju jeni
19 Trupi i parë Gjykes që po e shqyrtoni sepse asnjë prokuror më
20 herët as nuk i shkoi në mendje që kishte prova të mjaftueshme
21 për të ngritur akuza për cilindo në Shtabin e Përgjithshëm për
22 krime që janë kryer në vitin 1998 dhe 1999. I pamë provat që
23 kishin, dhe thanë që janë të pamjaftueshme për të ngritur
24 akuza asokohe.

25 Pesëmbëdhjetë vjet më vonë, sidoqoftë, ZPS-ja ngre akuza

1 bazuar në thelb, mbi të njëjtat prova. Tani ZPS-ja përpigjet ta
2 ndajë çështjen e vet nga ajo e TPNJ-së edhe mbështetet në
3 dokumente që janë sekuestruar nga z. Selimi dhe nga z.
4 Krasniqi. Por, ZPS-ja ama nuk i kishte këto dokumente kur
5 ngriti akuzat në këtë çështje. Dorëzuan një aktakuzë bazuar
6 mbi të njëjtat prova që TPNJ-ja, OTP-ja, konstatoi se ishin të
7 pamjaftueshme.

8 Dje ZPS-ja po ashtu argumentoi se "asnjë gjykatë nuk ka
9 pasur provat që do të ketë ky Trup Gjykues në këtë çështje".
10 Por për çfarë provash konkretisht flet ZPS-ja që janë kaq
11 thelbësore sa do të kërkojnë që ju të prapësoni konstatimet e
12 TPNJ-së dhe të Trupit Gjykues për të cilin sapo ju fola pak më
13 herët. Sigurisht, që ZPS-ja nuk evidentoi konkretisht për
14 cilat prova po fliste dje.

15 Anëtarë të Trupit Gjykues, në fund të provave të
16 Prokurorisë do t'ju pyesim: TPNJ-ja dhe z. Williamson, a e
17 kishin gabim, apo e ka gabim ZPS-ja si pasojë e zellit të
18 tepërt që kanë për të ndjekur penalisht z. Thaçi?

19 Diapozitivi 113.

20 I kthehemi besueshmërisë dhe mjaftueshmërisë së provave
21 të ZPS-së. Sigurisht, ne nuk duam të themi të gjitha cenet që
22 kemi gjetur në provat e Prokurorisë sepse ky Trup Gjykues me
23 përvojë e di që ka vlera forenzike të mjaftueshme ku
24 dëshmitarët sigurisht që japin prova që ndonjëherë janë të
25 paqarta, kur merren në kundërpjetje.

1 Të jeni të sigurt që ne nga ana e Mbrojtjes do të kemi --
2 ne do të nxjerrim provat tona kur t'i marrim në pyetje
3 dëshmitarët. Por megjithatë, do t'ju japim disa shembuj për të
4 treguar se sa defekte ka Prokuroria në provat e veta.

5 Diapozitivi 114.

6 Shembulli i parë është çështja -- marrim të parën. Dy
7 gazetarë serbë. Thuhet, dy gazetarë serbë u mbajtën të ndaluar
8 dhe u morën në pyetje nga Hashim Thaçi dhe Fatmir Limaj.
9 Pretendohet se u kanosën, u rrahën, dhe aktakuza thotë,
10 "çështja tërhoqi vëmendjen e përfaqësuesve ndërkombëtarë", dhe
11 në fakt organizatat Human Rights Watch nxori një deklaratë
12 publike lidhur me kidnapimin e këtyre "gazetarëve".

13 Ju lutem të mos e shfaqim në publik diapozitivin e
14 radhës.

15 ZPS-ja i identifikoi dy gazetarët e pretenduar. E lëmë
16 mënjane pretendimin që z. Thaçi është përfshirë në ndonjë
17 formë në ndalimin e këtyre individëve, qoftë përmes marrjes në
18 pyetje apo në çdo formë tjetër të cilën z. Thaçi e mohon
19 kategorikisht. Por çfarë bëri ZPS-ja për ta verifikuar
20 statusin e këtyre individëve, dhe të konfirmonte që në të
21 vërtetë këta ishin gazetarë, dhe për më tepër që këta ishin
22 civilë?

23 Personi të cilit unë këtu -- unë do t'i them Gazetari i
24 ZPS-së numër 1, në fakt nuk ishte thjesht një gazetar.
25 Dyshohej se ishte krim [sipas përkthimit] lufte serb që ka

1 marrë pjesë në luftën në Kroaci edhe luftëtar edhe në luftën
2 që është bërë në Bosnjë. Provat do të tregojnë se Gazetari 1
3 është mbuluar, pra ka përdorur mbulimin se ka qenë gazetar
4 duke përdorur edhe kredencialet e mediave, por në fakt ishte
5 një nacionalist radikal, një luftëtar, dhe dokumenti që keni
6 para është një dokument i Republika Srpska, Ministria e
7 Brendshme, dhe është një dokument, pra, që vjen nga territori
8 i Kroacisë edhe në këtë dokument sigurimi i shtetit e
9 identifikon këtë Gazetarin 1 dhe thotë që ka shkuar në Kroaci,
10 "me një grup vullnetarësh nga Serbia dhe Bosnjë dhe
11 Hercegovina".

12 Raporti them -- "tha se ishte fotograf gazetash nga një
13 organizatë mediash dhe se kishte edhe kartën e identifikimit
14 si gazetar. Por ai shprehu dëshirën për t'u bashkuar me
15 njësitin mbrojtës".

16 Vazhdojmë:

17 "Grupi i vullnetarëve iu afrua" Gazetarit 1, "dhe ata në
18 fakt kishin reputacionin si kriminelë, shfrytëzonin këtë
19 pozitë për të bërë plaçkitje, vjedhje e kështu me radhë, madje
20 edhe vrasje".

21 Dhe vazhdon:

22 "Për shkak të aktiviteteve kriminale, dhe vrasjeve që u
23 kryen, sidomos afër zonës së Skabrinjës, ata vranë me dhjetëra
24 civilë, dhe u vendos që ky njësit të mbyllej për shkak të
25 atyre që bënte".

1 Dhe për këtë në fakt u dënua edhe Milan Martić me
2 përgjegjësi NKP nga TPNJ-ja. Dhe ky është Gazetari 1 që përdor
3 ZPS-ja dhe ky është një gazetar që na ka rastisur të ketë qenë
4 dhe në Kosovë në vitin 1998.

5 Ajo që është e rëndësishme për këtë dokument është ky
6 dokument vjen, e kemi marrë nga arkivat e TPNJ-së. Këtë e
7 përdor Prokuroria për të dënuar, është një nga provat që ka
8 përdorur Prokuroria për të dënuar Milan Martić.

9 Diapozitivi i radhës.

10 Po ashtu nga TPNJ-ja e kemi marrë nga arkivat e tyre,
11 këtë deklaratë të dëshmitarit, emrin e keni përpara, nuk do ta
12 lexoj. Prokuroria tha se Gazetari 1 ishte një "çetnik dhe
13 është shfaqur në këtë zonë në luftën në Kroaci, dhe ai u jepte
14 armë serbëve në mars 1992 në Bosnjë, serbëve në Bosnjë".

15 Prokuroria, njësoj si ju, po merr vesh për herë të parë
16 sot, kush është ky Gazetar. Kush ka qenë në të vërtetë ky
17 Gazetar. Deri në këto momente Prokuroria nuk e ka ditur se një
18 nga këta dy gazetarët serbë në fakt -- dyshohet se ishte
19 kriminel lufte dhe ka qenë luftëtar në luftën e Kroacisë dhe
20 Bosnjës.

21 Ne e dimë se dokumentet që ju treguam nuk janë përgatitur
22 nga ZPS-ja, dhe duhet të na nxirrnin në fakt materiale
23 shfajësuese në qoftë se do i kishin në zotërimin e tyre. Fakti
24 që nuk na i kanë treguar, na bën të dalim në përfundimin se
25 ZPS-ja nuk është në dijeni se kush ishte në të vërtetë

1 Gazetari 1 i ZPS-së.

2 Mosdijsja e Prokurorisë është shqetësuese, sepse ky është
3 një shembull se si Prokuroria në këtë çështje nuk ka ndërmarrë
4 hapat më thelbësorë të një hetimi, të përcaktonte fillimisht
5 faktet, dokumentet që sapo ju shfaqëm janë publike. Ne hymë në
6 faqen online të TPNJ-së, shtypëm emrin e Gazetarit 1 edhe na
7 dolën dokumentet brenda sekondash.

8 Dhe sa të tjera, sa viktimat të tjera të Prokurorisë kemi
9 që Prokuroria të mos u ketë kontrolluar të shkuarën?

10 Prokuroria nuk ka tentuar fare ta kontrollojë emrin e
11 këtij në bazën e të dhënave të TPNJ-së për të kuptuar kush
12 ishte ky individ. Ne nga ana tjetër, ju themi se ka edhe emra
13 të tjerë që as nuk e ka marrë mundimin t'i verifikojnë. Disa u
14 përmendën dhe dje në deklaratat hyrëse të ZPS-së. Por do të
15 përmend edhe më shumë edhe gjatë gjykimit, edhe ne do t'i
16 ballafaqojmë në pjesën e kundërpyetjeve.

17 Të nderuar Anëtarë të Trupit Gjykes, Prokuroria ka
18 barrën të vërtetojë statusin civil të çdo personi që
19 pretendon se ka qenë viktimë civile e krimeve të paraqitura
20 në aktakuzë. Çështja apo aspekti, apo ky "gazetar" serb,
21 tregon se as nuk kanë filluar ta hetojnë ndonjëherë statusin e
22 viktimave të pretenduara, dhe gjyqi është duke filluar.

23 Diapozitivin e radhës mund ta shohim edhe -- mund ta
24 përcjellim edhe për publikun.

25 Diapozitivi 119.

1 Flasim tani për pretendimin 110 dhe 111 të aktakuzës që
2 më 20 shtator ose rreth asaj date, 1998, trembëdhjetë anëtarë
3 të delegacionit parlamentar u mbajtën në Qirez. Dhe
4 pretendohet se i çuan në një shkollë në Baicë, dhe pretendohet
5 se "u rrahën mizorisht dhe ishin objekt i abuzimit
6 psikologjik". Më pas, pasi këta anëtarë "u rrahën mizorisht
7 dhe kishin dëmtime të dukshme", u morën në pyetje, pretendohet
8 se u morën në pyetje nga Hashim Thaçi, ndër të tjerë. Ky
9 pretendim u tha edhe dje te deklaratat hyrëse të ZPS-së. Por a
10 është i vërtetë?

11 Diapozitivi 120.

12 Këta parlamentarë, a u rrahën vërtet mizorisht dhe kishin
13 lëndime të dukshme? Mbrojtja do të ketë shumë për të thënë kur
14 të marrë në pyetje dëshmitarët në pjesën e kundërpyetjeve për
15 ngjarjet që kanë ndodhur në Qirez dhe Baicë. Ju do të dëgjoni
16 dëshmi për shqetësimet e sigurisë të krijuara nga dy
17 delegacion. Por ne do ju tregojmë një video të deputetëve
18 menjëherë pas lirimit të tyre më 23 shtator 1998. Dëgjoni nga
19 vetë parlamentarët në këtë video dhe gjykoni ju nëse janë
20 rrahur mizorisht, a kanë lëndime të dukshme.

21 Mund të dëgjoni edhe dëshmitë e asokohe që kanë dhënë
22 nëse janë keqtrajtuar gjatë kohës që janë mbajtur të ndaluar.

23 Diapozitivi i radhës.

24 Videoja që do t'ju tregojmë është nga një dokument, nga
25 një emision në Kosovë që është shfaqur më 21 tetor 2020, ku

1 është dhe një deklaratë, njoftim për shtyp që kanë bërë këta
2 parlamentarë më 23 shtator 1998. Prandaj do të shihni datën 21
3 tetor 2020, por për qëllimet tona na shërben videoja që do të
4 shohim tani dhe që është marrë më 23 shtator 1998.

5 [Luhet videoincizimi]

6 "Prezantuesi: -- një konferencë -- pas kthimit nga kjo
7 vizitë në Drenicë e cila është komentu gjatë edhe që besoj se
8 do të komentohet akoma më shumë. Ta shohim këtë material e
9 kthehemi në studio për ta dëgjuar pastaj rrëfimin e z. Dedaj
10 për atë që çfarë ka ndodhur atje.

11 "Gjergj Dedaj: Me të arritur në Qirez, pasi kemi kaluar
12 në një rrugë nëpër disa fshatra, tash jemi ndalu disa herë,
13 bile në fund [e pakuptueshme] policisë serbe edhe nga një orë
14 e gjysmë. Domethënë, ka arritur një efektiv i policisë siç
15 thanë ata sekrete e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët
16 kanë pyet për kush është organizatori, kush udhëheq grupin,
17 kush janë këta këtu. Ne, thashë, ishim nga Prishtina 30
18 pjesëmarrës të një delegacioni, duke përfshi edhe gazetarët".

19 "Unë -- kanë pasë biseda edhe të ndara me ne, kryesisht
20 janë interesu për aktivitetin tonë politik, aktivitetin sociol
21 -- unë flas për bisedat që kanë pasë për mu aktivitetin tim
22 politik në cilësinë e Nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës,
23 edhe në cilësinë e Kryetarit të Partisë Liberale të Kosovës.
24 Metoda e marrjes tonë, ndalimit tonë, për mu personalisht
25 ishte e pakuptimtë, e panevojshme, sepse nuk ishim njerëz të

1 panjohur për opinionin. Aktiviteti ynë gjithmonë ka qenë
2 legal. Do t'i japim prioritet.

3 "Dje pasi ka fillue një ofensivë shumë e egër, dhe
4 Drenica ishte në një shtetrrëthim të plotë, mund të them të
5 hekurt, në Qirez kemi parë një gjendje tashmë edhe rrugës për
6 Qirez, kur njerëz lëviznin në drejtime të ndryshme, duke ikur,
7 dhe e pyetnin njënin, kah je ka shkon ti, kah po shkoj unë,
8 domethënë një gjendje ku njerëz vërtet në udhëkryq nuk dinin
9 ku po shkon, një gjendje që s'mund të përshkruhet, domethënë,
10 si pasojë e kësaj ofensive të egër serbe, dhe ishin mjaft të
11 shqetësuar.

12 "Deri në orën 14.00, domethënë, të ditës së djeshme,
13 domethënë 48 orë, dhe kështu na kanë shqiptuar se jemi të
14 liruar, dhe ju kemi mbajtur në ndalim për 48 orë. Interesimi i
15 tyne ishte domethënë në radhë të parë pse nuk e kemi
16 paralajmëru vizitën, që mendoj që ne nuk do ta paralajmërojmë
17 vizitat kur shkojmë asnjëherë. Edhe do shkojmë edhe në
18 territore të tjera, sepse thashë, kemi obligim se po shkojmë
19 te njerëz tonë, te tokat tona, te trevat tona.

20 "Nuk kemi qenë të kërcënuar, them në kuptimin e fjalës
21 'kërcënim', kur mendoj se ndalesa sipas mendimit tim ishte e
22 pakuptimtë, nuk ka sepse, nuk kish kurrfarë arsye që ne të
23 ndalohemi përderisa ne ishim të gjithë persona publikë.
24 Domethënë ishim njerëz që për aktivitetin tonë, për punën
25 tonë, gjithmonë, domethënë e din opinionin dhe është ditë e

1 kemi punu në mënyrë legale. Prandaj ne s'kishim shkuar atje të
2 bënim kurrfarë propagande as politike, as partiake, as kundër
3 UÇK-së, as pro UÇK-së.

4 "Ne, thashë, edhe në fillim, misioni i ynë ishte i
5 karakterit humanitar.

6 "Ato forca, ai efektiv që jemi taku, kanë pasë sjellje
7 korrekte me ne, ndërsa sa i përket asaj se ne jemi parti të
8 tjera, jemi domethënë, të afërta me Presidentin Rugova, mendoj
9 se çdo respekt kemi të gjitha partitë politike për z. Rugova,
10 Presidentin e Republikës së Kosovës, i cili në zgjedhjet e
11 fundit ka fitu votën e popullit të Kosovës.

12 "Nuk kam dijeni çfarë argumentesh kanë pasë ata, por mund
13 t'ju them publikisht se nga gjithë pjesëmarrësit që ishin, nuk
14 mund të ekzistojë as në letër dhe as e thënë me gojë, as me
15 shkrim, se jemi kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kundër
16 organizimit institucional të Kosovë".

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndërkohë që parlamentarët pa
18 diskutim protestuan kundër faktit që ishin ndaluar, ata thonë
19 që, "ne nuk u kërcënuam, në kuptimin real të fjalës
20 'kërcënim'" dhe ata thonë që "forcat, njësitë që u takuan me
21 ne u sollën në mënyrë korrekte."

22 Në kundërshtim me pretendimet e Prokurorisë në aktakuzë
23 dhe asaj çfarë na thanë ata dje, këta parlamentarë nuk duken
24 se kanë, "lëndime të dukshme" siç pretendohet dje nga
25 Prokuroria.

1 Për momentin, do ta lëmë këtë diskutim, pra sa i takon
2 pretendimeve rreth ngjarjeve në Qirez, megjithatë do të kemi
3 shumë herë më tepër për të thënë lidhur me këtë çështje gjatë
4 marrjes në pyetje të dëshmitarëve të Prokurorisë.

5 Diapozitivat e radhës nuk duhet t'i tregohen publikut.

6 Në fund, do të flasim për pretendimet që z. Thaçi ka
7 pasur lidhur me zhdukjen e dy personave, dy viktimave, në
8 Drenoc. Prokuroria pretendon që ka dy persona të cilët janë
9 marrë në pyetje, janë ndaluar dhe më pas janë rrahur me mjete
10 të ashpra në Drenoc dhe më pas janë dërguar në drejtimin e
11 selisë së përgjithshme të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së
12 nga Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli me praninë edhe të Rexhep
13 Selimit. Dje u parashtruar gjithashtu që këta të ndaluar nuk
14 janë parë më që prej asaj kohe.

15 Vazhdojmë te diapozitivi 123.

16 ZPS-ja nuk ka prova të besueshme që z. Thaçi ka qenë i
17 përfshirë në zhdukjen e këtyre dy individëve, dhe kjo për
18 shkak të faktit se ai nuk ka qenë fare i përfshirë në këtë
19 gjë. [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 Duam që të theksojmë që të gjithë individët që kanë
7 fabrikuar pretendime të tilla kishin motive të qarta për ta
8 bërë këtë gjë, gjë e cila do t'ju bëhet e ditur gjatë procesit
9 gjyqësor.

10 Për momentin, nuk do të themi më tepër në mënyrë të tillë
11 që të mbrojmë pacenueshmërinë dhe efektivitetin e marrjes në
12 pyetje të dëshmitarëve të ZPS-së, megjithatë të jeni të sigurt
13 që shumë shpejt ne do të kemi shumë gjëra për të thënë lidhur
14 me këtë pretendim.

15 Kalojmë te diapozitivi tjetër, i cili mund të tregohet
16 për publikun.

17 Dua të falënderoj Trupin Gjykses për vëmendjen sot
18 paradite, dhe tani më lejoni t'i jap fjalën z. Kehoe për
19 komentet përmbyllëse, në qoftë se do të më jepni leje, i
20 nderuar z. Gjykatës.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni lejen
22 time.

23 Z. Kehoe, fjala për ju.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit z. Kryetar i Seancës,
25 të nderuar Gjykatës, kolegë. Do të mundohem që të jem shkurt.

1 Në përfundim, përpara sesa Presidenti Thaçi të bëjë disa
2 komente të vetat për Trupin Gjykses, më lejoni që të mbuloj
3 disa prej çështjeve që në fakt i shtjelluam dhe gjatë
4 paradites sot. Në thelb, ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses që të
5 konstatojë përtej dyshimit të arsyeshëm, një konspiracion
6 masiv që katër të akuzuarit kanë marrë pjesë në aktet të cilat
7 janë të paraqitura si pjesë e aktakuzës. Sikurse u zbulua në
8 këtë deklaratë hapëse, këto prova janë simpliste dhe
9 shpeshherë janë edhe të gabuara.

10 Dhuna në vetvete ka ardhur si rezultat i arsyeve të
11 shumta, si p.sh. lufta kaotike e cila ishte e lokalizuar në
12 bazë e ishte e mbështetur nga njerëzit të cilët po mundoheshin
13 që të mbronin shtëpitë e tyre dhe fshatrat e tyre.

14 Sa i takon komandës dhe kontrollit, ZPS-ja dëshiron që ju
15 të besoni që kishte komandë vertikale, komandë dhe kontroll
16 vertikal brenda UÇK-së që funksiononte pa asnjë devijim apo pa
17 asnjë gabim. Dhe në fakt nuk është kështu situata. Nuk kishte
18 komandë dhe kontroll efektiv dhe nuk është e nevojshme që ne
19 të përmendim ndonjë incident tjetër përveç faktit që
20 komandantët e zonës kanë ndryshuar Komandantin e Përgjithshëm
21 të UÇK-së pa u konsultuar as me z. Thaçi dhe as me askënd
22 tjetër.

23 Përveç kësaj, nuk ka asnjë lloj indikacioni nga ZPS-ja që
24 ata kanë përfshirë atë çfarë ka ndodhur në terren në atë kohë.
25 Bëhej fjalë për një kohë lufte. Bëhej fjalë për një luftë

1 kundër një prej ushtrive më të mëdhaja ose më të fuqishme në
2 Evropë, pra që ishte Ushtria Jugosllave. Pavarësisht kësaj,
3 nuk kishte asnjë lloj shpjegimi, asnjë lloj indikacioni apo
4 diskutimi nga ZPS-ja lidhur me sulmet që ishin realizuar nga
5 Ushtria Jugosllave, apo nga ushtria, policia ushtarake në 1998
6 dhe 1999, dhe nuk u përmend në asnjë pikë të prezantimit të
7 tyre se çfarë kishte shkaktuar kjo ushtri për brigadat dhe
8 batalionet në terren.

9 Këto brigada në fakt u minimizuan në numër në çdo zonë në
10 Kosovë, si rezultat i sulmeve të tilla.

11 Hashim Thaçi ishte pjesë e Drejtorisë Politike. Ai nuk
12 kishte fare asnjë lloj kontrolli mbi trupat, dhe pa diskutim
13 që nuk kishte kontroll në qendrat e ndalimit që ishin të
14 shpërndara në disa vende, në vende të pakta, në fshatra në të
15 gjithë Kosovën.

16 Sa i takon çështjeve të motivit, çdo dhunë e drejtuar
17 kundër civilëve, do ta kishte penguar z. Thaçi që të ishte në
18 kontakt me bashkësinë ndërkombëtare. Pra, në qoftë se do të
19 kishte pasur sulme të tilla të drejtuara kundër tij dhe në
20 qoftë se ai do të ishte i përfshirë në sulme të tilla, nuk do
21 të kishte qenë e mundur dhe për të pasur marrëdhëniet që pati
22 me bashkësinë ndërkombëtare.

23 Në përmbledhje, të nderuar Gjykatës, ndryshe nga
24 deklaratat dhe pozicionet e ZPS-së, Hashim Thaçi nuk ishte një
25 person që dëshironte që të merrte në dorë Kosovën. Ajo që

1 është demonstruar në disa raste dhe njëra prej tyre është një
2 video që do të transmetohet në prezantimin -- që u transmetua
3 në prezantimin e z. Misetic, nuk ishte -- ai ishte një person
4 i cili dëshironte që të sillte së bashku Kosovën, në kuptimin
5 që të gjitha palët e ndryshme do të bëheshin pjesë e procesit
6 të pajtimit edhe të demilitarizonte ushtrinë. Këto janë disa
7 prej fakteve të cilat do t'i shtjellojmë më tej në provat
8 tona. Këto fakte në vetvete hedhin poshtë çdo lloj pozicioni
9 dhe parashtrimi të kundërt të ZPS-së që klienti im z. Thaçi
10 ishte pjesë e një qëllimi kriminal të përbashkët për të marrë
11 peng Kosovën. Nuk ishte kështu rasti.

12 Të nderuar z. Gjyqtar, Kryegjykatës, faleminderit shumë
13 për vëmendjen. Do të kemi mundësinë që të flasim në mënyrë të
14 drejtpërdrejtë drejt fundit të çështjes dhe mezi presim që të
15 vijë radha jonë dhe deri në atë moment ne ju kërkojmë juve që
16 të merrni një vendim pafajësie për z. Thaçi, sepse jemi
17 besimplotë që prova që do të parashtrohen si nga ZPS-ja, dhe
18 nga parashtrimet tona, do të mbështesin plotësisht, pra,
19 moshpalljen e dënimit, ose shpalljen pafajtor të z. Thaçi.

20 Z. Kryesues -- z. Kryegjykatës, faleminderit, e
21 vlerësojmë shumë. Do të donim që tani t'i japim fjalën
22 klientit tim.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa kohë
24 parashikoni?

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Pesë minuta, ndoshta deri në shtatë

1 minuta. Nuk jam i sigurt.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Thaçi, ju
3 lutemi çohuni në këmbë, nëse mundeni.

4 Keni të drejtën që të bëni një deklaratë jo nën betim.
5 Keni të drejtën që të bëni një deklaratë jo nën betim, ju
6 japim këtë të drejtë tani. Ju lutem, mos e zgjasni ndërhyrjen
7 tuaj më shumë se sa pesë minuta. Faleminderit.

8 I AKUZUARI THAÇI: Faleminderit shumë i nderuar z.
9 Kryetar i Trupit Gjykses, z. Smith, të nderuar Gjykatës,
10 Mettraux, Barthe, Gaynor. Faleminderit shumë për mundësinë që
11 t'ju drejtohem shkurt.

12 Sot ne jemi duke nisur një rrugëtim së bashku, një
13 rrugëtim drejt së vërtetës dhe drejtësisë. E vërteta dhe
14 drejtësia janë parime të çmuara për mua. Ato janë gur themel i
15 të gjitha demokracive dhe themel i paqes.

16 Më lejoni të shfrytëzoj këtë moment, për të thënë se
17 ndiej keqardhje dhe dhimbje për të gjitha viktimat e kësaj
18 lufte të tmerrshme, pavarësisht nga përkatësia etnike, fetare
19 apo politike. Viktimat nuk marrin drejtësi kur të pafajshmit
20 ndiqen. Një padrejtësi nuk ndreqet nga një padrejtësi tjetër.

21 Unë jam i pafajshëm për të gjitha këto akuza. Por jam
22 gati të përballem me këtë sfidë të re dhe të kem sukses për
23 familjen time, për popullin tim dhe vendin tim. Rruga jonë
24 drejt lirisë ishte e gjatë dhe shumë e vështirë.

25 Unë isha student në Zvicër, i strehuar politik kur u

1 masakrua familja Jashari në mars të vitit 1998. Si shumë
2 shqiptarë nga diaspora, edhe unë u ktheva për të ndihmuar
3 vendin tim dhe iu bashkova rezistencës për lirinë e Kosovës.
4 Kushdo që do të ishte në vendin tonë, do të kishte bërë të
5 njëjtën gjë kur t'u hiqej liria.

6 Ushtria Çlirimtare e Kosovës përbëhej nga njerëz të
7 thjeshtë, vullnetarë, që përpiqeshin të mbronin shtëpitë,
8 familjet dhe vendbanimet e tyre. Ata luftuan dhe shumë vdiqën
9 trima heronj. Ky ishte çmimi i lirisë. Mijëra familje humbën
10 të dashurit me qindra masakra të forcave serbe. Kundërshtarët
11 tanë ishin ushtria, policia dhe paramilitarët serbë të kalitur
12 në fushatat e tyre të vrasjeve në Bosnjë.

13 Të nderuar të pranishëm, Trup Gjykues, si rezistenca
14 paqësore ashtu edhe ajo e armatosur kishin të njëjtin synim:
15 lirinë, shtetësinë dhe rendin demokratik të Kosovës. Dhe pa
16 atë rezistencë gjithëpopullore sot Kosova nuk do të ekzistonte
17 fare. Qytetarët e Kosovës nuk donin luftë, ata ishin të
18 përcaktuar dhe kishin vullnetin për paqe. Lufta iu imponua.
19 Ata bënë atë që do ta bënte çdo popull liridashës, për të
20 mbrojtur familjet e tyre, fëmijët e tyre, vendin e tyre. Pra
21 ne, Kosova, ishim në anën e drejtë të historisë.

22 Sot unë jam i lumtur që populli i Kosovës jeton në një
23 Kosovë të lirë, të pavarur, të bazuar në të drejta të
24 barabarta për të gjithë qytetarët e saj ku sundon ligji.
25 Kosova pra është rrëfim suksesi.

1 I nderuar Trup Gjykses, gjatë këtij procesi gjyqësor ne
2 do të udhëtojmë prapa në kohë tek ngjarje që kanë ndodhur 25
3 vjet më parë. U kërkoj të gjithëve që të keni parasysh se
4 mbamendja 25 vjet më vonë është e mjegulluar. Realiteti po
5 ngatërrohet me opinione dhe agjenda të ndryshme. Spekulumet po
6 shndërrohen në fakte. Gjithashtu, emocionet, motivet apo
7 mllefet politike të secilitdo akter politik nuk duhet të
8 kuptohen si fakte në këtë sallë. Kjo vlen edhe për disa botime
9 e opinione pas luftës të ekzagjeruara apo të përshtatura të
10 akterëve të ndryshëm të luftës.

11 Si në çdo shoqëri demokratike, edhe tek ne jo çdo
12 bashkëluftëtar i luftës ka qenë edhe bashkudhëtar apo
13 bashkëmendimtar në proceset politike të pasluftës. Në raste jo
14 të pakta, ambicia, interesat politike e egoja personale
15 tejkaloi të vërtetën dhe realitetin për rrëfimin e Ushtrisë
16 Çlirimtare të Kosovës dhe vetë historisë së Kosovës. Njerëzit
17 mbajnë mend atë që duan të besojnë se është e vërtetë, por ne
18 kemi një dëshmi historike dhe faktike të regjistruar në atë
19 kohë. Ne duhet të kthehemi tek ato dëshmi, sepse aty do të
20 zbulohet e vërteta.

21 Më vjen keq që nuk do të kemi mundësi t'i dëgjojmë në
22 këtë gjykatë dëshmitë e Sekretares së Shtetit, Madeleine
23 Albright, Sekretarit të Jashtëm, Robin Cook, Senatorit Robert
24 Dolle, Ambasadorit Richard Holbrooke, z. de Mello - z. de
25 Mello ka qenë Shefi i parë i UNMIK-ut në Kosovë, menjëherë pas

1 luftës, të Presidentit Ibrahim Rugova, të Profesor Fehmi
2 Aganit, të Adem Demaçit dhe liderëve të tjerë. Ata do të
3 kishin dëshmuar në emrin tim për atë çfarë kam thënë dhe bërë
4 gjatë asaj kohe shumë të rëndësishme në historinë e lirisë dhe
5 pavarësisë së Kosovës.

6 Jam i lumtur që shumë të tjerë si ata, vendorë dhe
7 ndërkombëtarë, janë të gatshëm të dëshmojnë për pafajësinë
8 time.

9 Ne besuam në veten tonë, në vendosmërinë tonë, për të
10 qenë të lirë. Por, të gjithë ne në Kosovë e dinim gjatë gjithë
11 kohës, se pa ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, në veçanti të
12 Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nuk do të mund të ishim
13 kurrë të lirë dhe të pavarur. Ne në Kosovë gjithmonë kemi
14 mbështetur drejtësinë, e drejtësinë ndërkombëtare në veçanti.

15 E nderuara Trupë Gjykuese, kur raporti i Dick Marty-t
16 para 13 vjetësh mbushi titujt e mediave ndërkombëtare me akuza
17 të sajua për trafik organesh nga Ushtria Çlirimtare e
18 Kosovës dhe nga unë, unë menjëherë i kërkova bashkësisë
19 ndërkombëtare të hetonte në mënyrë të pavarur. Bashkësia
20 ndërkombëtare më tha se një gjykatë e veçantë ishte thelbësore
21 për të hequr renë e zezë të akuzave për trafik të organeve në
22 Kosovë.

23 Bota tani e di, sot si rezultat i këtij procesi, se nuk
24 kishte trafik organesh dhe se shtëpia e verdhë nuk kanë
25 ekzistuar kurrë. Tani e dimë se edhe unë, edhe Ushtria

1 Çlirimtare e Kosovës, edhe populli i Kosovës, dhe të gjithë
2 shqiptarët jemi shfajësuar nga këto akuza. E vërteta është
3 thënë dhe reja e zezë mbi Kosovën është hequr. Pra, kjo
4 sakrificë ia ka vlejte.

5 Unë pres që të shfajësohem nga çdo akuzë tjetër ndaj meje
6 në përfundim të këtij procesi.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim].

8 I AKUZUARI THAÇI: Shumë shkurt, i nderuar z. Kryegjyqtar.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një sekondë
10 zoti --

11 I AKUZUARI THAÇI: Kjo është gjykata e katërt nga
12 ndërkombëtarët pas asaj të Tribunalit të Hagës, UNMIK-ut,
13 EULEX-it dhe Dhomat e Specializuara. Unë jam intervistuar nga
14 këta mekanizma të drejtësisë ndërkombëtare, qoftë në cilësinë
15 e dëshmitarit apo të dyshuarit. Çdo bashkëpunim i imi me të
16 gjithë këta akterë ndërkombëtarë ka qenë në interes të
17 drejtësisë dhe plotësisht transparent, qoftë në Prishtinë,
18 qoftë në Hagë. Gjithçka tjetër që thuhet është e
19 paqëndrueshme. Prandaj, askush nuk duhet dhe nuk mund ta
20 shkruajë historinë.

21 Ky është çmimi i lirisë. Unë besoj në paqe, të vërtetën,
22 pajtim dhe drejtësi. Dhe kam besim se ky proces do të jetë i
23 drejtë, transparent dhe i shpejtë.

24 Ju faleminderit shumë për vëmendjen.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

1 z. Thaçi.

2 Mendoj që përpara, më mirë se t'i japim fjalën z.

3 Emmerson që të fillojë me prezantimin e vet tani, do të ishte
4 mirë që të bëjmë pushimin e drekës. Z. Emmerson sa mendoni se
5 do të jeni, 45 minuta pak a shumë? Domethënë si mendoni,
6 mbrojtja e z. Selimi, do keni mundësinë që të bëni deklaratën
7 hapëse tuajën sot?

8 Z. YOUNG: [Përkthim] I nderuar z. Gjykatës, dua të them
9 që duhet t'i jap kolegut tim fjalën për të folur në emrin tim.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se
11 është e nevojshme, sigurisht që jam gati që të filloj sot,
12 megjithatë do të kem një orë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një orë?

14 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, do të jem një orë. Duke
15 përfshirë këtu edhe deklaratën e z. Selimi, domethënë do të
16 jetë 40-45 minuta fjala ime, ndërkohë që fjala e z. Selimi e
17 ka ndërhyrjen gati 10 minuta.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,
19 po juve? Do përdorni një orë?

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pak më pak ndoshta se sa një orë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

22 Do të bëjmë pushimin e drekës deri në orën 14.00. Do të
23 kthehemi përsëri këtu në orën 14.00, dhe do të fillojmë
24 menjëherë me z. Emmerson dhe do të vazhdojmë nga aty pastaj
25 edhe me ekipet e tjera. Seanca ndërpritet këtu.

1 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.25

2 --- Seanca rifillon në orën 14.00

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
4 dëgjojmë deklaratën hyrëse të Mbrojtjes së Z. Veseli.

5 Z. Emerson, keni fjalën.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Faleminderit.

7 Të nderuar Gjykatës, në komentet e mia të shkurtra dua të
8 flas për disa aspekte kyçe në të cilat në emër të z. Veseli do
9 t'ju kërkojmë të përqendrohemi dhe t'i mbani parasysh gjatë
10 shpalosjes së provave.

11 Pikë së pari, 25 vjet pas traumës, masakrave, dhe
12 trazirave të shkaktuara nga konflikti në Kosovë, dhe nga
13 fushata serbe e spastrimit etnik, Kosova vijon të jetë një
14 vend ku qëlon thashethemi, ku hamendja serviret si fakt, ku
15 qarkullojnë zëra dhe kundërzëra, pretendime dhe
16 kundërp pretendime, ku gjen mërinë, madje edhe gjakmarrjen.
17 Elementët e kësaj kulture kanë shekuj që ekzistojnë, por
18 vijojnë edhe sot e kësaj dite.

19 Nuk është për t'u habitur që lufta e vitit 1998 ka çuar
20 në një sasi të madhe të lindjes së miteve, gjatë këtyre 25
21 viteve të fundit. Pra siç doli, siç u përmend për shembull në
22 fjalën e z. Thaçi, miti i trafikimit të organeve është një
23 prej historive të shumta. Mbase përmes ndonjë amplifikimi,
24 elementi e të tjerë, diçka që ka hedhur rrënjë, por që s'është
25 e bazuar në fakte.

1 Historia e luftës, po kështu është shkruar e rishkruar,
2 nëpër kujtime, artikuj në gazeta, intervista, libra, shpesh e
3 shtrembëruar për t'u shërbyer interesave të protagonistëve të
4 ndryshëm. Por kjo histori ka qenë objekt edhe i një shqyrtimi
5 më të konsiderueshëm, më të kujdesshëm gjyqësor nëpër procese
6 gjyqësore, si brenda Kosovës nëpër gjykata të ngritura nga
7 EULEX-i dhe këtu sigurisht në Hagë, në TPNJ.

8 Dhe nuk është nevoja ta përmendim se jo të gjithë
9 personat e përfshirë në këto ngjarje janë historianë njësoj të
10 besueshëm. Disa njerëz e kanë ekzagjeruar rolin dhe rëndësinë
11 që kishin në UÇK. Shpesh për qëllime të aktualitetit politik
12 të ditës. Por të tjerë, janë përpjekur të distancohen nga
13 ngjarjet, ku në fakt kanë marrë pjesë. Sepse e dinë se disa
14 prej veprimeve të tyre ishin të themi së paku tejet të
15 dyshimta, dhe mund të bënin që ata të dilnin para një gjykate
16 penale.

17 Të gjitha këto ndërlikohen më tej akoma nga propaganda e
18 luftës që kanë bërë të gjitha palët gjatë vetë periudhës së
19 konfliktit. Dhe sigurisht, ngjarjet për të cilat ju do t'i
20 shihni, kanë ndodhur para thujse 25 vjetësh, dhe me keqbesim
21 apo jo kujtimet edhe mund të dobësohen ose të shtrembërohen
22 gjatë një periudhe kaq të gjatë kohe.

23 Të marrë së bashku, këta faktorë sigurisht se përbëjnë
24 një mjedis të vështirë për konstatimin e faktit në mënyrë të
25 besueshme. Nëse do të përdornim një aforizëm të njohur, e

1 vërteta është humbja e parë e luftës. Por në këtë kuadër ky
2 është një përshkrim që është sidomos i përshtatshëm për arsye
3 të cilat do të shpalosen nga provat.

4 Do të gjendeni pra përballë një panorame pështjelluese të
5 një periudhë kaotike të historisë së një vendi të vogël, mes
6 ngjarjeve që ia përmbysi jetën çdo familjeje të Kosovës.
7 Vështirësia kryesore sigurisht për çdo tribunal do të ishte në
8 këtë rast shoshitja e fakteve nga thashethemet, dhe ndarja e
9 provave të forta nga pretendimet e ricikluara që në mendjet e
10 disa njerëzve kanë marrë statusin e faktit të mirëqenë.

11 Në fjalën time do të respektoj urdhrin tuaj për të mos
12 përsëritur përmbajtjen e dosjes paraprake të Mbrojtjes së z.
13 Veseli. Ju tashmë e dini se Mbrojtja në themel e kundërshton
14 përshkrimin që Prokuroria i ka bërë UÇK-së si një organizatë
15 që, që prej fillimit të vet drejtohej nga lart-poshtë, apo që
16 udhëhiqej, administrohej, apo mikro-administrohej nga individë
17 që përgjithësisht quhen që kanë qenë anëtarë të Shtabit të
18 Përgjithshëm.

19 Dëshmitar pas dëshmitari në proceset e mëparshme në TPNJ
20 e kanë përshkruar strukturën e pushtetit brenda UÇK-së si një
21 strukturë që në thelb ishte horizontale dhe jo vertikale, ku
22 komandantët e zonave, madje edhe komandantët lokalë më në
23 bazë, ushtronin nivele shumë të larta autonomie dhe e
24 konsideronin veten se ishin në nivel operativ tërësisht të
25 pavarur nga njëri-tjetri, por edhe nga Shtabi i Përgjithshëm.

1 Prandaj edhe të përshkruash, siç ka konstatuar dhe vetë
2 TPNJ-ja, pra ta përshkruash këtë organ si një Shtab i
3 Përgjithshëm në kuptimin konvencional do të ishte diçka pra,
4 një përshkrim i shtrembëruar i fakteve.

5 Sigurisht, në një ushtri guerile, që u formua në mënyrë
6 të shpejtë në pranverën e vitit 1998 dhe që përbëhej thuajse
7 tërësisht nga civilë shqiptarë me armatime të pakta dhe të
8 pastërvitur, u bënë orvatje që UÇK-në ta paraqisnin kundrejt
9 botës së jashtme si një gjë më të organizuar, më të unifikuar,
10 dhe më efektive se ç' ishte në të vërtetë. Se propaganda është
11 përfshirë nga të gjitha palët, përfshirë këtu UÇK-në.

12 Materialet që keni në dispozicion përfshijnë jo vetëm
13 aktgjykimet me konstatimet për këtë gjë të çështjeve të
14 ndryshme gjyqësore të TPNJ-së që kishin të bënin me konfliktin
15 në Kosovë, por edhe tekstet e zbardhur të dëshmimeve që kanë
16 dhënë dëshmitarët e Mbrojtjes -- të Prokurorisë apo të
17 Mbrojtjes, por sidomos të Prokurorisë, në ato procese
18 gjyqësore.

19 Sa për t'ju dhënë një ide të realitetit për parashtrimin
20 që bën Prokuroria, që, që në fillim kjo ka qenë një organizatë
21 e drejtuar nga lart-poshtë.

22 Koloneli John Crosland ishte Atasheu Ushtarak britanik në
23 Ambasadën e Britanisë së Madhe në Beograd. E thirrën që të
24 jepte dëshmi si ekspert për Prokurorinë në gjyqin kundër
25 Haradinajt. Koloneli Crosland dëshmoi se gjatë pranverës së

1 vitit 1998 kur filloi ofensiva e rëndë serbe, UÇK-ja ishte jo
2 më shumë se 30 ose 40 anëtarë aktivë brenda Kosovës, që
3 përdornin siç e ka thënë ai me një shprehje, *shoot-and-scoot*
4 në anglisht, një taktikë e goditjes në lëvizje. Duke qenë se
5 ishte vetë në Kosovë asokohe, dhe duke qenë se kishte në duar
6 informata operative të nivelit më të lartë, ai përshkroi
7 pasojat e mëdha të sulmeve serbe kundër bazave të UÇK-së në
8 Prekaz dhe Gllogjan gjatë marsit 1998.

9 Ai përshkroi rritjen në numër të forcave serbe si në
10 formën e ushtrisë së rregullt serbe, por edhe në formacione të
11 parregullta paraushtarake të cilat vërshuan brenda në Kosovë
12 dhe ai përshkroi një valë masive frike e cila kaploi me
13 shpejtësi zonat rurale. Ndërkohë që forcat e mbrojtjes lokale
14 të cilat -- të fshatrave që ekzistonin me kohë para lufte, dhe
15 që vinin nga vetë jeta rurale shqiptare, u përpoqën të
16 organizoheshin në një farë gjëje që do të dukej si vijë
17 koherente mbrojtjeje kundër forcave mësymëse serbe dhe ajo që
18 -- ato kërkonin pra të mbroheshin ndaj një fushate spastrimi
19 si ajo që kishte ndodhur në Bosnjë, siç doli pra më pas që
20 ishte dhe gjenocid.

21 Një tjetër dëshmitar që i ka dhënë dëshmi TPNJ-së dhe i
22 cili do ta japë dëshmi edhe përpara jush, është Bislim Zyrapi.
23 Ai u bë Shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe ai është
24 dëshmitari mbi të cilin është mbështetur Prokuroria për të
25 paraqitur dëshmi dhe për të komentuar të shumë pra atyre që u

1 përshkruan dhe si dokumente rregullatorë të UÇK-së -- kodet që
2 përshkruanin sjelljen, disiplinën, të cilat Prokuroria jua
3 tregoi dhe.

4 Por siç me siguri e di edhe ZPS-ja, z. Zyrapit ka dëshmuar
5 disa herë për këto dokumente këtu në Hagë, ku ka dëshmuar se
6 këto rregulla në fakt ishin thjesht në nivel aspirate, nuk u
7 vunë ndonjëherë në jetë. Ishin projekt-dokumente të cilat nuk
8 kishin asnjë farë lidhjeje me realitetin në terren, siç është
9 shprehur edhe vetë dëshmitari i vetë Prokurorisë për këto
10 dokumente.

11 Sipas z. Zyrapit, këto rregulla u hartuan si pjesë e një
12 plani për ta profesionalizuar UÇK-në nga fundi i vitit 1998,
13 për ta konvertuar këtë nga një forcë kaotike guerile, e cila
14 ishte e shpartalluar nga ofensivat e pranverës dhe verës 1998,
15 në diçka që, pra, në një ushtri që të ishte e aftë për të
16 mbrojtur popullatën civile kundër asaj fushate të gjatë që
17 synonte të arrinte nivele të konsiderueshme të spastrimit
18 etnik.

19 Sigurisht, askush asokohe, në nëntor në fund të vitit
20 1998, mund të parashikonte nëse dhe kur forcat e NATO-s do të
21 arrinin pikën kur do të ishin të gatshme për të marrë vendimin
22 për të ndërhyrë kundër Serbisë, për të ndaluar edhe një
23 gjenocid tjetër si ai në Bosnjë.

24 Askush, domethënë me përjashtim të Kadri Veselit, sepse
25 roli i tij ishte që të ndërledhej drejtpërdrejt me personelin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata jo nën betim nga i akuzuari Selimi (Seancë e hapur) Faqe 101

1 e zbulimit, atë informativ, jo vetëm të Shqipërisë, por edhe
2 të disa shteteve anëtare të NATO-s të cilat sigurisht po e
3 mbanin nën vëzhgim me kujdes zhvillimin e situatës brenda në
4 Kosovë. Dhe për këtë qëllim një prej periudhave kyçe të
5 konfliktit ai e kaloi jashtë Kosovës, tërësisht jashtë
6 Kosovës, duke mbajtur lidhjet me shërbimet informative të
7 këtyre subjekteve shtetërore.

8 Ju e dini nga dosja paraprake e Veselit se kur shohim
9 rastin e z. Veseli periudha e aktakuzës apo periudha e
10 konfliktit të armatosur duhet të them, duhet ndarë në tri faza
11 të ndryshme që janë të dallueshme nga njëra-tjetra. E para
12 është nga pranvera 1998 deri në fund të vjeshtës, është
13 periudha kaotike gjatë së cilës u bënë përpjekje për të
14 ngritur një farë rrjeti strukturash në terren midis zonave dhe
15 grupeve të fshatrave, të cilat thuajse menjëherë u
16 shpartalluan nga një fushatë ushtarake tejet profesionale
17 serbe e cila synoi, vuri në shënjestër jo vetëm UÇK-në, por
18 edhe të gjithë popullatën civile. Ata rrethuan fshatrat, i
19 bombarduan këto, duke granatuar dhe kur u dha dhe korridor
20 largimi, u bënë edhe operacione fshesë, siç mund t'i quajmë,
21 duke hyrë nëpër fshatra, duke pushkatuar njerëzit, duke
22 plaçkitur duke i djegur ndonjëherë edhe me njerëz brenda. Pra
23 kjo është periudha e parë.

24 Asokohe, siç do ta dëgjoni, nuk kishte një funksion të
25 brendshëm zbulimi që të funksiononte në nivelin e Shtabit të

1 Përgjithshëm të UÇK-së, aspak. Kjo është gjatë periudhës së
2 ofensivës serbe që në fakt shkatërroi edhe organizatat lokale,
3 apo edhe xhepat e izoluar të këtyre organizimeve lokale në
4 terren.

5 Periudha e dytë ishte midis fundit të vjeshtës 1998 dhe
6 pranverës 1999. Në pjesën e dytë të nëntorit 1998 pati një
7 farë organizimi duke u caktuar dhe role personave të ndryshëm
8 si anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm dhe z. Veseli u emërua
9 si Shef Zbulimi. Një prej pyetjeve kryesore për të cilën duhet
10 të vendosë ky Trup Gjykues është se ç' do të thoshte ky emërim
11 në praktikë.

12 Më së miri mund të kuptohet se çfarë ishte ky rol duke
13 parë se çfarë ndodhi. Sapo, pothuajse sapo, z. Veseli u emërua
14 Shef Zbulimi, ai u largua nga Kosova për të kryer rolin e tij
15 si Shef Zbulimi, dhe u vendos jashtë vendit duke u vendosur në
16 lidhje, duke mbajtur lidhjet me organizatat ndërkombëtare dhe
17 agjencitë e tjera derisa thuhet pak përpara momentit kur
18 NATO-ja mori vendimin për të filluar fushatën e bombardimeve.

19 Funkzioni i tij pra, është i dukshëm si në periudhën
20 kohore -- pra në momentin kur ka ndodhur dhe nga lëvizjet.

21 Siç ka shpjeguar më parë në dosjen e tij paraprake,
22 funksioni i zbulimit që ai kryente ishte i fokusuar në lidhjet
23 e mbajtura me aparatit informativ të Shqipërisë, jashtë vendit
24 pra, dhe të disa shteteve anëtare të caktuara të NATO-s. Në
25 pritje të asaj që pritej të vinte. Funkzioni i tij nuk kishte

1 të bënte fare me zbulimin e brendshëm apo me gjetjen e
2 kolaboracionistëve. Siç e thashë, fokusi i tij ishte thujse
3 tërësisht në mbajtjen e lidhjeve me organizatat e huaja
4 informative dhe prandaj ai ishte i vendosur jashtë Kosovës për
5 një periudhë thujse 6-mujore, që nga emërimi i tij si Shef
6 Zbulimi në Shtabin e Përgjithshëm deri në fillim e fushatës së
7 bombardimit të NATO-s që filloi në mars 1999.

8 Pra, ai nuk ishte i vendosur, siç nënkuptoi Prokuroria,
9 në malet e Berishës gjatë kësaj periudhe kritike. Ai ishte i
10 fokusuar dhe i vendosur jashtë Kosovës për të dhënë këtë
11 kontribut jetik dhe të rëndësishëm për luftën.

12 Prokuroria dje ju foli për mijëra njerëz të cilët i ka
13 intervistuar në të gjitha nivelet e UÇK-së, nga luftëtarët e
14 thjeshtë, tek komandantët e zonave, madje edhe tek ish-
15 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm. Ju folën për gjerësinë dhe
16 gjatësinë e imtësinë e intervistave brenda vetë UÇK-së, si
17 edhe me persona ndër të tjera jashtë UÇK-së. Dhe pra, asnjë
18 person i vetëm nga të cilët ata propozojnë të thërrasin këtu,
19 nuk e kanë parë ndonjëherë Kadri Veselin të bënte diçka qoftë
20 edhe pakëz të papërshtatshme.

21 Deri javën që shkoi ishte një dëshmitar në listën e
22 dëshmitarëve të Prokurorisë, edhe pse kishte vdekur dhe provat
23 ishin në letër. Pra ishte një dëshmitar i Prokurorisë, i cili
24 kishte pretenduar se e kishte parë z. Veseli një herë në
25 Kukës, ku kishte marrë në intervistë një të ndaluar. Rast i

1 cili, si të thuash, do ta afronte me pretendimet që paraqet
2 Prokuroria.

3 Por, ishte e dukshme që në fillim, dhe pasi panë
4 deklaratat dhe dëshmitë më të fundit të dëshmitarit, se ky
5 dëshmitar ishte gabuar tërësisht sa i takon identifikimit të
6 z. Veseli, dhe në fakt, kështu ishte shprehur dhe ai vetë.
7 Arsyet e kësaj përshkruhen në dosjen paraprake tonën në
8 paragrafin 53(e).

9 Javën që shkoi në prag të nisjes së këtij gjyqi,
10 Prokuroria i dha njoftim Mbrojtjes se tani e pranon se ky
11 dëshmitar vërtet e kishte pasur gabim sa i takon identifikimit
12 të z. Veseli dhe se Prokuroria rrjedhimisht nuk propozon që të
13 paraqesë prova në mbështetje të pretendimeve në lidhje me këtë
14 rast, të cilat ata i kanë parashtruar në paragrafët 49 dhe 120
15 të aktakuzës. Pra nuk u qëndrojnë më këtyre pretendimeve.

16 Qëndrimi i Prokurorisë është se është e panevojshme nga
17 ana formale që ta ndryshojnë aktakuzën për të reflektuar këtë.
18 Sigurisht, këtë e gjykojnë ata, por ata nuk propozojnë që të
19 paraqesin prova në mbështetje të kësaj. Në fakt, nuk është --
20 është thjesht një rast, një incident poshtë në varësi të një
21 pike. Nuk është se ndryshon të gjithë pikën. Por mirë do të
22 ishte, të nderuar Gjykatës, pra ta dimë këtë gjë.

23 Mirëpo, të nderuar Gjykatës, mund së paku, mendërisht
24 mund t'u heqin vizë këtyre paragrafëve, pra 49 dhe 120 të
25 aktakuzës sepse Prokuroria në mënyrë të qartë ka konfirmuar se

1 nuk do të paraqesin prova në mbështetje të këtij pretendimi.

2 Ishte thjesht gabim nga ana e tyre.

3 Por, me eliminimin e këtyre provave, me eliminimin e
4 këtij pretendimi, nuk ekziston edhe një i vetëm mes mijëra
5 dëshmitarëve të intervistuar nga Prokuroria të cilët do të
6 pretendonin se e kanë parë Kadri Veselin të bëjë ndonjë gjë,
7 qoftë edhe paksa të papërshtatshme në këtë çështje gjyqësore.
8 Nuk ka asnjë dëshmitar që të pretendojë se e ka parë të
9 pranishëm në çfarëdolloj momenti kur pretendohet se mund të
10 jetë bërë çfarëdolloj krimi. Nuk ka asnjë provë që ai të ketë
11 autorizuar apo të ketë nxitur ndonjëherë ndonjë krim apo
12 ndonjë politikë kriminale, që ai të ketë marrë ndonjëherë, në
13 cilësinë si Shef i Zbulimit, ndonjë raportim të ndonjë krimi
14 të kryer, apo që ai të ketë luajtur ndonjëherë, çfarëdolloj
15 roli në ngjarjet që kanë çuar në kryerjen e ndonjë krimi. Pra
16 nuk ka asnjë provë për këto pika fare.

17 Ashtu sikurse nuk ka asnjë provë që ai të mos ketë marrë
18 hapa brenda objektit të mandatit që i është dhënë atij, për të
19 parandaluar ndonjë krim, apo për të ndëshkuar personat e
20 përgjegjshëm. Të gjitha këto mungojnë.

21 Kjo vlen edhe për provat shkresore mbi të cilat
22 mbështetet Prokuroria. Nuk ka asnjë provë shkresore provuese
23 që edhe të kishte lidhje me z. Veseli me një përjashtim të
24 cilin do ta përmend pas pak. Por nuk ka asnjë dokument të
25 vetëm për të gjitha provat që propozohen, pavarësisht nga

1 mijëra dëshmitarë që kanë intervistuar dhe pse kanë pasur një
2 mori dokumentesh në dispozicion që nga TPNJ-ja, nga gjykimet e
3 mëparshme apo nga proceset e tjera. Pra, nuk ka një dokument
4 të vetëm në të gjithë provat e tyre që të mbajë, që të ketë
5 pra, nënshkrimin e tij.

6 Nuk ka asnjë provë që ai të ketë dhënë ndonjëherë ndonjë
7 urdhër me shkrim, apo goftë edhe me gojë, dhe nuk ka asnjë
8 provë që ai të ketë marrë ndonjë raport me shkrim apo me gojë,
9 nga ndokush, goftë kjo në lidhje me kolaboracionistë, me
10 informata të brendshme, apo ndonjë gjë tjetër. Në shtëpinë e
11 tij nuk është sekuestruar asnjë dokument. Pra, në kuptimin e
12 plotë të fjalës, do të thosha, nuk ka asnjë provë shkresore
13 lidhur me rolin e tij.

14 I vetmi përjashtim që unë e përmenda, është një mbledhje
15 më datë 21 tetor 1998, në Tiranë. Është dokumenti ERN 061168.
16 Do ta shihni një -- është përmendur kjo një herë në deklaratën
17 hyrëse të Prokurorisë, dhe një herë në deklaratën hyrëse të z.
18 Kehoe. Pra ka të bëjë me një takim në Tiranë, që ka të bëjë --
19 kishte të bënte me integrimin e forcave të FARK-ut, pra, që
20 është grupi ushtarak i lidhur me Qeverinë e Bukoshit dhe me
21 LDK-në. Pra, një marrëveshje që ato forca të bashkoheshin me
22 UÇK-në në një forcë të vetme luftuese në Kosovë.

23 Pra, dhe kjo nuk është provë e një politike persekutuese,
24 përndjekëse. Është provë e një marrëveshjeje të arritur me
25 Qeverinë e Bukoshit që ishte në ekzil asokohe, në mërgim. Dhe

1 këtua është i vetmi dokument ku është një nënshkrim i z.

2 Veseli, dhe kjo është e rëndësishme pra, që është një

3 dokument, sepse është i nënshkruar jashtë Kosovës. Është

4 nënshkruar në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë.

5 Jo vetëm që nuk e mbështet idenë se z. Veseli ka qenë
6 pjesë e një konspiracioni për të përndjekur mbështetësit, ky
7 dokument në fakt dëshmon për përfshirjen e FARK-ut në UÇK si
8 forcë unike luftimi. Pra një prej të metave në thelbin e
9 provave që ka Prokuroria është nocioni që e mendon një numër
10 relativisht i vogël individësh, është nocioni që udhëheqja e
11 UÇK-së kanë komplotuar së bashku për të vënë në shënjestër
12 mbështetësit e LDK-së për t'i përndjekur. Por siç do ta
13 dëgjoni, ky është një mendim krejt i ndryshëm nga ajo që ka
14 ndodhur në terren, ku shumica e mbështetësve të UÇK-së ishin
15 në fakt anëtarë të LDK-së, pra nuk ishin dy grupe më vete,
16 ishin të ndërthurur. Tani, konflikte ka pasur, dallime në
17 mendime ka pasur, si në çdo forcë, si çdo rast kur bashkohen
18 dy forca politike. Por asnjëherë s'ka pasur një politikë
19 përndjekjeje kundër LDK-së, siç e tregon edhe fakti që shumica
20 e anëtarëve të UÇK-së ishin mbështetës të LDK-së.

21 Pra, nga mes orëve -- mes mijëra orëve që Prokuroria ka
22 intervistuar dëshmitarët e çdo niveli brenda Kosovës, nuk ka
23 hasur në asnjë dëshmitar apo në një dokument të vetëm në të
24 cilin të mund të mbështeten se z. Veseli të ketë luajtur
25 ndonjë rol në promovimin e një ndërmarrjeje kriminale të

1 përbashkët, që ata e pretendojnë se ka ekzistuar. Megjithatë,
2 Prokuroria kërkon që ta mbajë tërthorazi përgjegjësinë z. Veseli
3 për sjelljen kriminale të individëve në terren, të cilët kanë
4 kryer krime, për të cilat ai nuk kishte dijeni, dhe me të
5 cilat nuk kishte të bënte fare.

6 Më kot do të prisni të shihni prova të cilat do ta
7 implikonin z. Veseli gjatë këtij gjykimi, apo që tregojnë se
8 ai ka qenë palë e një politike kriminale të përbashkët, apo se
9 ka bërë ndonjë gjë për të çuar përpara qëllimet e ndërmarrjes
10 kriminale të përbashkët të pretenduar, apo se ka pasur ndonjë
11 kontroll efektiv mbi komandantët e zonave, komandantët lokalë
12 apo luftëtarët në terren.

13 Gjatë përgatitjes së çështjes kundër z. Veseli,
14 Prokuroria ka bërë një gabim elementar që do të thotë se ka
15 hamendësuar se thjesht fakti që ai u emërua si Shef i
16 Zbulimit, nga fundi i nëntorit 1998, mund të barazohet, është
17 i barasvlershëm me një rol udhëheqës në një rrjet të unifikuar
18 të brendshëm zbulimi që synonte të evidentonte apo të zbulonte
19 kolaboracionistët. As nuk e pyetën këtë, as nuk e kanë tentuar
20 ta vërtetojnë për çfarë funksioni zbulimi po flasim. Çfarë po
21 bënte ai, kur ishte jashtë Kosovës, që qartë ndërlydhte, bënte
22 komunikimin me shërbimet e zbulimit të shteteve të tjera.

23 Në dosjen e vet paraprake, z. Veseli e ka shprehur qartë
24 pse ky ekuacion i pabazë nuk mund të merret si arsye për të
25 dalë në përfundime të tilla, sa i takon rolit konkret që ka

1 pasur z. Veseli.

2 Kur iku nga Kosova, nuk kishte për t'u larguar nga
3 konflikti, por për të çuar më tej interesat e konfliktit por
4 në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Identifikimi,
5 ndalimi dhe keqtrajtimi i kolaboracionistëve brenda Kosovës
6 nuk ishte pjesë e funksionit të tij në asnjë moment.

7 Siç theksuan dje z. Whiting dhe znj. Lawson në deklaratat
8 hyrëse, Prokuroria po e paraqet këtë çështje dhe Prokuroria
9 duhet të vërtetojë pretendimet e veta përtej dyshimit të
10 arsyeshëm. Në çështjen e z. Veseli kjo kërkon që ata, përtej
11 dyshimit të arsyeshëm, të gjejnë argumente, të kundërshtojnë
12 argumentet mbrojtës që ai ka në dosjen e vet paraprake. Këtë
13 duhet të bëjnë ata.

14 Ai thotë që ai merrej apostafat me funksion të jashtëm,
15 sa i takon zbulimit dhe prandaj u largua nga Kosova sapo ia
16 dhanë këtë rol. Përndryshe, pse do ta kishte bërë të gjithë
17 këtë? Nëse Prokuroria nuk e kundërshton dot këtë, dhe nuk kanë
18 asgjë në prova që t'i afrohet kësaj, atëherë z. Veseli
19 sigurisht duhet të shfajësohet, kjo duhet të ndodhë.

20 Të thuash thjesht për faktin se kishte një rol si Shefi i
21 Zbulimit, sigurisht që kjo nuk është e mjaftueshme. Ata duhet
22 të vërtetojnë sipas standardeve në fuqi saktësisht çfarë
23 nënkuptonte ky rol dhe saktësisht pse mendojnë ata se kanë
24 prova t'ju thonë ju që marrja e një titulli të tillë,
25 nënkupton që ai në fakt ka qenë i përfshirë në një program

1 brenda vendit, program brenda vendit që synonte të kalonte
2 përmes komandantëve të zonave, deri në nivel individ, që
3 merreshin në një zonë lokale në Kosovë, sepse për çfarëdo
4 arsye, ky person që zgjidhej, besohej se ishte
5 kolaboracionist.

6 Sigurisht, do të zbulohet, do të shpaloset ç'po ndodhte
7 në Kosovë asokohe e çfarë nuk ndodhte. Por kjo ide është po aq
8 qesharake sa edhe akuza për trafikim organesh. Roli i Shtabit
9 të Përgjithshëm nuk ishte roli i një Shtabi i Përgjithshëm në
10 mënyrën konvencionale, është qesharake të pretendosh që kishin
11 një rol të atillë. Edhe, sigurisht, Prokuroria do ta dëgjojë
12 sepse është shprehur edhe më përpara kjo. Të kalosh nga kjo në
13 një pretendim të kësaj natyre, sipas mendimit tonë është --
14 nuk është logjike dhe duhet të jetë e papranueshme.

15 Por, përveç kësaj, përveç këtij hamendësimi kaq të
16 thjeshtë nuk ka asgjë tjetër Prokuroria, thjesht kanë këtë
17 supozim për shkak të rolit që ka pasur. Dhe në një hamendeshim
18 kaq i thjeshtë apo ekuacion i gabuar që gjeneron të gjitha
19 këto akuza që kaq shpesh janë pjesë e analizës së konfliktit
20 në Kosovë.

21 Mund të pyesë dikush, po ku janë provat konkrete që z.
22 Veseli ka qenë i përfshirë në një ndërmarrje kriminale të
23 përbashkët për të keqtrajtuar kolaboracionistët? Ku janë
24 provat të rolit të tij konkret?

25 Tani sigurisht dikush duhet të komunikonte me shërbimet e

1 zbulimit në Shqipëri dhe shtetet anëtare në NATO dhe duhet ta
2 bënte këtë jashtë Kosovës. Nëse Prokuroria thotë që nuk ishte
3 z. Veseli, pra ai nuk ishte presoni që bënte ndërlidhjen,
4 atëherë kush ishte sipas Prokurorisë? Kush po e kryente këtë
5 funksion? Kush po komunikonte me shërbimet e zbulimit në këto
6 shtete apo shërbimet informative?

7 Në qoftë se ishte z. Veseli, atëherë si mund të lidhet ky
8 rol me një konspiraci të pretenduar se ai keqtrajtonte
9 kolaboracionistët brenda Kosovës? Mbase Veseli duke qenë se
10 ishte në Shqipëri, pjesën më të madhe të kohës, ishte një
11 vizitor i shpeshtë, shkonte shpesh pra në dy vendet e ndalimit
12 që ka identifikuar Prokuroria në territorin shqiptar. Por nuk
13 ka asgjë për këtë. Asgjë në prova që të tregojë se ai ka qenë
14 i përfshirë në çfarëdolloj forme në identifikimin apo ndalimin
15 e kolaboracionistëve të pretenduar.

16 Po për komunikatat? As këto, qartazi, s'kishin asnjë
17 lidhje me z. Veseli. As nuk i shkroi ndonjëherë, s'ka asnjë
18 element që tregon se ai ka miratuar paraprakisht, asgjë nuk
19 është gjetur në zotërimin e tij, por dhe më e rëndësishme, të
20 gjitha këto s'janë prova të reja, këto janë shqyrtuar
21 tërësisht edhe nga TPNJ-ja në disa raste. Dhe sipas z.
22 Misetic, TPNJ-ja në mënyrë të vazhdueshme i ka portretizuar si
23 propagandë lufte dhe nuk shërbejnë si fakte, nuk mund të
24 shërbejnë si fakte. Sidomos kur flitet për reprezalje ndaj
25 kolaboracionistëve u referoheshin një strategjie ushtarake

1 kundër atyre që perceptoheshin se ishin, apo konspiroheshin si
2 një kërcënim ushtarak.

3 Sigurisht që ju doni t'i shqyrtoni me kujdes ato që u
4 lëshuan gjatë periudhës së aktakuzës. Jo të vitit 2004, 2005,
5 por ato që janë lëshuar gjatë periudhës që lidhet me
6 aktakuzën. Dhe kur ta bëni këtë, do ju lutesha të keni
7 parasysh që asgjë, asnjë element, nuk e lidh z. Veseli apo
8 rolin që luante ai, pra teksa kryente funksionin e zbulimit
9 jashtë Shqipërisë, asgjë pra nuk e lidh me këto dokumente.

10 Më në përgjithësi, gjatë fjalës hyrëse të Prokurorisë,
11 mund të keni vënë re referenca relativisht të kufizuara që iu
12 bënë provave, sa i takon asaj që, thotë Prokuroria, ishte roli
13 konkret i z. Veseli. Jam i sigurt që ju do ta lexoni edhe një
14 herë transkriptin e ditës së parë, por referenca për rolin e
15 z. Veseli konsistonte për pjesën më të madhe mbështetur në
16 hipoteza që nuk mbështeteshin as me citime, apo të provave që
17 ata përdorin në mbështetje të argumenteve të tyre. Ata nxorën
18 një dokument me shkrim dore, që pretendohet se është gjetur në
19 banesën e z. Krasniqi më duket dhe u prezantua në diapozitivin
20 B31. Dhe më duket se referenca është SPOE00227535. Edhe u
21 shfaq në ekran nga z. Halling, ishte një dorëshkrim. Dhe ishte
22 një pjesëz aty që ua tregoi z. Halling që pretendonte se
23 përshkruante funksionin e zbulimit në UÇK. Nuk përmendet z.
24 Veseli aty, por thotë vetëm çfarë duhet të përmbante funksioni
25 i zbulimit të UÇK-së.

1 Është një faqe e vetme që është marrë për provë materiale
2 nga një dorëshkrim, nga një bllok. Por prejardhja është
3 tërësisht e panjohur. Nuk ka prova që tregojnë që e ka shkruar
4 z. Krasniqi apo kush e ka shkruar. Askush nuk e di kush e ka
5 shkruar e kur është shkruar, a ku është shkruar, e për
6 ç'qëllim është shkruar. Është tërësisht -- nuk ka asnjë vlerë
7 ky material. Në kuptimin e vërtetë të fjalës, nuk mund të jetë
8 provë. Po, kishte një pozicion shumë të lartë dhe këtë e thotë
9 Prokuroria, e shfaqti në ekran z. Halling, edhe citoi sigurisht
10 në atë pasazh.

11 Thjesht fakti që ky dokument që nuk ia dimë prejardhjen,
12 një copë letër që mund ta kenë marrë edhe në rrugët e Hagës,
13 që Prokuroria e nxori dhe e shfaqti për të përshkruar çështjen
14 që kishin kundër z. Veseli në raport me rolin që luante si
15 zbulim, është një dëshmi -- do të thotë që në fakt nuk kishin
16 -- kjo tregon që nuk kanë asnjë provë konkrete për të
17 implikuar z. Veseli në asnjë sjellje apo veprim lidhur me
18 zbatimin e kësaj ndërmarrjeje kriminale të përbashkët.

19 Ky shënim, i zhargavitur nga një shkrimtar i panjohur,
20 Zoti e di nga vjen apo pse, as nuk e përmend emrin e z.
21 Veseli.

22 Prova tjetër që përmend Prokuroria në fjalën hyrëse, nëse
23 dhe mund ta quajmë provë, është që z. Veseli, thonë ata, mori
24 *nom de guerre*, emrin e luftës, Luli në enklavën e UÇK-së në
25 Jabllanicës. Folën për këtë, dëgjuam goxha për Jabllanicën,

1 për atë haurin ku mbaheshin njerëzit e ndaluar, në periudha të
2 ndryshme kohore. Dhe u tha se në një moment z. Veseli, *nom de*
3 *guerre*, emri i tij u shpik në Jabllanicës, emri i tij i
4 luftës.

5 Jabllanica është një fshat i vogël brenda zonës së
6 Dukagjinit, i izoluar, në pjesën perëndimore të Kosovës, që
7 është shqyrtuar gjerësisht edhe në çështjen Haradinaj. Është
8 një vend ku dihet që një numër individësh janë mbajtur të
9 ndaluar dhe janë keqtrajtuar rëndë dhe ka gjasë që më shumë se
10 një person të ketë humbur jetën.

11 Ajo që Prokuroria nuk bën dhe nuk mund të bëjë është që
12 të pretendojë se z. Veseli ka qenë në ndonjë moment i
13 përfshirë në këtë vendngjarje apo edhe që ka pasur dijeni
14 lidhur me ndalimin e ndonjë personi në Jabllanicë në çdo
15 moment kohor, apo që të ketë qenë fizikisht i pranishëm në
16 fshat në momente kur ka pasur persona të ndaluar atje.

17 Siç tha z. Misetic, në këtë rast duhet parë -- na tregon
18 shumë në fakt për teoritë që ka Prokuroria. Veçanërisht teoria
19 për ndërmarrjen kriminale të përbashkët, dhe komandën dhe
20 kontrollin. Dhe sugjerojmë dhe themi që Jabllanica është shumë
21 e rëndësishme që ta keni parasysh të nderuar Gjykatës.

22 Komandanti i Jabllanicës ishte një person që quhej Lahi
23 Brahimi. Z. Brahimi është dënuar nga TPNJ-ja në çështjen
24 Haradinaj dhe është dënuar me burgim për krimet e
25 keqtrajtimit, dhunë, torturë e kështu me radhë, që ai dhe

1 vartësit e tij të drejtpërdrejtë në Jabllanicë kishin kryer
2 kundër disa personave që ishin burgosur atje.

3 Kushëriri i z. Brahimaj ishte Ramush Haradinaj dhe Ramush
4 Haradinaj ishte komandanti i zonës së Dukagjinit asokohe. E
5 për rrjedhojë ishte dhe oficeri përgjegjës dhe ishte
6 përgjegjës për Lahi Brahimaj dhe enklavën e Jabllanicës. E
7 vizitonte herë pas here Jabllanicën. Dhe Lahi Brahimaj ishte
8 nën vartësinë e tij, ishte vartës i tij. Sidoqoftë, u bënë --
9 dy dhoma gjykimi të suksesshme të TPNJ-së, dy trupa gjykues të
10 TPNJ-së konstatuan se z. Haradinaj nuk ishte pjesë e një
11 ndërmarrjeje kriminale të përbashkët me Lahi Brahimaj, që të
12 ndalonte dhe të keqtrajtonte të burgosurit që janë keqtrajtuar
13 në Jabllanicë nga z. Brahimaj dhe burrat e tij.

14 Sidoqoftë, siç tha dhe z. Misetiç, Prokuroria mbështetet
15 në të njëjta akte keqpërdorimi nga z. Brahimaj dhe burrat e
16 tij pa i marrë parasysh konstatimet e TPNJ-së, Prokuroria tani
17 pretendon se për shkak të faktit që z. Veseli ka qenë anëtar i
18 Shtabit të Përgjithshëm ai duhet të jetë përgjegjës për krimet
19 tërthorazi, për krimet që ka kryer z. Brahimaj. Megjithatë,
20 aktgjykimi Haradinaj, dhe flasim për gjykimin e dytë, ishte që
21 ndërmarrja kriminale për keqtrajtimin e të burgosurve në
22 Jabllanicë ishte vetëm për ata anëtarë të UÇK-së që ishin në
23 vartësinë e drejtpërdrejtë të z. Brahimaj. Pra ishte NKP-ja e
24 Jabllanicës.

25 Nuk ishte një ndërmarrje kriminale që shtrihej për të

1 gjithë komandantët e zonave. Tani pikëpyetja është: a mund të
2 shtrihet kjo edhe për z. Veseli thjesht sepse ai ishte anëtar
3 i Shtabit të Përgjithshëm? Pa pasur asnjë provë, asgjë të
4 ngjashme. Pikërisht këto janë pyetjet që ju të nderuar
5 Gjykatës duhet të drejtoni kur të vlerësoni secilin prej
6 vendeve të krimeve të paraqitura në aktakuzë. Si i ka lidhur
7 Prokuroria këto me individët në dokument?

8 Si mund ta anashkalojnë pra komandantin e zonës dhe themi
9 që kemi një organizatë me komandën nga lart-poshtë, por ja ku
10 jemi këtu.

11 Ju do t'i shihni të gjitha këto, këtë analizë abstrakte
12 që do t'i paraqesë Prokuroria.

13 Më falni, jam duke e përfunduar.

14 Në deklaratën përmbyllëse dje, znj. Lawson tha se
15 Prokuroria nuk po mbështetej vetëm në praktikat e ndalimit dhe
16 rrethanat e keqtrajtimit për të vërtetuar çështjen e vet. Por
17 të paktën, sa i takon z. Veseli, është e vështirë që ta
18 vërtetojnë këtë, sepse nuk kanë asnjë provë të pavarur, që të
19 tregojë se ai është fajtori që ta përdorin si bazë.

20 Kjo do të thotë se do të jetë me rëndësi jetike për ju të
21 nderuar Gjykatës, të shqyrtoni këtë praktikë të pretenduar në
22 kontekstin numerik, krahasimor, kohor dhe gjeografik. Shifrat
23 -- sa veta janë ndaluar e sa janë keqtrajtuar, sidomos gjatë
24 intensifikimit të luftimeve, shpërndarja e këtyre incidenteve
25 gjatë një periudhe 15 mujore që zgjati konflikti dhe më pas,

1 edhe pasi kishte përfunduar konflikti, dhe në vende të
2 ndryshme në Kosovë, si edhe, siç u tha në rastin Limaj,
3 motivet e mundshme që mund të kishin ekzistuar për ata në
4 terren që i kryen këto krime, dhe asnjë prej tyre nuk do të
5 japë prova për ju.

6 Të gjitha këto ndryshore, që janë masive, duhen vlerësuar
7 me kujdes, dhe duhen shqyrtuar. Më duket se z. Kehoe e tha
8 edhe dje që në fakt prokuroria duhet të ndjekë një qasje sa më
9 të thjeshtë. Ata duhet ta vërtetojnë këtë çështje.

10 Ata e mbështesin çështjen mbi propozimet, ju i keni parë
11 dokumentet. Ata i mblodhën të gjitha në një diapozitiv,
12 vendosën një pikë -- sa i takon ku ishin selitë apo zyrat e
13 Shtabit të Përgjithshëm, por që të bëjnë një çështje të mirë
14 që të kemi një çështje të mirë, ata duhet të mbështeten mbi
15 faktin se krimet ose ishin shumë të shpeshta ose ishin të
16 shumta, ose kishin karakteristika, ngjashmëri, motive, të
17 identifikimit e kështu me radhë. Dhe vetëm mund të kishin qenë
18 rezultat i një politike të adoptuar nga Shtabi i Përgjithshëm.

19 S'keni për ta gjetur gjëkund këto strategji, këtë
20 politikë. Asnjë vend s'keni për ta gjetur se nuk ka ekzistuar.
21 Nuk dëgjoni asnjë provë, sepse ne e dimë nga Prokuroria. Nuk
22 keni për të gjetur asnjë dokument që të tregojë se ka
23 ekzistuar një politikë e tillë. Kur flasim, kam prova kundër
24 çdo individi në dokument, në qoftë se nuk kam prova për çdo
25 individ në dokument, kjo është sepse në fakt ata nuk kanë.

1 Kemi dy vjet persona që kanë ndenjtur në paraburgim, do
2 kemi të paktën edhe dy vjet gjykim bazuar në një çështje që
3 nuk ka prova. Është e pabazë. Prandaj do t'ju lutesha të
4 shihnit me kujdes çështjen e këtyre praktikave, dhe
5 influencave dhe urojmë që të jepet rëndësia e nevojshme
6 sigurisht që duhet ta shihni me kujdes. Dhe kur të vërtetohen,
7 kur të vërtetohen do të keni të paktën një bazë solide faktesh
8 ku të mbështesni konstatimet tuaja në këtë rast konkret.

9 Por, përmasa e vërtetë e këtyre krimeve, të cilat i ka
10 fryrë Prokuroria, madje edhe këto shifra, numra, s'e dimë si
11 kanë dalë në këto përfundime, sepse kanë edhe përfshirë edhe
12 persona për të cilët ka pasur konstatime të kundërta, por ja
13 kështu është bazuar kjo çështje. Por përmasa e vërtetë e
14 këtyre krimeve, dhe ajo që përmbush standardin kriminal të
15 provës është pikërisht detyrë e Trupit Gjykses, pasi t'i ketë
16 parë dhe dëgjuar të gjitha provat.

17 Por, siç thamë në fillim, Prokuroria nuk ka nxjerrë asnjë
18 provë, asgjë të ngjashme që lidh z. Veseli me këtë praktikë
19 krimesh, apo me ndërmarrjen e pretenduar kriminale përtej
20 faktit se ai u emërua në fund të nëntorit, para se të largohej
21 në Kosovë për të bërë punën si oficer ndërlidhës i zbulimit,
22 ai u emërua Shefi i Zbulimit. Dhe u kthye para se NATO-ja të
23 shtypte butonin.

24 Fakti se ai kishte rolin dhe quhej Shefi i Zbulimit, nuk
25 mund të konsiderohet provë, të nderuar Gjykatës.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
2 z. Emmerson.

3 Tani do të dëgjojnë, Mbrojtjen e Selimit.

4 Z. Roberts, fjala është për ju. Keni një orë.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Sikurse përmenda para pushimit z.
6 Selimi do të flasë përpara për 15 minuta, dhe pastaj do ta
7 marr unë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, ju doni
9 që të fillojë z. Selimi?

10 Z. ROBERTS: [Nuk ka përkthim]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Selimi,
12 keni të drejtën të bëni një deklaratë jo nën betim, mund ta
13 bëni tani. Dhe ju lutem, ju thatë 15 minuta?

14 I AKUZUARI SELIMI: Ndoshta më pak.

15 Z. ROBERTS: [Përkthim] Mbase më pak, por rreth 15 minuta.

16 I AKUZUARI SELIMI: I nderuar Kryetar dhe Anëtarë të
17 Trupit Gjykes, të nderuar të pranishëm këtu në sallë dhe në
18 galeri. Ka pothuajse 2 vite e gjysmë qëkur u njoftova që ndaj
19 meje është ngritur një aktakuzë nga Dhomat e Specializuara të
20 Kosovës. Natyrisht nuk e prisja. Sido që rrodhën ngjarjet,
21 tash jemi përballë një aktakuze që me të drejtë vazhdojmë ta
22 konsiderojmë të pabazuar mbi fakte e argumente.

23 Prandaj, përballë kësaj aktakuze sërish deklarohe se nuk
24 kam të bëj asgjë me krimet e pretenduara në këtë aktakuzë.

25 Në fillim të viteve '90 isha student në Universitetin e

1 Prishtinës në Fakultetin Filologjik në degën Letërsi e Gjuhë
2 Shqipe. Si kudo në Kosovë, edhe në Universitetin e Prishtinës
3 u përshkallëzua dhuna. Më kujtohet kur na dëbuan nga
4 konviktet, unë isha në konviktin numër 2 ku më 16 mars 1990
5 rreth Qendrës së Studentëve shihje autoblanda me policë të
6 armatosur duke nxjerrë studentët shqiptarë jashtë. Nuk mund të
7 hyje në objektet e Universitetit, më nuk mund të hynim në
8 fakultete e as në bibliotekë.

9 Shqiptarët u larguan nga puna, nuk kishte më policë
10 shqiptarë, nuk kishte më as mjekë shqiptarë, as postierë
11 shqiptarë, as nëpunës në administratë. Të rinjtë shqiptarë nuk
12 mund të luanin as futboll në stadiumet e palestrat sportive, u
13 mbyll televizioni i vetëm në gjuhën shqipe si dhe u mbyllën
14 gazetat e botuara deri atëherë. Dhuna ndaj shqiptarëve
15 përshkallëzohej, të rinjtë dërgoheshin me dhunë në ushtrinë
16 jugosllave, jo për të shërbyer në ushtri, por për të na vrarë
17 ashtu siç i vranë shumë të rinj që i dërgonin në ushtri e
18 pastaj i kthenin në arkivole të mbyllura.

19 Si sot më kujtohet kur bashkëmoshatarin tim, Jetullah
20 Desku, e dërguan me forcë në shërbimin ushtarak dhe pas pak
21 kohe e kthyen në arkivol, duke i thënë familjes së tij se e
22 kishte vrarë veten.

23 Po i nderuar z. Kryetar.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Selimi, z.
25 Selimi, ngadalësoni pak për përkthimin.

1 I AKUZUARI SELIMI: Patjetër.

2 Unë siç thashë më lart, isha në moshën e adoleshencës kur
3 vijoja mësimet në shkollën e mesme "Luigj Gurakuqi" në Klinë.
4 Për dijeninë tuaj Luigj Gurakuqi ishte një patriot, shkrimtar
5 shqiptar i fundshekullit XIX dhe fillim shekullit XX e Serbia
6 dhunshëm ia ndërroi emrin e shkollës sonë dhe bustin e Luigjit
7 e hodhën zvarrë në lumë. Atë vit filluan t'i helmonin nxënësit
8 e shkollës sime. Edhe sot mund t'i gjeni ato imazhe të të
9 rinjve që përpëliteshin buzë çmendurisë apo vdekjes si pasojë
10 e helmimit të organizuar kundër nxënësve shqiptarë në shkollat
11 tona. I shihja moshatarët e mi duke vuajtur dhe nxjerrë shkumë
12 nga goja nga helmimet misterioze që bënte Serbia kundër
13 nxënësve shqiptarë.

14 Ky gjah ndaj të rinjve shqiptarë vazhdonte pa ndalur si
15 një presion sistematik për t'i bërë ata që ta lëshonin
16 Kosovën. Prandaj në fillim të viteve '90 shumë bashkëmoshatarë
17 të mi u detyruan ta braktisin Kosovën që aq shumë e donin.
18 Në atë kohë unë kisha dy opsione, të qëndroja në Kosovë dhe të
19 prisja që potencialisht një ditë mund të helmohesha, të
20 arrestohesha, të vritesha, të dërgohesha me dhunë në ushtrinë
21 vrastare të Serbisë, apo për t'iu shmangur kësaj, ta lëshoja
22 edhe unë Kosovën, të shkoja diku në Gjermani, apo në Holandë
23 këtu, ku kisha gjysmën e familjarëve të mi, të kërkoja azil
24 sikur shumë të rinj shqiptarë.

25 Në mes të këtyre dy opsioneve, unë zgjodha një rrugë të

1 tretë. Në vend që t'i bashkohesha familjarëve të mi në mërgim,
2 unë iu bashkova një familjeje akoma më të madhe, iu bashkova
3 familjes Jashari në Prekaz. Lashë ëndrrat e mia të rinisë,
4 lashë studimet e letërsisë dhe u bëra pjesë e Ushtrisë
5 Çlirimtare të Kosovës.

6 UÇK-ja në atë kohë e kishte emrin ushtri, por nuk
7 numëronte shumë njerëz. Emrin dhe vullnetin e kishim të madh,
8 por njerëz e armë kishim shumë pak. Të ishe pjesë e UÇK-së do
9 të thotë të ishe armiku i Serbisë dhe mund të vriteshe ose e
10 pakta të arrestoheshe, siç u arrestua vëllai im dhe u dërgua
11 në burgjet e tmerrshme serbe, apo siç edhe u arrestua shoku im
12 Besnik Restelica, të cilin e mbytën gjatë torturave në
13 ambientet e hetuesisë në Prishtinë.

14 Unë tashme isha kërkuar nga Serbia, ata më ndiqnin për të
15 më arrestuar ose edhe për të më vrarë. Ndaj meje u publikua
16 një aktakuzë nga gjykata e Serbisë. Në atë aktakuzë ishte edhe
17 vetë Adem Jashari, si dhe bashkëluftëtarë të tjerë të tij. Unë
18 nuk mund të qëndroja më tutje në shtëpinë time dhe në familjen
19 time, prandaj u detyrova që bashkë me dajën tim Mujë
20 Krasniqin, më 10 tetor 1996 të largoheshim nga shtëpitë tona.
21 Prej asaj kohe, kryesisht qëndroja me familjen Jashari dhe jo
22 vetëm. Aty qëndroja me Ademin, Shabanin, Hamzën, aty qëndroja
23 edhe me fëmijët e asaj familjeje, me Fitimin, Besimin,
24 Kushtrimin, Igballen e të gjithë ata fëmijë të asaj familjeje.
25 Këta emra fëmijësh që sapo i përmenda, të gjithë u vranë

1 pastaj nga një sulm i policisë serbe mbi familjen Jashari. Pra
2 më 5 mars 1998 filloi sulmi i Serbisë mbi familjen Jashari, në
3 Prekaz.

4 Në ditën e sulmit unë nuk ndodhesha aty, prandaj edhe jam
5 gjallë, përndryshe edhe unë do ta kisha fatin e atyre që ranë
6 atë ditë në ato tri ditë, siç njihet tri ditët e Epopesë së
7 UÇK-së.

8 Në atë betejë, Adem Jashari ra heroikisht duke rezistuar
9 bashkë me tërë familjen e tij.

10 Ne, shokët e Adem Jasharit, që shpëtuan gjallë mbetëm
11 përballë gjithë Serbisë. Ishim shumë pak djem dhe vajza, burra
12 e gra, të armatosur shumë dobët e të pauniformuar dhe të
13 paorganizuar mirë. Mbetëm luftëtarë pa komandant.

14 Krejt çka mund të bënim ishte ta ndiqnim rrugën e Adem
15 Jasharit, të vdisnim duke luftuar apo të luftonim deri në
16 fitore. Disa e bënë të parën, ranë duke luftuar, e disa e bëmë
17 këtë të dytën e i mbijetuan luftës deri në përfundimin e saj.

18 Në ato ditë të rënda për Kosovën, vazhduam të rezistonim,
19 ashtu siç dinim e ashtu siç mundnim, donim ta kishim edhe në
20 një ushtri të armatosur mirë, por nuk ia arritëm ta armatosnim
21 sa duhet. Donim edhe ne ta kishim një ushtri të organizuar
22 mirë, por nuk e arritëm ta organizonim siç do të duhej, donim
23 edhe ne ta mundnim Serbinë, por nuk e arritëm këtë, pa ndihmën
24 e shteteve nga jashtë.

25 U munduam të organizohemi, të armatosemi, por nuk ia

1 arritëm, u munduam ta bënim këtë për të mbijetuar si njerëz të
2 vendit ku kishim lindur. Ne nuk kishim kazerma, por kishim
3 shtëpitë e familjeve tona dhe familjeve të tjera, të cilat na
4 strehonin dhe na mbanin.

5 Ne nuk kishim akademi ushtarake, por na kishin mësuar
6 prindërit tanë se si duhet të mbrohemi e të luftonim për
7 vendin tonë, ne nuk kishim uniforma, por ato i sajnim, disa i
8 blinim e disa edhe i ngjyrosnim vetë që të dukeshim si
9 ushtarë.

10 Kujtoj se si piktori akademik Idriz Berisha, me brushën e
11 tij të piktorit i pikturonte rrobat e punëtorëve, që ato të
12 dukeshin sikur rrobat e ushtarëve.

13 Të nderuar Gjykatës, lufta nuk është e mirë asnjëherë dhe
14 për askënd. Ne luftën nuk do ta zgjidhnim kurrë as si
15 profesion e as si pasion, po ajo ishte domosdoshmëri për
16 mbijetesën si komb e si shoqëri. E ndërkohë dhuna agresive dhe
17 shtypja vazhdonte kundër popullatës shqiptare në Kosovë.

18 Serbia kreu qindra masakra, ku siç të gjithë e dimë, vrau
19 mbi 12 mijë shqiptarë, pa kursyer gratë e fëmijët, pleqtë e të
20 sëmurët. Përveç vrasjeve, forcat serbe dhunuan mijëra gra e
21 vajza të pambrojtura shqiptare, ata dogjën me qindra e mijëra
22 shtëpi, dëbuan me dhunë nga Kosova, gjysmën, apo më shumë se
23 gjysmën e popullatës, kurse ne asnjëherë nuk bëmë atë çka
24 bënte Serbia kundër nesh, pra nuk iu përgjigjëm në të njëjtën
25 formë.

1 E nëse po flasim për krime, atëherë le të flasim për ato
2 krime që në të vërtetë kanë ndodhur. Le të flasim për të
3 gjitha masakrat, qoftë për atë të Mejës, Reçakut, Abrisë,
4 Radoniqit, Izbicës, Krushës, Rezallës, Poklekut, Qyshkut,
5 Makovcit, apo edhe qindra maskara të tjera ku janë vrarë
6 fëmijët, qoftë edhe në gjirin e nënave të tyre. Le të flasim
7 pra për Dubravën, ku Serbia ekzekutoi mbi 100 të burgosur
8 shqiptarë, le të flasim për të zhdukurit me dhunë, ku edhe sot
9 mijëra nuk janë gjetur akoma, le të flasim për krejt ata
10 kriminelë që kanë bërë krime dhe akoma nuk janë ndëshkuar.

11 Në qershor të vitit 1999, NATO dhe shtetet aleate
12 ndërhyjnë në ndihmë të popullit tonë dhe pas 78 ditë
13 bombardimesh lufta përfundoi. Kosova tashmë ishte e lirë.

14 Pas përfundimit të luftës, ata që e morën përgjegjësinë
15 për rendin dhe sigurinë ishin NATO dhe Kombet e Bashkuara,
16 respektivisht KFOR-i dhe UNMIK-u. Bashkërisht me ta u përpoqëm
17 që Kosova të bëhej shtet, të kishte zgjedhje të lira dhe
18 institucione demokratike. Si rezultat sot Kosova është shtet
19 sovran dhe demokratik.

20 Pas themelimit të kësaj Gjykate, jo rrallëherë jam pyetur
21 se a kisha frikë nga drejtësia, gjithmonë kam thënë dhe sot e
22 përsëris, unë nuk kam frikë nga drejtësia, por nga padrejtësia
23 duhet të kemi frikë të gjithë. Por pavarësisht kësaj, unë sot
24 qëndroj përballë jush, me besimin e plotë se në fund të këtij
25 procesi ju do të vendosni në favor të pafajësisë sime.

1 Siç u tha më herët këtu, më duhet të theksoj e të them se
2 dallimet dhe opinionet politike mes nesh, sidomos në kohë
3 specifike dhe me ndikime të thella politike, nuk duhet dhe nuk
4 mund të përdoren si fakte juridike kundër askujt e po ashtu
5 kundër ne, të bashkakuzuarve.

6 Në këto çaste kur ne po flasim e po na shohin
7 bashkëkombësit tanë, qytetarët e vendit tim, kam shumë besimin
8 se të gjithë së bashku do ta nxjerrim të vërtetën dhe unë
9 bashkë me bashkëluftëtarët e mi do të kthehem në vendin tonë
10 të lirë, për të cilin luftuam dhe punuam gjatë gjithë jetës
11 sonë.

12 Ju faleminderit që më dhatë mundësinë t'ju adresohem!

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

14 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit z. Kryegjyqtar.

15 Mirëdita të nderuar zotërinj. Të gjithë të pranishmëve në
16 gjyq dhe jashtë saj, mirëdita.

17 Kam nderin dhe privilegjin të filloj sot me deklaratën
18 hapëse të z. Rexhep Selimi i cili është i pranishëm këtu në
19 sallën e gjyqit. Sikurse thashë edhe më përpara unë parashikoj
20 që do të flas për 45 minuta edhe nuk do bëj një përmbledhje të
21 asaj që kemi parashtruar në dosjen paraprake, sikurse edhe
22 jemi udhëzuar prej jush të nderuar Gjykatës.

23 Në fakt, madje nuk ka asnjë arsye që pala mbrojtëse të
24 bëjë një përmbledhje në këtë fazë përpara se ZPS-ja të
25 thërrasë dëshmitarët e saj të parë. Sikurse edhe i dini

1 tashmë, të nderuar anëtarë të Trupit Gjykses, roli jua j në
2 përcaktimin e përgjegjësisë penale është të arrini në
3 përfundime të bazuara vetëm në prova që lidhen drejtpërdrejt
4 me faktet materiale të parashtruara në aktakuzë. Palës
5 mbrojtëse nuk i ngarkohet asnjë detyrim për të hedhur poshtë
6 akuzat e paraqitura në aktakuzë, por mbetet tërësisht
7 përgjegjësi e ZPS-së t'i vërtetojë të gjitha akuzat përtej një
8 dyshimi të arsyeshëm.

9 Dje, ZPS-ja pranoi publikisht dhe pa asnjë mëdyshje se ky
10 parim themelor është i gërshetuar në çdo aspekt material të
11 kësaj çështjeje. Gjithashtu, dëgjuam dje ZPS-në disa herë të
12 thoshte, si në fjalimin hapës, edhe atë përmbyllës, nga z.
13 Whiting dhe znj. Lawson, se kjo çështje nuk përbën procedim
14 penal kundër UÇK-së dhe që nuk drejtohet ndaj UÇK-së dhe që
15 UÇK-ja nuk është në gjykim.

16 Megjithatë, pavarësisht këtyre fjalëve të përzgjedhura me
17 kujdes, të rëndësishme janë veprimet e ZPS-së, në veçanti
18 zgjedhja e kësaj të fundit, për të ngritur një aktakuzë kundër
19 z. Selimi dhe të bashkakuzuarve të tjerë mbi bazat e një
20 ndërmarrjeje kriminale të përbashkët, që ne parashtrajmë,
21 lejon, krijon mundësinë e përfshirjes së cilitdo anëtari të
22 UÇK-së si anëtar apo vegël që është përdorur nga kjo NKP e
23 pretenduar.

24 Është pikërisht ZPS-ja e cila po përpiqet të bëjë
25 përgjegjës z. Selimi dhe të bashkakuzuarit e tjerë për

1 gjithçka që ka ndodhur në Kosovë, madje edhe në pjesë të
2 Shqipërisë. Përgjatë gjithë periudhës së mbuluar nga aktakuza,
3 sikurse vendimi për të siguruar dhe ushtruar kontroll mbi
4 gjithë Kosovën në vetvete do të nënkuptonte që cilido që
5 besonte në këtë qëllim, ishte përgjegjës për çdo veprim të
6 kryer nga të tjerë për arritjen e tij.

7 Kjo përzgjedhje nga ZPS-ja në mënyrë të palejueshme
8 njëtrajtëson drejtësinë e vendimit të popullatës shqiptare të
9 Kosovës si një e tërë për t'u armatosur kundër forcave serbe,
10 me atë çka ndodhi gjatë kohëzgjatjes së konfliktit që pasoi.
11 Në këto rrethana, ndoshta është e kuptueshme pse z. Selimi dhe
12 të bashkakuzuarit e tjerë e ndjejnë një farë detyrimi për të
13 mbrojtur trashëgiminë e UÇK-së kur kjo e fundit ishte qartazi
14 nën sulmin e kësaj Prokurorie.

15 Megjithatë, Mbrojtja e z. Selimi nuk do të bjerë pre e
16 këtij kurthi. Por garancia jonë e sigurtë është se ky shteg
17 nuk do të shmanget, nuk do të nënkuptojë të injoruarit të të
18 gjithë kontekstit të çështjes së ngritur kundër z. Selimi, kur
19 ky kontekst është shumë i rëndësishëm për të kuptuar dhe për
20 të vlerësuar pretendimet e ngritura në aktakuzë.

21 Ju patët mundësinë të dëgjonit me hollësi nga Mbrojtja e
22 z. Thaçi sot paradite lidhur me kontekstin e konfliktit,
23 kështu që nuk kam për synim që të përsëris atë që u tha.
24 Megjithatë, në një nivel më të drejtpërdrejtë edhe më
25 personal, ju dëgjuat nga z. Selimi për ndikimin e fushatave të

1 diskriminimit e persekutimit të lançuar nën urdhrat e
2 Presidentit Milosheviç kundër atij vetë dhe kolegëve të tij,
3 dhe kundër një numri të konsiderueshëm shqiptarësh të Kosovës
4 përgjatë gjithë viteve që i paraprijnë periudhës së mbuluar
5 nga aktakuza.

6 Askush nga ata që kanë dëgjuar retorikën nacionaliste të
7 përhapur asokohe kundër të ashtuquajturve terroristë shqiptarë
8 apo që kanë përjetuar thundrën e krimeve të kryera nga forcat
9 serbe në të gjithë ish-Jugosllavinë, nga viti 1991 e në vijim,
10 nga Vukovari në Sarajevë, Prijedori në Srebrenicë, nuk do të
11 kishte pasur dyshime se cilat do të kishin qenë pasojat e
12 pashmangshme për shqiptarët e Kosovës, të gjendur në shtegun
13 vrastar të makinerisë ushtarake serbe.

14 Askush nuk do të kishte pasur pikë dyshimi se një
15 president serb i dëshpëruar dhe i kundërshtuar, do të kishte
16 qenë më se i lumtur të përdorte çfarëdo lloj mjeti të
17 nevojshëm për të shpalosur kredencialet e tij ekstremiste, dhe
18 për të ushqyer mbështetjen politike në rënie duke përdorur si
19 trofe kufomat e shqiptarëve të Shqipërisë [sipas përkthimit].

20 Megjithatë, pavarësisht se aktakuza përmban 177 paragrafë
21 dhe se dosja paraprake e Prokurorisë ka 714 faqe, kërcënimi
22 ekzistencial me të cilin përballëshin kosovarët e asaj kohe,
23 ishte përmendur pak fare. Gjithashtu, mungesa në deklaratën e
24 hapëse të ZPS-së ditën e hënë ishte e dukshme e kësaj gjëje.

25 Masakrat e kryera kundër shqiptarëve të Kosovës, si ajo e

1 Prekazit thjesht u quajtën dje në parashtrimet e prokurorisë
2 si "ngjarje". Ky mohim përmes heshtjes i ekzistencës së një
3 shkalle të lartë kriminaliteti të ushtruar gjatë -- kundër
4 shqiptarëve të Kosovës, dhe teksa fajëson pikërisht këta
5 drejtues të UÇK-së për krimet e supozuara, nuk është
6 aksidental. Nuk është asgjë tjetër përveçse manipulim i
7 Prokurorisë.

8 Kundërshtimi i armatosur i shtypjes serbe nga shqiptarët
9 e Kosovës nuk ndodhi në mënyrë spontane edhe të menjëhershme,
10 nën drejtimin e një mendjeje udhëheqëse sikurse aludohet në
11 mënyrë të nënkuptuar nga ZPS-ja. Përkundrazi, pas një
12 dhjetëvjeçari rezistence paqësore të shqiptarëve të Kosovës
13 ndaj fushatës diskriminuese dhe shtypëse të Serbisë, e cila
14 ishte injoruar tërësisht dhe qëllimisht nga komuniteti
15 ndërkombëtar, në Dejton dhe përtej, ishte e nevojshme të bëhej
16 një zgjedhje. A do të vazhdohej me rezistencën paqësore ndaj
17 forcave serbe, nga shqiptarët e Kosovës, apo do të përdornin
18 një tjetër qasje ata tashmë?

19 Mendoj që zgjedhja që çfarë duhet bërë përballë shtypjes
20 përmbledhet më së miri nga Viktor Hygoja në veprën e tij "Të
21 mjerët", teksa orvatet të përshkruajë zgjedhjen që duhet të
22 bëjnë ata të cilët përballen me shtypjen:

23 "Pra, dëshiron të mos bësh asgjë. Atëherë, nuk do të
24 mbetet asnjë javë, asnjë ditë, apo asnjë orë, nga i cili do të
25 jesh i lirë nga shtypja. Nuk do të arrish të ngresh asgjë pa

1 përjetuar agoni. Çdo minutë që kalon do të t'i copëtojë
2 muskujt. Ajo që ka peshon sa një pupël për të tjerët, për ty
3 do të rëndojë sa një shkëmb. Gjërat më të thjeshta do të bëhen
4 më të vështira. Jeta jote do të bëhet e përbindshme. Të
5 shkosh, të vish, të marrësh frymë, do të jetë sforcime të
6 tmerrshme për ty. Mushkëritë e tua do të peshojnë sa qindra
7 kilogramë.”

8 Edhe ata të cilët udhëhiqeshin nga ideja e ndjekjes së
9 një politike tërësisht paqësore drejtuar nga LDK-ja, kundra
10 autoriteteve serbe, kuptuan në fillim të vitit 1998 që kishte
11 ardhur një pikë që nevojitej një qasje e ndryshme. Dhe këtu
12 përfshiheshin edhe persona të cilët nuk kishin përvojë
13 ushtarake, të cilët duhej që të vendosnin jetën e tyre në
14 rrezik. Kjo pikë kthese ishte qartazi masakra e familjes
15 Jashari, në datat 5, 6, dhe 7 mars 1998.

16 Dëgjuat nga z. Selimi sesi ai iu bashkua familjes Jashari
17 në Prekaz, dhe që shpesh qëndronte në shtëpinë e Adem Jasharit
18 në muajt dhe vitet që i paraprinë masakrës, dhe sesi
19 rastësisht ai nuk gjendej në Prekaz në ato ditë famëkeqe.

20 Më kujtohet që e kam parë masakrën në lajme, gati 24 vite
21 më përpara, ndërsa ndërtesat digjeshin, në ajër ishin të
22 filmuara nga lart, të rrethuara nga qindra trupa ushtarake
23 serbe. Megjithatë, ajo për çka nuk je përgatitur ndërsa sheh
24 ato reportazhe lajmesh është ndjesia e hyrjes në kompleksin e
25 Jasharëve dhe ecja përreth asaj që kishte mbetur nga dhomat e

1 shkrumbuara ku anëtarë të familjes së Adem Jasharit ishin
2 strehuar nga bombardimet e vazhdueshme, përfshirë edhe fëmijë
3 të moshës dyvjeçare. 57 persona [sipas përkthimit] mbetën të
4 vrarë nga forcat serbe gjatë atyre tri ditëve.

5 Ju dëgjuat nga vetë z. Selimi që lufta nuk -- do të
6 kishte qenë asnjëherë zgjedhja e tij ose e bashkëkombësve të
7 tij në qoftë se do të kishte pasur mënyra të tjera të
8 disponueshme për të mbrojtur veten. Prekazi u dëshmoi atyre se
9 nuk kishte mbetur rrugë tjetër. Lufta iu imponua atyre.

10 Të nderuar Gjykatës, paralelizmat me luftën aktuale në
11 Ukrainë janë mjaft të dukshme. Ukrainasit kanë mundur t'i
12 bëjnë ballë fuqisë mbizotëruese të kundërshtarit vetëm përmes
13 kurajës së tyre, duke mbrojtur veten dhe familjet e tyre nga
14 shkatërrimi. Mësues, mjekë, ekonomistë, kameramanë, njerëz nga
15 të gjitha fushat e jetës, pa përvojë ushtarake, kanë rrëmbyer
16 armët për të mbrojtur veten dhe popullin e tyre.

17 Ngjashmëria midis Kosovës së marsit 1998 dhe Kievit të
18 shkurtit 2021, është e frikshme.

19 Të nderuar anëtarë të Trupit Gjykses, thelbi i çështjes
20 së ngritur kundër z. Selimi nga ZPS-ja ne parashtrojmë se
21 është e mbështetur në të pavërteta. Bazohet në të pavërtetën
22 sipas të cilës UÇK-ja si grup aktiv rezistence që përpara
23 masakrës së Jasharëve, do të kishte kontrolluar në mënyrë të
24 drejtpërdrejtë hierarkike vullnetarët e shumtë që po dyndeshin
25 drejt Kosovës nga jashtë apo që po rrëmbenin armët brenda për

1 brenda vendit. Ky duket sikur është thelbi i çështjes së
2 ngritur nga ZPS-ja, pra që Shtabi i Përgjithshëm në njëfarë
3 mënyre vepronte në prapaskenë duke qëndruar pas çdo aspekti
4 vendimi apo aktiviteti që lidhej me këdo që kundërshtonte
5 forcat serbe në Kosovë.

6 Kjo është ajo çka u aludua nga ZPS-ja gjerë e gjatë dje
7 nga z. Halling i cili në mënyrë të çuditshme sugjeroi se
8 hierarkia e cila kishte rol qendror për UÇK-në që në fillesat
9 e saj, ushtroi në mënyrë fleksibël, citoj, çka mua në njëfarë
10 mënyre më duket një kontradiktë në vetvete.

11 Sa tërheqje mund të jetë për nga thjeshtësia false kjo
12 teori, aq dhe dukshëm dhe plotësisht e gabuar dhe ju të
13 nderuar Gjykatës, nuk duhet ta përqafojë atë.

14 Të nderuar anëtarë të Trupit Gjykses, të gjithë e dimë
15 mirë tendencën për t'i zbukuruar fillesat e një konflikti dhe
16 për të ngatërruar atë çka individë të caktuar do të kishin
17 dashur të ndodhte dhe atë që ka ndodhur në të vërtetë. Sikurse
18 u tha, fitorja ka një mijë baballarë, kurse humbja është
19 jetime. Në luftë kjo është më e vërtetë se kurrë. Çdo luftëtar
20 që përkuqton bëmat e tij, apo ato të njësive ose komandantëve
21 të vet, ka tendencën të mbivlerësojë ose ekzagjerojë nivelin e
22 suksesit ushtarak të organizatës së tyre, teksa njëkohësisht
23 minimizon dështimet e veta ose mungesën e organizimit.

24 Dokumentet e shumta tek të cilat u bazua dje ZPS-ja për
25 të mbështetur këtë organizim të pretenduar, përbëjnë

1 shëmbëlltyrën e kësaj shprehjeje. Në rastin më të mirë ato
2 reflektojnë aspiratën e individëve për të qenë të organizuar,
3 dhe jo realitetin për të cilin flasin faktet në terren. E
4 njëjta gjë vlen për deklaratat e dhëna publike të bëra
5 përballë dhe në funksion të kamerave. Projeksione të zbehta të
6 një niveli drejtues të unifikuar, të paraqitur për t'i dhënë
7 shtysë përsiatjeve të UÇK-së dhe për të transmetuar një imazh
8 të saj si strukturë e organizuar mirë, çka në të vërtetë nuk i
9 përgjigjet realitetit.

10 Dje, z. Whiting për ZPS-në foli për copëzat e ndryshme të
11 mozaikut, referuar çështjes së ngritur nga ZPS-ja, të cilat do
12 të vinin dhe mund të bashkoheshin me njëra-tjetrën përpara
13 jush të nderuar Gjykatës. Megjithatë, problemi me zgjidhjen e
14 këtij mozaiku është që ti tenton të mbledhësh copëza të
15 ndryshme të saj në këtë mënyrë pa kontekst, dhe informacion
16 rreth secilës prej copëzave, dhe se si njëra copëz lidhet me
17 të tjerat.

18 Kur të mbarojë ky proces gjyqësor, dhe kur ZPS-ja të bëjë
19 përmbledhjen e argumenteve të prezantuara prej saj, këto
20 copëza të panoramës apo të mozaikut do t'ju ofrojnë vetëm
21 thjesht një imazh të shtrembëruar dhe të rremë.

22 Po ashtu, z. Whiting përmes lenteve të tij konspirative,
23 e interpretoi atë si mjegullnajë. Në të vërtetë nuk është gjë
24 tjetër veçse mungesë provash. Neve, parashtrojmë që përmes
25 kësaj qasjeje konspirative, fsheh mungesën e provave. Shpesh

1 përgjigjja më e thjeshtë është edhe më e sakta.

2 Kryengritja spontane në Kosovë në muajin mars 1998 pas
3 masakrës së Jasharëve, nuk u udhëhoq apo drejtua në mënyrë të
4 organizuar apo hierarkike nga z. Selimi dhe të bashkakuzuarit
5 e tjerë sikurse e sugjeron ZPS-ja. Por, nga diaspora që u dynd
6 drejt Shqipërisë dhe më pas Kosovës nga e gjithë Evropa,
7 shpesh pa trajnim formal dhe me njohuri të kufizuara të asaj
8 kohe të vendit për të cilin ata kishin ardhur të mbronin, si
9 edhe shumë pak lidhje me ndonjë strukturë apo hierarki që do
10 t'i shërbenin.

11 Këta burra dhe gra të guximshëm të ardhur nga e gjithë
12 Evropa dhe edhe më nga larg, thjesht ishin të bashkuar në
13 besimin e tyre se kishte ardhur koha tashmë për të ndryshuar
14 taktikë dhe për t'u përfshirë në veprime të armatosura. Ky
15 botëkuptim nuk nënkupton të pranuarit e luftës në drejtimin e
16 Shtabit të Përgjithshëm apo të marrjes së urdhrave ose
17 udhëzimeve detyruese të tyre.

18 Sikurse do të dëshmojnë me besueshmëri provat e
19 dëshmitarëve të ZPS-së, nuk ka pasur strukturë të organizuar
20 për grupe që u formuan në pranverë të vitit 1998, dhe as
21 hierarki ushtarake të përqendruar te kryesia e supozuar e
22 Shtabit të Përgjithshëm. Vullnetarët luftuan aty ku
23 dëshironin, përgjithësisht për të mbrojtur shtëpitë e
24 familjeve të tyre, së bashku me njerëz që ata i njihnin dhe
25 ishin të besuar të tyre. Ndonjëherë jepeshin sugjerime se ku

1 duhej të shërbenin vullnetarët, por nuk ekzistonte pritshmëri
2 konkrete që sugjerimet e tilla të ndiqeshin.

3 Nuk ka pasur pasoja për individë që largoheshin nga fusha
4 e betejës ose ktheheshin në vendet e tyre për javë apo muaj të
5 tërë. Në rastin më të mirë, uniformat, armët dhe furnizimet
6 ishin sporadike. Dëgjuat drejtpërdrejt nga z. Selimi për sa i
7 takon përdorimit dhe sajimit të veshjeve të kamufluara
8 ushtarake ku pantallonat e thjeshta pikturoheshin me bojëra të
9 ndryshme.

10 Mjafton vetëm të bëhet kontrasti ndërmjet UÇK-së dhe
11 fuqisë së forcave të armatosura serbe të kohës, një ndër më të
12 mëdhatë në Evropë për nga numri i trupave, me një personel
13 aktiv prej rreth 114,000 [sipas përkthimit] trupash të
14 mbështetur nga 400,000 rezervistë. Ndërsa forcat serbe ishin
15 të pajisur me avionë ushtarakë, tanke dhe artileri, UÇK-ja
16 kishit vetëm pushkë dhe bomba të improvizuara. Ndërsa Serbia
17 kishte ushtarë me përvojë në terren të mësuar me ashpërsinë e
18 betejave të përgjakshme në Bosnjë e Hercegovinë dhe Kroaci,
19 UÇK-ja kishte vullnetarë të cilët me gjasë nuk kishin parë dhe
20 prekur me dorë asnjëherë armë. Ndërsa serbët dispononin
21 brigada, batalione dhe reparte të organizuara sipas një
22 hierarkie të mirëpërcaktuar, UÇK-ja kishte vetëm grupime të
23 vogla luftëtarësh të bashkuar rreth fshatrave apo individëve
24 të caktuar të cilat me ngut mund të grupoheshin për mbrojtjen
25 e komuniteteve, të diktuar nga nevojat e çastit dhe jo nga një

1 planifikim i kujdesshëm ushtarak.

2 Të nderuar Anëtarë të Trupit Gjykses, ky është konteksti
3 real që ZPS-ja nuk dëshiron t'jua bëjë me dije. Shpërfilleni
4 mungesën e balancës ndërmjet forcave serbe dhe kundërshtarëve
5 të tyre shqiptarë, shpërfillini tmerret ndodhin gjithandej si
6 dhe konfuzionin dhe kaosin përbrenda Kosovës. Këtë ju tha ZPS-
7 ja dhe thjesht përqendrohuni vetëm në fushat specifike që ne
8 duam që të sjellim në vëmendjen tuaj. Por mos e shikoni të
9 gjithë mozaikun.

10 Pra, cilat janë akuzat konkrete tek të cilat ZPS-ja
11 kërkon që ju të përqendroheni. Si arriti z. Selimi deri këtu i
12 përballur me akuza të shpërndara në 45 vendndodhje të ndryshme
13 përgjatë gjithë Kosovës për një periudhë prej 19 muajsh.

14 Ne parashtrojmë se është e pamundur t'i përgjigjesh kësaj
15 pyetjeje pa shqyrtuar fillimisht origjinën e hetimit të kryer
16 nga Senatori zviceran Dick Marty më shumë se sa dhjetë vjet më
17 parë, i cili çoi në krijimin e Dhomave të Specializuara të
18 Kosovës.

19 Sikurse e dini të nderuar Gjykatës dhe sikurse u tha edhe
20 më përpara, pavarësisht pretendimeve të bujshme dhe të rreme
21 për trafik organesh, raporti përfundimtar i z. Marty nuk i
22 referohet fare, nuk e përmend fare emrin e z. Selimi.
23 Megjithatë, këto pretendime të pavërteta janë në thelb të
24 vazhdimësisë së hetimeve kundër z. Selimi dhe të
25 bashkakuzuarve të tjerë, të mbështetura nga disa shtete,

1 parashtrojmë ne, që kishin interes të drejtpërdrejtë në
2 destabilizimin e Kosovës.

3 Edhe pse pretendimet për trafik organesh u
4 përgënjeshtroan më pas, hetimet zgjatën për shumë vite duke u
5 transformuar në dublikatë të hetimeve të ndërmarra thuajse dy
6 dekada më parë nga TPNJ-ja, dhe të kryesuar më së fundi nga
7 hetimet e UNMIK-ut dhe EULEX-it në Kosovë.

8 Padyshim që Kosova mund të ketë të ashtuquajturin "nder"
9 të të qenit subjekt i më shumë llojeve të hetimeve për krime
10 lufte ndoshta më shumë se çdo vend dhe konflikt tjetër në
11 botë. Ne madje mund të themi më shumë se sa Serbia e cila
12 arriti t'i shmangej hetimeve të mëtejshme dhe më të thelluara
13 për sa i përket veprimtarisë së forcave të tyre ushtarake në
14 Kosovë. Kjo pavarësisht gjetjeve të shumta që faktonin
15 kryerjen e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit të
16 mbështetura në çështjen Gjorgjeviq nga TPNJ-ja.

17 Fatkeqësisht, perceptimi i përgjithshëm është se hetimet
18 ndërkombëtare për krime janë të suksesshme vetëm nëse
19 përfundojnë në ndjekje penale. Përndryshe, ato kritikohen si
20 dështime të kushtueshme. Nga ana tjetër, prokurorive u
21 nevojiten gjykatat. Pra gjykatat mund të kenë emra të
22 ndryshëm, mund të jenë gjykata të jashtëzakonshme, të posaçme
23 apo të specializuara. Ndryshe nga sistemet gjyqësore
24 kombëtare, gjykatat e posaçme ngrihen me një qëllim specifik:
25 Përgjithësisht për të hetuar individë apo grupe të caktuara

1 individësh. Diçka e tillë është e vërtetë edhe për Dhomat e
2 Jashtëzakonshme në Gjykatën e Kamboxhias të cilat ishin
3 përgjegjës për hetimet e drejtuesve më të lartë dhe atyre me
4 përgjegjësi kryesore. E njëjta gjë është edhe për rastin e
5 Tribunalit Special të Libanit, ku gjykata u ngrit për hetimin
6 e personave që ishin të dyshuar si përgjegjës për vrasjen e
7 ish-kryeministrit të vendit.

8 E njëjta gjë vlen edhe për Dhomat e Specializuara të
9 Kosovës të ngritura për të hetuar krimet ndërkombëtare që
10 lidhen me raportin e Dick Marty. Ne parashtrojmë që hetimi i
11 kryer nga TFHS-ja, nga Task Forca Speciale Hetimore kundër z.
12 Selimi dhe të bashkakuzuarve të tjerë, nuk ka qenë asnjëherë
13 hetim i paanshëm dhe i pavarur. Kërkimi i supozuar i së
14 vërtetës prej saj ishte pashmangësisht i kompromentuar që në
15 gjenezë. Një prokuror vlerëson në mënyrë të pavarur dhe
16 objektive nëse krimet kanë ndodhur. Kush ka qenë për kryerjen
17 e tyre dhe më pas në përputhje me rrethanat përcakton nëse
18 përgjegjësia penale mund t'i atribuohet në mënyrë të
19 pakundërshtueshme dhe të drejtë personave të tretë, për shkak
20 të sjelljes së tyre të fajshme, në këto vepra penale. Faji nuk
21 duhet të jetë asnjëherë i nënkuptuar.

22 Provat duhet të vlerësohen në mënyrë objektive edhe nëse
23 përgjegjësia mbërrin deri te shkaktari i drejtpërdrejtë i
24 krimit ose supervizori i drejtpërdrejtë i tij. Kjo është
25 normale. Nuk mund të ketë supozime se faji për krimet e

1 pretenduara të luftës apo të atyre kundër njerëzimit,
2 transferohet gjithmonë sipër në shkallaren e hierarkisë. Nëse
3 ndodh kjo e fundit, atëherë cilido udhëheqës politik apo
4 ushtarak në çdo konflikt do të përballet me përgjegjësi
5 kriminale për çdo krim të kryer në terren.

6 ZPS-ja e nisi hetimin e vet me fajin e prezumuar të z.
7 Selimi dhe më pas u kthye mbrapsht për të provuar, për të
8 tentuar të dëshmojë se si z. Selimi mund të lidhet me krime
9 tërësisht të ndryshme nga ato që janë identifikuar. ZPS-ja
10 supozonte se meqenëse krimet ishin kryer gjatë periudhës së
11 mbuluar nga aktakuza, dhe se z. Selimi dhe të bashkakuzuarit e
12 tjerë kishin qenë në pozita autoriteti asokohe në Kosovë, ata
13 duhet të kenë qenë përgjegjës për këto krime në mënyrë të
14 pashmangshme.

15 Kjo ka prodhuar një çështje e cila nuk është thjeshtë e
16 dobët, e paqartë, e mbështetur në fakte të palidhura dhe e
17 mjegullt, por edhe thellësisht jokohërente në thelbin e saj.

18 Përpara se të trajtojë pretendimet e supozuara kundër z.
19 Selimi në këtë çështje gjyqësore, dëshiroj të përqendrohen në
20 dy elemente kontekstuale që lidhen me bërthamën e akuzave të
21 ngritura këtu. Janë cekur dhe më përpara dhe do të përpiqem
22 t'i bie shkurt.

23 Kundër Z. Selimi janë ngritur dhjetë akuza për krime
24 kundër njerëzimit dhe krime lufte. Nëse ZPS-ja nuk arrin të
25 faktojë elementët thelbësorë kontekstuale të të gjitha këtyre

1 veprave penale përpara kësaj Gjykate të Kosovës, atëherë
2 dënimi, shpallja fajtor nuk do të mund të bëhej.

3 Që të faktojë krimet kundër njerëzimit, ZPS-ja duhet të
4 faktojë ekzistencën e një sulmi të përgjithshëm dhe sistematik
5 kundër popullatës civile.

6 Thuhet shpesh se çmenduri do të thotë të kryerit të të
7 njëjtit veprim gjithherë duke pritur të njëjtat rezultate.
8 Megjithatë, duket se po bën dhe ZPS-ja me tentativën e saj për
9 të provuar ekzistencën e aludimeve të saj për sulme të
10 përgjithshme sistematike.

11 TPNJ-ja kishte juridiksion mbi Kosovën dhe e ka hetuar
12 atë gjerësisht. Asnjë prej personave të UÇK-së nuk është
13 akuzuar për dhe dënuar për krime kundër njerëzimit. E njëjta
14 gjë vlen edhe për rastet e luftëtarëve të supozuar të UÇK-së
15 të hetuar nga UNMIK-u dhe EULEX-i. Edhe pse disa u akuzuan për
16 krime kundër njerëzimit, asnjë prej tyre nuk u dënua.
17 Pavarësisht kësaj, ZPS-ja po përpiqet të përdorë sërish të
18 njëjtat akuza të ripërtëritura.

19 Kemi dëgjuar pra për tentativën e ZPS-së, por që dështoi
20 për të shpjeguar përbërjen e popullatës civile të Kosovës, në
21 ritregimin që i bëri luftë së Kosovës. Nëse nuk mund të
22 shpjegojë në mënyrë të përmbledhur provat e veta, si mund t'ju
23 bindë ajo juve? Nuk ekziston një faktor i përbashkët koherent
24 për të gjitha krimet e ndryshme të pretenduara që përbëjnë
25 boshtin e supozimeve të ngritura nga aktakuza kundër z.

1 Selimi. Nëse ky faktor do të ekzistonte, ZPS-ja nuk do të
2 ishte e detyruar të bënte akrobaci mendore për ta përshkuar
3 atë.

4 Këto elemente të ndryshme rrethimore nuk mund të
5 trajtohen si teknikalitete nga ZPS-ja. Ato janë elemente
6 thelbësore për të lartësuar krimet kundër njerëzimit dhe
7 kategorinë e veçantë tek e cila bën pjesë. Është pikërisht ky
8 prag, ky standard kaq i lartë që duhet të përmbushë ZPS-ja për
9 të paraqitur pra prova të qarta të mirëpërcaktuara dhe të
10 besueshme. Por ajo thjesht nuk mund të jetë ta bëjë një gjë të
11 tillë.

12 Po kështu, ZPS-ja i klasifikon krimet e shumëllojta të
13 ngarkuara kundër z. Selimi si krime lufte. Duhet që të
14 demonstrojë lidhjen midis këtyre krimeve dhe konfliktit të
15 armatosur. Nuk mjafton që ZPS-ja të pohojë se thjesht kishte
16 një konflikt të armatosur të shtrirë në të gjithë Kosovën
17 gjatë të gjithë periudhës së mbuluar nga aktakuza dhe të presë
18 nga ju, anëtarë të nderuar të këtij Trupi Gjykues që thjesht
19 ta pranoni këtë pohim të përgjithshëm pa detaje të mëtejshme.

20 Çdo veprë penale duhet të jetë kryer gjatë periudhës së
21 konfliktit të armatosur të cilin ZPS-ja ka detyrime ta
22 faktojë, dhe të jetë mjaftueshëm i lidhur me të. Për krimet e
23 shumëllojshme të ngritura në aktakuzë ajo nuk mund të bëjë as
24 të parën e as të dytën.

25 Edhe nëse supozojmë se ZPS-ja në njëfarë mënyre arrin të

1 ketë sukses aty ku të tjerët kanë dështuar, pra të vërtetojë
2 ekzistencën e krimeve të pretenduara, si edhe elementet e
3 duhura rrethanore, asaj sërish do t'i duhet të identifikojë se
4 cilat janë veprat për të cilat z. Selimi është fajtor. Dhe ne
5 themi se këtu lind në të vërtetë problemi i ZPS-së.

6 Ka tre forma të ndryshme të ndërlidhura të përgjegjësisë
7 penale, pra është: NPK-ja; përgjegjësia si epror; dhe ndihma
8 dhe nxitja.

9 Që në fillim, vërehet se ZPS-ja shprehimisht ka
10 konfirmuar se nuk ka asnjë pretendim në aktakuzë që z. Selimi
11 të ketë kryer krime me pjesëmarrje fizike duke qenë se kryerja
12 e tyre ka të bëjë vetëm me NPK.

13 Nuk është për t'u habitur, nëse z. Selimi do të ishte
14 akuzuar si shkaktari fizik i veprave penale mbi bazën e këtyre
15 aludimeve, akuzat nuk do të kishin kaluar standardin
16 fillestar. Shumë prej këtyre akuzave shquhen për mungesën e
17 veprimit të qenësishëm penal. Procedimi penal i z. Selimi për
18 marrjen e supozuar në pyetje të një individi, kthimin e
19 letërnjoftimeve, apo kërcënimin e supozuar të një gazetari, do
20 të ishte thujse absurd nëse pasojat për z. Selimi nuk do të
21 kishin qenë kaq serioze.

22 Edhe me argumentin e sjellë nga ZPS-ja sipas të cilës z.
23 Selimi supozohet se kishte qenë i pranishëm apo i informuar
24 rreth individëve që ishin ndaluar, aludime të cilat Mbrojtja i
25 vë në dyshim, vetë dëshmitarët e thirrur nga ZPS-ja që pritet

1 të dëshmojnë, thonë se ata mendonin në të vërtetë i kishte
2 udhëzuar rojet që t'i lironin, ose që të lejonin që këta të
3 fundit t'i bashkoheshin UÇK-së.

4 Në fakt kjo e vërtetë ngre dyshime të qenësishme mbi
5 pretendimet e ZPS-së për kontroll efektiv, aq më tepër nëse
6 këto sugjerime mund të injorohen kaq thjesht, pa hezitim apo
7 pasojë nga vartësit e supozuar të z. Selimi.

8 Mbrojtja vëren se ekziston vetëm një aludim serioz kundër
9 z. Selimi; sipas të cilit një person është rrahur në prill
10 1999 në Kleçkë, nga një person i maskuar dhe sipas argumentit
11 të ngritur nga ZPS-ja ky person ishte z. Selimi.

12 Z. Selimi e mohon në mënyrë kategorike këtë akuzë, e cila
13 faktikisht i ishte fshehur palës mbrojtëse deri para pak
14 muajve. Kur them i ishte "fshehur", do të them që ishte
15 mbuluar me redaktime në aktakuzë, dhe erdhëm në dijeni të
16 kësaj vetëm më datë 22 janar. Por, edhe për shkak të mungesës
17 së provave të drejtpërdrejta identifikuese, argumenti i ZPS-së
18 është tërësisht i bazuar në referenca të supozuar të
19 pseudonimit të individit nga ushtarët e tjerë të pranishëm.
20 Një bazë veçanërisht e volitshme dhe e dobët për një akuzë kaq
21 serioze, pa asnjë mbështetje.

22 Pra, në vend që të përpiqej që ta ndiqte penalisht z.
23 Selimi si shkaktar të drejtpërdrejtë të veprave penale, ZPS-ja
24 u mbështet thujtë tërësisht tek akuza për ndërmarrje të
25 përbashkët kriminale, dhe si përgjegjësi si epror, e diktuar

1 jo nga provat siç themi ne, por nga një diskrecion subjektiv i
2 hetuesit, dhe pse z. Selimi akuzohet për ndihmë dhe nxitje të
3 veprave penale në aktakuzë bazuar në të njëjta aludime të
4 parashtruara për NPK-në, ky nuk përbën asgjë më shumë sesa një
5 reflektim të mëpasshëm nga ana e ZPS-së i cili nuk zë më shumë
6 se një paragraf të përgjithshëm në aktakuzë.

7 NPK-ja dhe përgjegjësia e eprorit njihen në tribunalët
8 ndërkombëtarë. Kur përdoren ato bëjnë të mundur identifikimin
9 e nivelit të plotë të supozuar të përgjegjësisë penale për
10 krime të një shkalle ndërkombëtare që lidhen me pozita në --
11 me persona në pozita më të larta, të cilët supozohen se mbajnë
12 përgjegjësi kryesore. Jo thjesht, pra për veprime fizike të
13 shkaktuara nga individë të caktuar. Dhe ky është qëllimi për
14 të cilin ato janë krijuar.

15 Për shembull, në vend që të procedohej penalisht vetëm
16 një shkaktar i nivelit të ulët, këto forma të përgjegjësisë
17 penale mundësojnë procedimin edhe të personit që supozohet të
18 ketë urdhëruar shkaktarin e drejtpërdrejtë të veprës penale.
19 Por në aktakuzë nuk ka aludime që z. Selimi të ketë urdhëruar
20 ndonjë krim, nuk ka as aludime që në njëfarë mënyre, me veprim
21 apo mosveprim të ketë shkaktuar krime. Madje as që
22 planifikonte krime.

23 Përkundrazi aludohet që z. Selimi mori pjesë në negociata
24 me ndërkombëtarë dhe grupe të tjera të armatosura dhe politike
25 në Kosovë dhe Shqipëri. Pretendohet se z. Selimi mbikëqyri

1 përcaktimin e kufijve midis zonave. Po kështu pretendohet se
2 ai koordinoi dhe u informua përmes raporteve dhe mori pjesë në
3 operacione ushtarake.

4 Tani kur i lexon këto pretendime, mund t'ia falësh kujt do
5 që të mos ta kuptojë. Ku qëndron kriminaliteti në këto
6 veprime? Çfarë ka parë papritmas ZPS-ja në këto veprime për të
7 justifikuar aktakuzën ndaj z. Selimi duke i hequr lirinë për
8 më shumë se dy vite tashmë? Dhe me një kohëzgjatje të pritshme
9 dhe dy vitesh të tjera? Të cilat në njëfarë mënyre i paskan
10 shpëtuar pararendësve të saj gjatë këtyre 20 viteve?

11 Ajo që ka ndodhur është që janë marrë të gjitha veprimet
12 dhe mosveprimet e z. Selimi sado të vogla apo kalimtare të
13 cilat nuk janë as kriminale, që nuk ushtrojnë ndikim mbi
14 krimet në fjalë të supozuara nga ZPS-ja, por janë grumbulluar
15 më pas për të prodhuar, për të përcjellë ndjesinë e një
16 fajësie të z. Selimi.

17 Gjithkush e di parimin se nëse përbalt mjaftueshëm një
18 mur, një pesë e kësaj balte edhe do të ngjisë. Në këtë rast,
19 ZPS-ja po vërvit gjithçka rreth z. Selimi, qoftë edhe brenda
20 qëllimit të përkohshëm të aktakuzës apo edhe përtej kësaj, me
21 shpresën e kotë se mbase një pjesë e saj do të ngjisë tek
22 akuza për NPK, që ZPS-ja e ka stisur, dhe që në njëfarë mënyre
23 do ta marrë me vete z. Selimi.

24 Por ky është problemi thelbësor që ka NPK-ja dhe
25 përgjegjësia si epror. Ku shtysat për të ngritur një çështje

1 kundër një individ të caktuar është kaq e madhe, kaq e fortë,
2 sikurse duket në rastin e ZPS-së, për z. Selimi, këto forma të
3 përgjegjësisë penale mund t'i tejkalojnë kufijtë e natyrshëm.
4 Së paku, dhe sa i takon konfirmimit të aktakuzës në bazë të
5 këtyre pretendimeve.

6 Sado të përpiqet ZPS-ja të përziejë, të kombinojnë në
7 këtë mënyrë apo një tjetër akuzat e ndryshme kundër z. Selimi,
8 provat nuk dëshmojnë që z. Selimi të ketë kontribuar në emër
9 të një plani të përbashkët kriminal të hamendësuar, edhe sikur
10 të supozojmë që ky plan ka ekzistuar. Por edhe këtë e
11 kundërshton fuqimisht Mbrojtja.

12 Në fakt, nuk është thjesht kontributi i supozuar i z.
13 Selimi në NPK po edhe plani i përbashkët i hamendësuar që
14 përbën thelbin e NPK-së që shërben edhe si shembull kryesor i
15 qasjes problematike të ZPS-së.

16 E dimë nga aktakuza që akuza e ZPS-së është që së paku
17 midis muajve mars 1998 dhe shtator 1999, katër të akuzuarit
18 dhe anëtarë të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale,
19 kishin të përbashkët një qëllim për të shtënë nën kontrollin e
20 tyre të gjithë Kosovën përmes veprave penale të shantazhit,
21 ushtrimit të dhunës, eliminimit të atyre që i konsideronin si
22 kundërshtarë.

23 Ishte kriminal në thelb qëllimi i NPK-së? Jo. Ishte
24 krejtësisht legjitim dhe madje mbështetëj, siç do sugjerojmë
25 ne, nga segmente të shumta të komunitetit ndërkombëtar në

1 Kosovë. Sidomos duke pasur parasysh se çfarë kishte ndodhur në
2 mbarë ish-Jugosllavinë në dekadën e mëparshme.

3 Në fakt mbrojtja e shqiptarëve të Kosovës nga mizoritë
4 serbe dhe çlirimi i mëpasshëm i Kosovës, ishin arsytet përse
5 NATO-ja hyri në luftë kundër Serbisë në mbështetje të UÇK-së.

6 Prapëseprapë, për arsye se objektivi i çlirimit të
7 Kosovës në njëfarë mënyre supozohet se nënkuptonte ndërmarrjen
8 e veprave penale të kryera nga të tretë, dhe jo nga z. Selimi,
9 ai sërish akuzohet se ka qenë pjesë e një NPK-je lidhur me
10 këto vepra penale. Megjithatë, askush nuk po sugjeron se
11 veprat penale sporadike janë të nevojshme për të arritur këtë
12 qëllim. Por, ZPS-ja pretendon se këto krime janë kryer pra,
13 dhe i janë lënë në derë z. Selimi dhe të bashkakuzuarve të
14 tjerë sikur kjo të ishte fytyra e vërtetë e UÇK-së.

15 Lidhur me këtë, parashtresat e ZPS-së ditën e djeshme
16 lidhur me motivin që qëndronte pas NPK-së ishin ndriçuese.
17 Edhe pse në seancë deklaroi se nuk ishte e nevojshme që ZPS-ja
18 të vërtetonte motivin, z. Whiting gjithsesi shfrytëzoi rastin
19 të sugjeronte se ky i fundit mund të kishte qenë për të fituar
20 pushtet për shkak të frikës, urrejtjes apo edhe për hakmarrje.
21 Por që nuk kishte rëndësi, pasi motivi nuk ishte as shkak për
22 shkelje penale, as për mbrojtje.

23 Megjithatë, pa një motiv të tillë, të qartë, u sugjerua
24 se mungesa e koherencës së teorisë së ZPS-së për NPK-në vetëm
25 sa u shpalos haptazi, sepse nuk ekzistonte siç e thashë, një

1 motiv i qartë, logjik dhe i artikuluar mirë, i cili të
2 shërbente si pikë bashkimi për akuzat e zhbancuara.

3 Pikërisht, kjo mungesë e këtij elementi, e këtij motivi,
4 e zgjeron aq shumë konceptin e NPK-së, sa e komprometon gjithë
5 qëllimin e saj, dhe ngre hije dyshimi mbi të gjithë bazën e
6 përrallave që mund të paraqiten kundër z. Selimi.

7 Të njëjtat shqetësime ngrihen edhe për zbatueshmërinë e
8 konceptit të përgjegjësisë si epror, një formë e përgjegjësisë
9 penale e hartuar fillimisht për të dënuar guvernatorin
10 ushtarak japonez të Filipineve të pushtuara asokohe, nën
11 udhëheqjen e ushtrive me një ndër hierarkitë më rigoroze të
12 botës, për një sërë krimesh të kryera nën komandën e tij, duke
13 përfshirë edhe vdekjen e 25,000 burrave, grave dhe fëmijëve.

14 Në këtë rast, i njëjti parim është marrë për të përfshirë
15 edhe përgjegjësinë mbi një grup incidentesh të veçuara dhe
16 sporadike, të kryera, nëse janë kryer, nga individë të cilët,
17 as nuk e shihnin veten dhe as nuk kishin qenë ndonjëherë nën
18 kontrollin efektiv të z. Selimi apo edhe të ndonjërit prej të
19 akuzuarve të tjerë në këtë çështje gjyqësore.

20 Për ta çuar edhe më tej zgjerimin e përgjegjësisë si
21 epror përtej kufijve të saj të natyrshëm, ZPS-ja tashmë është
22 shprehur se secili prej të akuzuarve në njëfarë mënyre ishte
23 diku nga të qenit tërësisht vartës të një të bashkakuzuari
24 tjetër në të qenit udhëheqës dhe komandant ndaj të
25 bashkakuzuarit, duke e ndërruar rolin si t'u volisë atyre. Pra

1 njësoj siç do t'i voliste apo leverdiste argumentit të
2 Prokurorisë në një moment të caktuar.

3 Sikurse do të bëhet e qartë nga vetë dëshmitarët e ZPS-
4 së, struktura dhe hierarkia e nevojshme për të vërtetuar në
5 mënyrë bindëse kontrollin efektiv mbi vartësin, thjesht nuk
6 ekziston në këtë çështje gjyqësore. Madje në një moment të
7 mirëpritur çiltërsie, ZPS-ja pranoi se arsyeja pse i është
8 dashur kaq shumë kohë, pra dy vjet, për të paraqitur
9 argumentet e veta është mungesa e provave bindëse të
10 ekzistencës së një strukture përbëra UÇK-së, krahasimisht me
11 provat e qarta dhe konsistente që ata dispononin lidhur me
12 krimet dhe mizoritë e kryera nga forcat serbe në Bosnjë e
13 Hercegovinë, raste të tjera të cilat i kanë hetuar dhe
14 proceduar përpara TPNJ-së. Pra maska e tyre ra, qoftë edhe për
15 një çast të vetëm.

16 Ndonjëherë, sikurse ne presim që të vërtetohet në këtë
17 rast, mungesa e provave të forta për të mbështetur një aludim
18 të caktuar, në të vërtetë është tregues i pavërtetësisë së
19 këtij aludimi. Mungesa e provave koherente dhe konsistente për
20 ekzistencën e një strukture përbrenda UÇK-së shërben për të
21 dëshmuar se një fakt nuk kishte një strukturë të tillë.
22 Mungesa e provave për ekzistencën e një plani kriminal
23 nënkupton që në të vërtetë një plan i tillë nuk ka ekzistuar
24 kurrë. Nuk ka asgjë më të ndërlikuar përtej kësaj.

25 Nëse ZPS-ja do ta kishte hetuar këtë rast në mënyrë

1 objektive dhe të paanshme në vend që të ndiqte qëllimin
2 specifik për të shënjestruar dhe dënuar z. Selimi, ajo do të
3 kishte shqyrtuar provat dhe do të kishte vendosur që, cilatdo
4 të ishin veprat penale të kryera kundër, z. Selimi nuk mund të
5 ngrihej asnjë provë apo çështje penale. Z. Selimi është duke
6 vuajtur pasojat e ZPS-së për t'u udhëhequr nga ky parim.

7 Për ta mbyllur, të nderuar Gjykatës. Fola sot për
8 argumentet e ZPS-së kundër z. Selimi për të cilat ai do të
9 duhet të mbrohet. Që nga dorëzimi i tij i parakohshëm në një
10 stacion policie ditën e arrestimit të tij në muajin nëntor
11 2020, ku ai u informua për një urdhër-arresti të lëshuar
12 kundër tij, e deri te deklarata e tij sot në gjykatë, z.
13 Selimi është angazhuar tërësisht në këtë proces gjyqësor.
14 Pavarësisht njollosjes së pashmangshme që vjen si pasojë e të
15 qenit i ndaluar në një vend të huaj, larg shtëpisë, larg
16 familjes, larg atdheut, për çlirimin e të cilit luftoi. Ai ka
17 qenë i pranishëm në çdo seancë të këtij procesi fizikisht, apo
18 në distancë dhe është plotësisht i bindur që do të vazhdojë të
19 veprojë në këtë mënyrë përgjatë gjithë prezantimit të
20 argumenteve të ngritura nga ZPS-ja.

21 Siç do ta tregojnë provat në dy vitet e ardhshme, nëse
22 ndonjëra prej veprave penale të përshkruara në periudhën e
23 mbuluar nga aktakuza kanë ndodhur, ajo përbën ngjarje të
24 izoluara dhe të rastësishme kundër individëve të caktuar, dhe
25 se z. Selimi thjesht nuk ka pasur asnjë lloj lidhjeje me to.

1 Personat përgjegjës janë ata të cilët e kanë kryer fizikisht
2 veprën penale ose kanë qenë drejtpërdrejt përgjegjës për
3 urdhërimin e saj.

4 E thënë thjesht, krimet e kryera në luftë jo medoemos
5 janë rezultat i një plani apo politike edhe nëse ato janë
6 relativisht të shumta në numër.

7 Z. Selimi, të nderuar Gjykatës, nuk është përgjegjës as
8 si kryes i tyre, as si anëtar i një NPK-je, as si epror, as si
9 ndihmues, as si nxitës i këtyre, nëse -- pra asnjë prej
10 krimeve -- në aktakuzë, dhe unë jam i bindur se provat e
11 paraqitura në këtë çështje do ta mbështesin plotësisht këtë
12 fakt.

13 Faleminderit për vëmendjen.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
15 z. Roberts.

16 Përpara se ta mbyllim, dua që të korrigjoj diçka, sa i
17 takoj datës për paraqitjen e mëtejshme të të akuzuarve përpara
18 Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

19 Pra, në vend të 5 tetorit të vitit 2022, në procesverbal
20 duhet të jetë se paraqitja e mëtejshme është 10 maji 2022.

21 Këtu mbyllet seanca sot publike, do të rimblidhemi nesër
22 në orën 9.00 për të vijuar me deklaratën hyrëse të Mbrojtjes
23 së z. Krasniqi.

24 Falënderoj palët, të pranishmit, përkthyesit, teknikët
25 dhe personelin e sigurisë dhe të tjerët për asistencën e tyre.

1 Këtu ndërpritet seanca.

2 --- Seanca mbyllet në orën 15.50

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25